

1 E enjte, 24 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

8 kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar

9 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup

10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë të

12 akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit. Do të

13 vazhdojmë sot me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë 04758.

14 Përpara sesa të fillojmë, dëshiroj t'ju pyes lidhur me

15 përditësimin e kohës që do ju duhet për të bërë pyetjet për

16 dëshmitarin? E di që Mbrojtja e Selimit e ka ulur kohën që do

17 i duhet për t'i bërë pyetje dëshmitarit në 30 minuta. Nuk e di

18 në qoftë se ekipet e tjera kanë ndonjë përditësim?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, do jetë

20 mirë që të informoj që do mundohem që të përdor vetëm një orë,

21 shpresoj që do përfundoj sot ky dëshmitar. Nuk më duket sikur

22 do më duhet më shumë kohë sesa kaq, megjithatë në qoftë se do

23 jetë e nevojshme do bëj një kërkesë në emrin tim sa i takon

24 mundësisë për të vazhduar më tej të hënën.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës edhe ne mendojmë

1 që na duhet një orë.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne na
3 duhet pak a shumë dy orë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është e
5 mundur që të jetë dëshmitari tjetër në pritje?

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk është problem. Dëshmitari
7 është në pritje. Kështu që, nëse do të jetë e nevojshme, do të
8 mund të vijë sot.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po gjithashtu
10 duhet të siguroni që dëshmitari mund të jetë i disponueshëm
11 edhe të hënën.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk është problem. Është i
13 disponueshëm dhe të hënën.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le ta sjellim
15 dëshmitarin në sallë.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Përpara sesa të sillen
17 dëshmitari në sallë, dëshiroj të them diçka lidhur me dy
18 dokumente. Është dokumenti që i është caktuar numri provizor i
19 provës P1762 dhe përkthimi në anglisht i faqes, i ballinës, i
20 faqes kryesore, që është U001-0041, që janë përgatitur dhe
21 janë nxjerrë dje në paketën e nxjerrjes 1466.

22 Dëshiroj që të them, që ky dokument është në listën e
23 provave të Prokurorisë dhe do të shtohet në dokumentin që ka
24 marrë numër MFI dhe do të pranohet në prova. Edhe ky do jetë
25 prova P1762. Mund të jetë provë publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
2 kundërshtim për këtë gjë?

3 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Kërkesa jote miratohet dhe do heqim numrin e provës provizore
6 dhe caktojmë numrin e provës normale për këtë dokument.

7 Tani, Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
10 Dëshmitar.

11 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
13 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj që ju lutem përgjigjuni
14 pyetjeve shkurt, qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk
15 e kuptoni një pyetje të caktuar mund t'i kërkonit Avokatit
16 Mbrojtës përkatës të përsërisë pyetjen ose mund t'i thoni atij
17 që nuk e kuptuat pyetjen dhe pala përkatëse do të mundohet të
18 sqarojë më tej atë. Po ashtu, na thoni se cila është baza e
19 njohurive, fakteve, rrethanave për të cilat do të pyeteni.

20 Ju kujtoj se jeni ende nën detyrim të thoni të vërtetën
21 sikurse e deklaruat dhe në betimin solemn. Ju lutem, po ashtu
22 mos harroni që të flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej
23 pesë sekondash përpara sesa t'i jepni përgjigje pyetjes dhe
24 flisni ngadalë për hir të përkthyesve.

25 Nëse e shihni të nevojshme që të bëni pushim, na e bëni

1 me dije këtë gjë.

2 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
4 Gjykatës.

5 DËSHMITARI: Nuredin Ibishi [Vijon]

6 Pyetje nga znj. D'Ascoli: [Vazhdim]

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

8 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

9 PË. Mirëmëngjesi.

10 PY. Jam thuajse në fushën, në pjesën e fundit të pyetjeve për
11 ju. Dëshiroj të filloj me një dokument.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I kërkoj Sekretares të paraqesë
13 në ekran dokumentin SPOE00119155 deri në 001191564. Më duhet
14 konkretisht faqja SPOE00119159 e këtij dokumenti. Për
15 versionin në anglisht përkthimi mban numrin SPOE00119159-ET.

16 PY. Dëshmitar, ndërkohë që shfaqet ky dokument në ekran, mund
17 t'ju them që ky është një dokument që ZPS-ja ka marrë nga
18 Gjykata Themelore e Prishtinës brenda materialit në çështjen
19 Latif Gashi dhe të tjerët.

20 Siç mund ta shikoni është një organigramë që tregon
21 formacionin, formimin e brigadës së komandës së UÇK-së. A jeni
22 i njohur me përmbajtjen e kësaj diagrame, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. A mund të na thoni se çfarë përfaqëson kjo tabelë?

25 PË. Kjo tabelë përfaqëson strukturën e organizimit të

1 brigadës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, konkretisht ato
2 çka dhe ne e kemi apliku, pra, në Zonën Operative të Llapit.
3 PY. Ju thatë që e njihni këtë organigramë. Kur e keni parë më
4 herët sesa t'jua tregonim ne në seancën përgatitore?

5 PË. Nuk jam i sigurtë për kohën por, normal, me postin e di
6 që, me postin e marrjen të komandantit të Brigadës 152 Zahir
7 Pajaziti e kemi pas. Kjo ka të bëjë me në gusht të vitit 1998
8 dhe ju kam referue dhe çështjes së organizimit, nëse nuk gaboj
9 unë, pasi që ka qenë si referencë mënyra e organizimit apo
10 strukturimit të njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

11 PY. Ju thatë që e keni përdorur këtë dokument. Si ju është
12 përcjellë juve ky dokument?

13 PË. Nuk jam i sigurtë ngase çdo herë përcjellja e
14 dokumentacionit ka shkuar nëpërmes komandantit të zonës. Ashtu
15 që, nuk kam njohuri sesi ka ardhë ky dokument, pasi që
16 komandanti i zonës ka qenë kompetent për kontakte me Shtabin e
17 Përgjithshëm.

18 PY. E kuptoj. A doni të thoni që e keni marrë këtë dokument
19 nga komanda e zonës së Llapit?

20 PË. Po.

21 PY. Mendoj që na thatë që në atë kohë ju keni qenë komandant
22 i Brigadës 152, a e kam saktë që kjo mund të ketë ndodhur diku
23 nga nëntori ose dhjetori? Ose nëse nuk ka qenë kjo periudhë
24 kohe, ju lutem, na e thoni pak sepse dje na shpjeguat kohën
25 kur ndodhi ndryshimi i numrave të brigadave.

1 PË. Jo. Fillimisht kam qenë komandant i Brigadës 151 dhe aty
2 kam mbet. Mandej, në mandatin tim ka qenë Brigada 151. Më vonë
3 është shndërruar në Brigadën 152. Sikur thashë, me
4 pozicionimin në vijën e parë të magjistrales edhe aty ka ardhë
5 deri te ndryshimi i emërtimit nga 151 në 152. Pra, fillimisht
6 jam emëruar dhe kam mbet komandant i Brigadës 151 Zahir
7 Pajaziti.

8 PY. Unë po mundohesha t'ju pyesja lidhur me kohën kur ju
9 thatë që e keni marrë këtë dokument, domethënë, pyetja kishte
10 të bëhnte me faktin se kur e keni marrë këtë dokument në çfarë
11 periudhe, në çfarë kohe. Nuk e di në qoftë se mund të na thoni
12 ndonjë gjë lidhur me këtë?

13 PË. Nuk mund t'i referohem saktësisht, mirëpo momentin që e
14 kam marr unë kam filluar ta bëj, domethënë, strukturimin e
15 brigadës. Pasi që brigadat në muajin korrik kanë qenë
16 strukturimi i njësiteve në nivel të kompanive ka bë. Ndërsa në
17 gusht ka filluar strukturimi në nivel të brigadave. Kjo duhet të
18 jetë mbas gushtit të vitit 1998. Nuk jam i sigurtë për kohën
19 kur e kemi marrë këtë organogram apo strukturën organizative.

20 PY. E kuptoj. Ju thatë që e keni marrë përmes zonës së
21 komandës së Llapit. Nga kush e keni marrë konkretisht nga
22 komandant Remi, nga komandant Daja, nëse ju kujtohet, a mund
23 të na e thoni?

24 PË. Jo, s'më kujtohet fare.

25 PY. Në rregull. Kopje që keni marrë ju, a kishte të njëjtën

1 vulë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së sikurse është rasti
2 në kopjen që keni përpara në ekran?

3 PË. Sa kam mbajtur unë mend, po, kjo vulë është.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani të kalojmë një faqe më
5 përpara te dokumenti në origjinal që është SPOE00119158.

6 Ndërkohë që për versionin në anglisht është dokumenti
7 SPOE00115511-ET.

8 PY. Dëshmitar, në ekran kemi një formular tjetër, një
9 shabllon tjetër, një organigramë tjetër. A mund të na e
10 shpjegoni ju lutem se çfarë është kjo organigramë?

11 PË. Kjo është formacioni i një komande të apo komande të një
12 zone operative, pra, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

13 PY. A e njihni këtë dokument, a e keni parë më përpara këtë
14 dokument?

15 PË. Po.

16 PY. Përsëri, a mund të na e thoni se kur e keni parë dhe në
17 çfarë rrethanash e keni marrë këtë dokument?

18 PË. Njëjtë deklaroj sikur te struktura organizative e
19 brigadës. Nuk më kujtohet koha dhe nga kush e kam marrë, por e
20 di që e kam pas këtë, e kam pranuar edhe kam punuar konform
21 kësaj disa modifikime. Kështu që njëjtë sipër qasja ndaj
22 dokumentit të parë, gjegjësisht, organigramës së brigadës vlen
23 edhe për organigramën e formacionit të komandës, të një
24 komande të një zone operative.

25 PY. Edhe këtë e keni marrë përmes komandës së Zonës Operative

1 të Llapit?

2 PË. Po ajo ka qenë e vetmja mundësi, pasi që i vetmi kontakt
3 kanë qenë me Shtabin e Përgjithshëm përmes komandantit të
4 zonës operative.

5 PY. Kopja që keni marrë, a ka pasur të njëjtën vulë që ka
6 qenë e ngjashme vula me të njëjtën vulë që shikoni në
7 formularin që keni në ekran, Dëshmitar?

8 PË. Sa mbaj mend, po.

9 PY. Këtë dokument a e keni marrë në të njëjtën kohë siç keni
10 marrë edhe dokumentin që pamë më përpara që ishte formacioni i
11 zonës?

12 PË. Më duket se po.

13 PY. A keni pasur kopje tuaja të këtyre dy dokumenteve me të
14 cilat punonit?

15 PË. Po.

16 PY. Pra, të këtyre dy strukturave organizative keni pas kopje
17 tuajat?

18 A ju kujtohet që juve ju kërkua që këto kopje t'i jepnit
19 gjatë seancës -- t'i sillnit me vete gjatë seancës përgatitore
20 me ZPS-në?

21 PË. Po, unë këto i kam marrë me vete. I kam në posedim
22 personal. Nuk e di dhe ju kam parashtrë juve, pra, në momentin
23 kur kam marrë si material pune për të rikujtuar gjatë fazës
24 paraprake që e zhvilluam ditëve të kaluara që me ju prezantue
25 strukturën, pozicionet e ndryshme. Ehe ju kur e patë ma

1 kërkuat dhe ju thatë, ju referuat se këto dy dokumente që i
2 prezantuar kanë qenë nga një proces i mëhershëm i Gjykatës së
3 Qarkut në Prishtinë edhe plus edhe strukturimi që ka qenë në
4 brigadën time.

5 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Mjafton kaq.

6 Do shohim këto dy dokumente.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja
8 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin 123264 deri në
9 123267. Ndërkohë versioni në anglisht ka të njëjtin numër ERN
10 po përfundon me ET në fund.

11 PY. Dëshmitar, Dokumenti A, është formacioni i komandës i
12 brigadës së UÇK-së, është struktura organizative e formacionit
13 të komandës. Nënshkrimi që është në cep në të majtë të faqes a
14 është i juaj dhe a është kjo një fletë të cilën e keni pas ju
15 si dokument pune dhe të cilën e keni sjellë me vete?

16 PË. Po.

17 PY. A e keni hartuar ju struktura organizative ose
18 organigrama për brigadat e Llapit mbështetur në këtë shabllon
19 që e keni marrë nga komanda e Zonës Operative të Llapit?

20 PË. Po.

21 PY. Kur i keni hartuar ju këto struktura, në qoftë se ju
22 kujtohen?

23 PË. Po kjo ka qenë në një fazë tranzicioni, pra, sikur dhe
24 zhvillimit të komponentëve sikur që thamë nga niveli, pra,
25 togje, domethënë, kompanive sikur që thashë ishin në, pra, në

1 korrik dhe krahas asaj domethënë, postimi në vende të
2 caktuara, domethënë, varësisht prej rrjedhës apo progresit të
3 ardhjes së kuadrove për secilin prej këtyre sektorëve
4 pozicioneve që janë në këtë organigramë. Kështu që ajo ka qenë
5 një them një postim progresiv i personelit në kuadër të kësaj
6 strukture organizative konform kohës.

7 PY. Doni të thoni me këtë që ju i keni përditësuar në
8 vazhdimësi struktura të tilla ndërkohë që zhvilloheshin gjëra
9 në Zonën Operative të Llapit, këtë po thoni, që e përditësonit
10 vazhdimisht?

11 PË. Po, gjithsesi. Nga se ajo u bë nga një procedurë brenda
12 strukturës ku u bënte propozimi nga unë, pasi që kisha
13 mandatin e komandantit të brigadës, për postet e caktuara bëna
14 propozimin te komanda, te komandanti, zëvendëskomandanti edhe
15 ai bënte vlerësimin edhe konfront kësaj bënte edhe postimet,
16 gjegjësisht, vendimet për postim në pozicion të caktuar në
17 kuadër të kësaj strukture organizative.

18 PY. Ku e keni mbajtur këto struktura, këto fletë?

19 PË. Këto i kam mbajtur në kuadër të zyrës time, pra, varësisht
20 prej vendit ku kam pas bazën e qëndrimit, pasi që kjo
21 gjithashtu ka qenë në ndryshim apo në progres, në zyrat e mia,
22 në zyrën time.

23 PY. Ia keni dërguar ndokujt ato?

24 PË. Jo, s'kam pas nevojë t'ia dërgoj. Pasi që vetëm kur kam
25 pas takime në nivel të komandës së zonës, i kam marrë me vete.

1 dhe normal kemi diskutuar për qasje të caktuara rreth
2 plotësimin të vendeve, pra, konform organigramës.
3 PY. Pra, me ç'kuptova ju thatë që nuk ia keni dërguar askujt,
4 domethënë, që nuk ia keni dërguar as komandës së zonës së
5 Llapit?

6 PË. Jo, ja kam dërgue, si jo, se me ta diskutue çështjen e
7 kuadrove për postim. Ato i kam pas me vete dhe ata kanë qenë
8 prej meje të njoftuar lidhur me postimet në vendet e caktuara
9 në kuadër të kësaj strukture organizative. Atë s'e kam bërë vetë
10 unë. E kam bërë në bashkëpunim me komandantin dhe
11 zëvendëskomandantin e zonës e normal dhe të sektorëve të
12 zonës.

13 PY. Në rregull. A ju kuptoj drejt që ju nuk keni dërguar një
14 organigramë konkrete fizike, nuk ia keni dërguar komandës së
15 zonës, e kam fjalën këtu për emërimet, për postet, nuk ia keni
16 dërguar? Ju kuptova drejtë, apo jo?

17 PË. Po unë konform përgjegjësive, fushës së përgjegjësive të
18 mia mvarësisht kam qenë komandant i brigadës që nënkupton në
19 atë fushëveprimin tërësisht nga fundi i dhjetorit kur kam qenë
20 komandant, shef i shtabit të zonës. Pra, unë në atë,
21 mvarësisht prej pozitës, unë normal që i kam dërgue dhe i kam
22 përditësue të dhënat duke i njoftue kompetentët lidhur me
23 ndryshimet aktuale dhe konform kësaj strukture organizative me
24 modifikim apo plotësime eventuale ngase specifika e zonës tonë
25 që përjashton disa.

1 Është çështja e Mbrojtjes Civile që nuk është e pasqyruar
2 këtu, mandej BIA, është edhe çështja e batalionit të mjekësisë
3 që është si e veçantë. Unë i përmenda vetëm tri komponenta që
4 janë jashtë kësaj strukture organizative dhe që në
5 organogramën, tash s'po flas për komandantin e brigadës, po
6 flas për strukturën organizative të zonës, ku janë përditësue
7 me të dhëna. Gjithashtu eshë policia ushtarake dhe në kuadër
8 të brigadave. Okej.

9 PY. Do kalojmë edhe tek kjo pikë për pak. Thjesht për ta
10 sqaruar, kur thoni që keni informuar autoritetet përgjegjëse
11 kompetente. A mund të na e sqaroni kë keni informuar
12 konkretisht? Thjesht po lexoj këtu përgjigjen në transkript.
13 Ndoshta do ishte më mirë që t'jua lexoj të gjithën. Ju thatë:

14 "... unë kam dërguar të dhënat përkatëse të përditësuar
15 duke informuar autoritetet kompetente lidhur me këtë ..."

16 Dhe:

17 "... organigramën me ndryshimet ose me modifikimet
18 përkatëse."

19 Kështu që do ju kërkoja dhe një herë që të më sqaronit
20 kur thoni që ia kam dërguar "autoriteteve kompetente", për kë
21 e keni pasur fjalën, ma sqaroni pak këtë ju lutem?

22 PË. Po komandantit të zonës dhe zëvendëskomandantit të zonës.
23 Dhe unë i kam bërë në bashkëpunim me ta, normal që i kam
24 njoftue.

25 PY. Në rregull. Faleminderit.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë tek faqja 2 me numër
2 ERN123265 te të dyja dokumentet.

3 PY. Dëshmitar, ky është Dokumenti B. Në cep në të majtë a
4 është nënshkrimi juaj ai aty?

5 PË. Po.

6 PY. Ky dokument a është i njëjti si edhe dokumenti që ka
7 pasur ZPS-ja, që ne e diskutuam pak më herët, që mban numrin
8 SPOE00119158, është i njëjti dokument si ai që pamë më herët

9 PË. Mendoj se po. Po me përjashtim të këtyre të vendeve të
10 plotësuar që janë me dorëshkrim.

11 PY. Sigurisht. Ky version i dokumentit që ju e keni sjellë me
12 vete ka pasur edhe disa emra të shkruar me shkrim dore. A mund
13 të na thoni se i kujt është ky shkrimi i dorës, kush i ka bërë
14 këto shënime plotësuese, kush i ka shkruar këto gjërat e
15 tjera me shkrim dore?

16 PË. Ky është shkrimi im.

17 PY. Një pjesë, ca shënime me shkrim dore janë me ngjyrë të
18 zezë ca të tjera me ngjyrë blu. A mund të na i shpjegon pak
19 këto dallimet ju lutem?

20 PË. Ndoshta se kjo ka qenë gjithashtu në zhvillim e sipër apo
21 në progres pi takimeve të ndryshme që kam mbajtur në kuadër të
22 komandës së zonës ku ka qenë komandanti, zëvendëskomandanti
23 edhe, domethënë, komandanti i Brigadës 152 edhe sektorëve. Unë
24 sa e kam pa si material pune ku e kam përditësuar me të dhëna.
25 Ka mund të jetë kjo që është me të zezë, ka mund të jetë

1 ngjyrë blu apo e kaltër, por që me fotokopjim eventual ka mund
2 të bartet në të zezë se kjo është krejt plotësim. Gjithashtu
3 edhe ndërkohë ka ndodhur një ndryshim në organogramë. Edhe atë
4 e kemi plotësue. Por këtë e llogariti sikur një formacion, një
5 strukturë organizative të punës ku i kam marrë të dhënat, pra,
6 në propozimet e ndryshme që kanë rrjedhë nga ai takim për mu
7 orientu më vonë apo për postimet e caktuara, ngase në
8 strukturën organizative të formacionit që është *blanko* apo
9 vetëm me emërimin e pozicioneve pa emra mbiemra të
10 pozicionimit nuk kanë ekzistue brigadat.

11 Tash këtu i keni të listume Brigada 151, 152 dhe 153, që
12 ka të bëjë që këto shënime janë bë, pra, kur kam qenë shef i
13 shtabit, pra, pas vitit, pra, në vitin 1999.

14 PY. Në rregull. Ju e thatë që ky ishte një dokument pune dhe
15 thatë që keni bërë shënime gjatë kohës. A mund të na e thoni
16 konkretisht se gjatë çfarë periudhe ju keni bërë shënimet me
17 shkrim dore duke reflektuar ndryshimet dhe pozicionet e
18 ndryshme? A mund të na e thoni pak a shumë se në çfarë kohe ka
19 ndodhur kjo? Kur keni bërë shënimet me shkrim dore?

20 PË. Kjo është në vazhdimësi, prej momentit kur kam qenë shef
21 i shtabit, flas prej fundit të dhjetorit apo fillimit të
22 janarit deri në përfundim të luftës.

23 PY. E kuptoj. Për shembull, Brigada 153 do jetë shtuar besoj
24 në fillim të vitit 1999 kur u krijua brigada, kështu?

25 PË. Po

1 PY. E kuptoj.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja 3.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Znj. Prokurore, ju kërkoj
4 ndjesë që ju ndërpres, por në përkthimin në anglisht nuk duket
5 sikur reflektohen shtesat me ngjyrë blu në të djathtë, në cep
6 në të djathtë dhe gjithashtu edhe shtesat e bëra me ngjyrë blu
7 nën J-6. Unë e di që dëshmitari e ka nënshkruar këtë në 19
8 tetor. A është e mundur që shtesat të jenë bërë më datë 19
9 tetor? Kjo është pyetja e parë.

10 Dhe pyetja e dytë është kjo: A mund të na jepni një
11 përkthim të plotë të të gjitha ndryshimeve që janë bërë në
12 fletë?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po. Në përgjigje të pyetjes së
14 dytë, po, do t'ju japim një përkthim të rishikuar që
15 reflekton, pasqyron ato ndryshimet e ndryshme në këtë fletë.
16 Do t'i shohim dhe një herë dhe do t'ju japim një përkthim
17 tjetër.

18 Ndërkohë që sa i takon pyetjes së parë do ta pyes
19 dëshmitarin që të na japë sqarime.

20 PY. Dëshmitar, besoj që e dëgjuat pyetjen e Gjykatësit
21 Gaynor. Po jua bëj dhe një herë pyetjen. Kur ju kërkoj ZPS-ja
22 që të sillni dokumentet, që ka ndodhur më datë 18 tetor dhe
23 pastaj kur keni nënshkruar dokumentin më 19 tetor, dokumenti a
24 i përfshinte shënimet që ne i shohim me ngjyrë blu në dokument
25 që janë aty tek BIA dhe ndryshimet edhe komentet e tjera që

1 janë nën BIA-n? Atëherë ju lutem më thoni përgjigjen e kësaj
2 dhe pastaj do të bëj pyetjet tjera më konkrete.

3 PË. Jo, unë nuk po flas me kompetencë se këtu është
4 informacioni i Zonës Operative të Llapit. Pra, unë në atë kohë
5 kam qenë komandant brigade. Dhe nuk -- është jashtë domenit.

6 PY. Ta sqaroj pyetjen. Po, po e sqaroj. Ky dokumenti siç e
7 shohim tani në origjinal në anën e majtë të ekranit është ky
8 dokumenti i saktë që i dhatë ZPS-së?

9 PË. Jo, që e mori ZPS-ja se nuk ia dhashë. Ju e kërkuat.
10 Është ashtu, znj. Prokurore? Këtë dokument ma kërkuat, unë nuk
11 e dhashë. Është ashtu? Gjatë --

12 PY. Po, po.

13 PË. Të jem korrekt.

14 PY. Pyetja ime ishte nëse është i njëjti dokument, me një
15 fjalë, siç dukej kur ju e dhatë me blu?

16 PË. Po. Kështu ka qenë.

17 PY. Siç e shohim tani?

18 Ju kujtohet kur i keni bërë këto shtime, këto shënime
19 shtesë ato me ngjyrën e kaltër?

20 PË. Unë mendoj se këto janë bë kur jam postuar në postin e
21 shefit të shtabit, pra, në fundin e dhjetorit të vitit 1998.

22 PY. Jeni ju që i keni bërë të gjitha ato shënimet me shkrim
23 që shohim në dokumentin këtu?

24 PË. Po. Ky është shkrimi im. Të gjitha këto që, përjashtuar
25 nga kjo, formati apo *blanko*, dokumenti i Shtabit të

1 Përgjithshëm, të gjitha këto çka janë në dorëshkrim janë, se
2 unë e kam lexue, sa e kujtoj, këto janë shënimet, janë
3 shënimet e mia të gjitha.

4 PY. Në rregull.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Besoj se u sqaruat, i nderuar
6 Gjykatës.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen tjetër
9 me numër ERN 123266 në të dy gjuhët.

10 PY. Dëshmitar, është Dokumenti që shikon numër C. Është
11 nënshkrimi juaj në anën e majtë lart?

12 PË. Po.

13 PY. A mund të na thoni përse bën fjalë kjo diagramë apo
14 organigramë?

15 PË. Po kjo ka të bëjë ajo çka me ato adoptimet çfarë janë ose
16 përshtatjet që janë bë konform strukturës organizative të
17 brigadës, pra, të dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm.

18 PY. Pra, është të themi një diagramë më moderne e brigadës,
19 kështu?

20 PË. Kjo është ajo çka në realitet kemi bë, po duke ju
21 përshtatur përherë strukturës organizative të dërguar nga
22 Shtabi i Përgjithshëm, por e modifikuar me veçoritë që i ka
23 pas zonës për të cilat i ceka ma herët. E ka të bëjë me
24 Mbrojtjen Civile edhe çështjen e tjera strukturale që ne i
25 kemi zhvilluar, pra, pas gushtit të vitit 1998.

1 PY. Kush e bëri këtë organigramën? Kush e hartoi?

2 PË. Po këtë organogramë, unë e thashë edhe më herët, që duke
3 ju përshtatur organogramës së dërguar si formë e përgjithshme
4 nga Shtabi i Përgjithshëm, ne e kemi modifikuar konform
5 pozicionimit me emra apo me persona në poste të caktuara edhe
6 në nivel të, pra, strukturës organizative sipas sektorëve edhe
7 në nivel të batalioneve pasi që në atëkohë në gusht, sa mbaj
8 mend, të vitit 1998, ishte urdhri i Shtabit të Përgjithshëm që
9 të kalohet në nivelin e organizimit në nivel të batalioneve.

10 PY. Juve e keni hartuar apo keni kontribuar ju në përgatitjen
11 e këtij organigrami?

12 PË. Po ne e kemi, normal, kemi dhënë kontributin secili,
13 domethënë, komandantët e brigadave. Për çdo herë e kemi bërë në
14 bashkëpunim edhe në miratim nga komanda e zonës, pra,
15 komandanti dhe zëvendëskomandanti i zonës dhe komanda në
16 përgjithësi.

17 PY. Emrat dhe pozicionet që shohim në organigramë a
18 pasqyrojnë rolet apo funksionet e ushtarëve 151 nga sa shohim
19 nga përshkrimet këtu në zonën e Llapit?

20 PË. Po. Tash këta janë eprorë në pozita të ndryshme,
21 domethënë, janë menaxherë në pozicione të ndryshme, nuk janë
22 më ushtarë dhe, pra, reflekton në atë çfarë e kanë zotue në
23 këtë kohë.

24 PY. Vërej se ju jeni vënë në dukje këtu, shënoheni si
25 komandant brigade dhe Arif Muço si zëvendëskomandant. Kjo

1 organigramë a pasqyron pozicionet tuaja në dhjetor apo përpara
2 dhjetorit 1998? Në qoftë se mund ta përcaktoni më saktë
3 periudhën kohore që pasqyron kjo organigramë dhe rolet dhe
4 emrat përkatëse?

5 PË. Kjo ka qenë para dhjetorit të vitit 1998. Po mendoj kjo
6 strukturë me këta emra. Po normal ka qenë në progres të
7 ndryshimeve sipas ardhjes së kuadrove apo edhe fundi i fundit
8 edhe rasteve të ndryshme sikur që janë të apostrofuara këtu.
9 Një ndryshim, për shembull, në vitin 1999, më 15 shkurt, kjo
10 ka ardhur për shkak të plagesës së një komandanti të
11 batalionit. Në këtë rast Batalionit të katërt ka ardhë
12 zëvendësimi i tij për arsye se ai ka qenë i pamundshëm të
13 kryejë funksione nga një komandant tjetër dhe, pra, Ramë
14 Arifaj.

15 Flas nëse shihni strukturën e batalionit të katër nga
16 prej komandantit, pra, që ka qenë në të kaluarën deri në
17 plagosje Ibrahim Demit, pra, është zëvendësue nga -- dhe
18 shkruhet dhe data, nga 15 shkurt 1999 ai ka vazhdu ta kryejë
19 atë funksion.

20 Kjo, këto janë shkru ma vonë këto të dhëna dhe kjo them
21 formë e plotësime edhe pse ka qenë dokumentet për afërsisht
22 sikurse ka qenë struktura e brigadës me ato plotësimet me emra
23 sikur çështja te zona, gjithashtu ka qenë edhe në kuadër të
24 brigadës e përditësime edhe me plotësime me forma të
25 organizimit që ka qenë specifik për zonën e Llapit, po

1 njëkohësisht edhe me emra të pozitive sipas kësaj organigrame
2 me personel.

3 PY. Faleminderit. Ndërsa diskutuam kohën e informacionit që
4 përmban ky dokument, mund të na thoni, të na ndihmoni të
5 kuptojmë se kur është përpiluar konkretisht ky dokument? E
6 shoh që është një organigramë e versionit me kompjuter. Pra,
7 po ju pyes se kur konkretisht është përpiluar?

8 PË. Po kjo është bërë në kohën e pas luftës, kjo formë kështu
9 është në kohën e pasluftës. Ndërsa ajo forma që unë e kam humb
10 s'e kam në posedim, ajo, si me thënë, si material pune edhe që
11 ka qenë në funksion por që kjo reflekton me atë qatë
12 materialin e punës. Pra, ajo më ka humb, s'e kam dhe më ka
13 mbetur vetëm kjo e Zonës Operative të Llapit. Ndërsa kjo është
14 bërë, pra, kjo strukturë është dizajnuar më vonë, por i përket
15 realitetit, pra, me këtë postim të personelit në pozicione të
16 ndryshme, pra, të brigadës.

17 PY. Të kalojmë në faqen e fundit.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Znj. Sekretare, në
19 përkthimin në anglisht tek nënkomandant "Nuredin Ibishi -
20 Leka" nuk e ka shënuar në anglisht edhe ke zëvendëskomandant i
21 brigadës "Arif Muçolli - Profa" nuk është shënuar. Mbase do të
22 ishte mirë që ta bëni ta rishikoni dhe ta plotësoni.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Patjetër do t'ju japim një
24 përkthim të përditësuar.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po e ngre dhe unë një çështje.

1 Në përkthimin në anglisht, nuk e di nëse ka ndonjë
2 rëndësi, po përdorë vijë të ndarë në mes. Nuk e di nëse ka
3 ndonjë rëndësi dhe nuk është një vijë e drejtë si të thuash e
4 pandërprerë, po origjinali është i drejtë.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kur ta rishikojmë përkthimin do
6 ta rregullojmë.

7 Po kalojmë në faqen tjetër të dokumentit ERN 123267 në të
8 dy gjuhët.

9 PY. Është Dokumenti D. Është nënshkrimi juaj lart në anën e
10 majtë?

11 PË. Po.

12 PY. A mund të na thoni për çfarë flet kjo organigramë dhe
13 kush e ka dizajnuar, kush e hartuar?

14 PË. Po kjo flet për një organizim të përshtatur të
15 organogramës të pranuar nga Shtabi i Përgjithshëm për Zonën
16 Operative të Llapit me ato specifikat çfarë janë të ndryshuara
17 edhe të adaptuara që janë të përfaqësuara në këtë personel.

18 PY. Po me sa e kuptoj e keni përgatitur sipas atij modelit të
19 përgjithshëm që diskutuam?

20 PË. Po.

21 PY. Kur është hartuar apo përgatitur kjo organigramë?

22 PË. Ky dizajn është bërë pas lufte, domethënë, në bashkëpunim
23 me komandantin dhe zëvendëskomandantin edhe disa nga anëtarët,
24 pra, për çështje më tepër të formalizimit, them kështu, që
25 sesi pasi që shumë prej dokumenteve kanë humbur edhe kemi

1 dashtë ta përshkruajmë reale çfarë ka qenë edhe pse, sikur
2 patë në atë dokumentin e mëhershëm, ne i kemi pas disa nga
3 këto pozicione çfarë janë tash të pasqyruara me këto plotësime
4 por në një formë më të mirëfilltë që kishte me qenë një
5 pasqyrim i denjë i, pra, i strukturës organizative edhe
6 kompetencave në kuadër të saj, i plotësum me personel
7 përkatës.

8 PY. Ju e përgatitët apo kontribuat në përgatitjen e vet
9 bashkë me zëvendëskomandantin edhe të tjerë?

10 PË. Edhe komandanti, zëvendëskomandanti edhe disa tjerë që
11 s'i mbaj mend.

12 PY. Pra, keni kontribuar edhe ju? Përgjigja është "po",
13 besoj?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe kur thoni "zëvendëskomandant" dhe "komandant" e keni
16 fjalën Kadri Kastrati dhe Rrustem Mustafa besoj?

17 PË. Po.

18 PY. Pra, pozicionet që vihen në dukje ato pasqyrojnë rolet
19 dhe emrat në Zonën Operative të Llapit në çfarë periudhë kohe?

20 PË. Kjo gjithashtu ka qenë progres, tash s'mund t'i
21 referohem, po mund ti referohet fundit të luftës them ashtu.

22 PY. A mund ta ngushtoni, të themi, periudhën, mund ta
23 përcaktoni fundi i 1999 apo mund të jeni më konkret?

24 PË. Po dhe fundi i luftës ka qenë me 12 qershor 1999.

25 PY. E keni fjalën që informacioni është përditësuar së fundi

1 në qershor të 1999?

2 PË. Po.

3 PY. Në rregull.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë
5 çast paraqes dokumentet e ZPS-së, faqet e diskutuara me
6 dëshmitarin, që janë SPOE00119158 dhe 9159 si prova publike
7 bashkë me përkthimet korresponduese në anglisht.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
9 kundërshtim për këtë të dyja, 00119158 dhe 59?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një pyetje për njërin prej
11 tyre për Prokurorinë përpara se të fillojmë pyetjet tone ne si
12 Palë Mbrojtëse.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka njeri
14 tjetër?

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 00119159 dhe
17 001158 pranohen të dyja.

18 PY. Do të kenë numrin si prova materiale P01764. Dhe besoj që
19 duhet të riklasifikohen si publike.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po.

21 Lidhur me kopjet e tjera, kërkoj që numrat ERN 123264
22 deri në 67, prej të cilave Prokuroria paraqet faqet 2 deri në
23 4, 123265 deri në 123267, pranohen në varësi derisa të bëhet
24 përkthimi përkatës të zëvendësohen me numrin si prova kur të
25 bëhet gati përkthimi në anglisht dhe mund të jenë publike.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam ndonjë kundërshtim për
2 t'ju dhënë një numër provizor për momentin, por pyetja ime ka
3 të bëjë me 123265.

4 Lidhur me përditësimet e përkthimeve në ekran. Kemi dhe
5 një gjë tjetër për të thënë kur të na vijë përkthimi i
6 përditësuar që është rreshti në origjinal nga shefi i shtabit
7 e poshtë duket sikur mungon në origjinal prandaj duhet të
8 korrigjohet.

9 Pastaj kutitë që vë në dukje shërbimin mjekësor,
10 shërbimin publik i kanë vijat të ndërprera në origjinal kurse
11 në përkthim janë vija të ndërprera. Unë nuk e di nëse kjo ka
12 ndonjë rëndësi për dëshmitarin por do të ishte mirë që të
13 ishte si në origjinal.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do ta bëjmë ashtu siç duhet
15 nëse ka mundësi teknikisht të futen në një faqe do të ishte
16 mirë. Do t'ju japim përkthimin e rishikuar sipas konstatimeve
17 që ju bëtë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Katër faqe
19 ERN 123264 deri në 267 do të shënohen, do t'u jepen numra
20 provizorë.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Numrat që do t'u jepen këtyre
22 materialeve me numër provizor do të jetë numri P01765.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

25 PY. Kaq kisha unë pyetje për t'ju pyetur, Dëshmitar.

1 Faleminderit për vëmendjen.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
3 Gjykatës. I përfundova pyetjet e mia.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti i
5 parë që u paraqit është pranuar, duhet të riklasifikohet si
6 publik?

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, duhet të riklasifikohet si
8 publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere ashtu
10 të bëhet.

11 [Mikrofoni çaktivizuar].

12 Duhet të filloni kundërpjetet. Jo, ju kërkoj ndjesë.
13 Është z. Laws, Mbrojtësi i Viktimave.

14 Z. LAWS: [Përkthim] A mundet të diskutoj diçka në mungesë
15 të dëshmitarit? Kam një parashtrim të shkurtër për të bërë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nxirreni
17 dëshmitarin nga dhoma. Do të bëjmë një pushim të shkurtër,
18 Dëshmitar. Dhe do të ktheheni së shpejti.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Përpara kësaj, tani që dëshmitari
21 nuk është këtu, a mund t'i bëj pyetje Prokurorisë?

22 Prova P1765, me numër provizor është faqja 123265 ka të
23 bëjë me pyetjen që bëri gjykatësi Gaynor lidhur me ngjyrën e
24 shënimeve.

25 Dëshmitari, kur e ka pyetur Prokuroria dëshmoi - në faqen

1 14 të transkript të përkohshëm, rreshtat 7 deri në 11 - kur e
2 pyetën nëse shënimet ishin bërë në shtator të 1998-s. Dhe
3 kështu doja të pyesja, kështu mendon Prokuroria? Sepse mua më
4 duket se nënshkrimi i 19 tetorit 2024 ka të njëjtën ngjyrë si
5 ato shënime shtesë.

6 Këto janë bërë gjatë seancës përgatitore apo nuk ka
7 ndonjë qëndrim për këtë çështje sepse unë do t'i bëj pyetje.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju jeni të lirë që të bëni
9 pyetjet tuaja sepse pasi Gjykatësi më pyeti mua për ta sqaruar
10 me dëshmitarin, unë mendova se u bë e qartë që ai tha që i ka
11 bërë ai në një periudhë kohe jo tani.

12 Nuk e kam referencën e saktë të transkriptit, por kështu
13 ishte.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] E di që tha, por po të shikosh
15 faqen është e njëjta bojë. Dhe unë do të pyes për këtë sesi
16 një fotokopje në bardh e zi e një dokumenti të bërë në 1998 ka
17 shënime me bojë blu të cilat janë bërë në dhjetor të 1998. Do
18 ta shtjellojë më tej.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere ashtu
20 bëni.

21 Ka njeri ndonjë pyetje tjetër?

22 Kështu në këtë mënyrë do të keni se çfarë të pyesni.

23 Z. Laws, mund të bëni parashtrimin.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Ju e keni njoftimin e 18 që përcakton
25 pozicionin tonë. Neve nuk kemi asnjë kundërshtim lidhur me

1 kundërshtimin e Mbrojtjes. Unë dua ta pyes lidhur me dy
2 dëshmitarë.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Përpara këto janë çështje që dhe ne
4 donim t'i ngrinim. Në qoftë se z. Laws do të flasë dhe
5 shpjegon arsyet për këtë njoftim, atëherë mbas kësaj do të
6 doja dhe unë të flisja.

7 Z. LAWS: [Përkthim] Praktika deri tani, nuk e kam si
8 kritikë, ka qenë që njoftimet të bëheshin me shkrim dhe
9 kundërshtimet të bëhen me shkrin që ju, i nderuar Gjykatë dhe
10 kolegët tuaj, të jeni në pozitë të gjykoni për ato që
11 vendosni, siç keni bërë, pa parashtrime me gojë.

12 Unë e di që këtë pjesë do ta bëjmë në seancë publike
13 mbase do të na duhet të futemi në seancë të mbyllur. Por
14 qëndrimi i Mbrojtësit të Viktimave përcaktohet në paragrafin 7
15 lidhur me këtë dëshmitar, W04758.

16 Intervistat e tij kanë të bëjnë me dy viktima që janë
17 pjesëmarrëse në proces dhe ai ka dëshmi me rëndësi për të
18 dhënë lidhur me të dy këta dëshmitarë. Ai i ka njohur të dy
19 ata dhe ky dëshmitar ka qenë i pranishëm në vendin ku ata janë
20 ndaluar të dy. Dhe lidhur me të dy viktimat pjesëmarrëse
21 dëshiroj të eksploroj disa nga rrethanat e ndalimit të tyre
22 për të cilat ky dëshmitar mund të dëshmojë. Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
24 përgjigjeni.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk është një kundërshtim në

1 vetvete. Po të ishte i tillë do ta kishim bërë me shkrim. Ka
2 të bëjë me zhvillimin e procedurës, vërtetë në paragrafin 7
3 vihet në dukje se bëhet fjalë për dy viktimë. Shqetësimi im
4 është që mënyra si është formuluar siç sugjerohet duket sikur
5 do ta vënë në diskutim dëshmitari. Pra, vihen në dukje
6 diferencat midis viktimave, çka thanë viktimat dhe ç'thotë ky
7 dëshmitar.

8 Ne nuk jemi kundërshtim të eksplorojmë pyetje për atë që
9 di dëshmitari, po nuk është detyrë e Mbrojtësit të Viktimave
10 të kundërshtojë kredibilitetin e dëshmitarit.

11 I cili është thirrur nga Prokuroria si dëshmitar që do
12 thotë të vërtetën. Ai mund të pyetet për të gjitha aspektet.
13 Pra, nuk është përcaktuar ndonjë armiqësi nga ana e tij. Pra,
14 nuk ka pse Mbrojtësi i Viktimave të atakojë një dëshmitar që
15 është thirrur nga Prokuroria.

16 Thjesht dua të vë në dukje se nuk ka pse ta diskreditojmë
17 dëshmitarin. Sepse gjithçka që i është vënë në dukje në
18 vendimin tuaj nuk ka pse të diskutohet.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam synim të diskreditoj
20 dëshmitarin. Dallimet në lidhje me rrëfimin, dëshminë e tij ka
21 të bëjë apo jepen nga ky dëshmitar bazuar në informacionin që
22 i kanë dhënë atij të tjerët. Nuk do të jetë, nuk shtrohet
23 çështja për ta diskretitur, përkundrazi për t'i bërë disa
24 pyetje lidhur me besueshmërinë e informacionit që atij i kanë
25 dhënë i cili është shumë i ndryshëm nga dëshmia që personi në

1 fjalë i ka dhënë ka dhënë.

2 Kjo është e gjitha. Nuk bëhet fjalë për diskreditim.

3 Së dyti, lidhur me një çështje më të përgjithshme, më të
4 gjerë që ngrihet që z. Dixon e quan si një pikë të
5 rëndësishme. Mendoj që, me të cilën neve nuk pajtohemi, mendoj
6 që nuk është me vend që ne si Mbrojtës të diskreditojmë një
7 dëshmitar. Unë i përcaktova arsyet pse dua ta pyes, por nuk ka
8 asgjë në urdhrin tuaj lidhur me zhvillimin e procedurave qoftë
9 edhe në ligj ku thotë, thuhet që Mbrojtësi i Viktimave nuk
10 mund t'i bëjë pyetje një viktime sipas rastit me lejen e
11 Trupit Gjykues për të trajtuar një çështje të besueshmërisë së
12 një dëshmitari.

13 Nuk është çështja për luajtur në një farë mënyre një lojë
14 si të thuash tërhiq andej, tërhiq këndeje me Prokurorinë në
15 interes të viktimës dhe të Prokurorisë. Puna është që të bëjmë
16 pyetjet që të mos mbivendosen dhe ne mendojmë se është
17 plotësisht e përshtatshme për ne, gjatë kohës që ne
18 përfaqësojmë viktimën, të ndjekim atë që mendojmë se duhet
19 bërë.

20 Pra, në qoftë se neve, nuk ka kuptim, në qoftë se ne do
21 të bënim pikërisht ato që bën Prokuroria dhe të mos shprehim
22 mendimet tona.

23 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për momentin
25 po e lëmë kështu, do ta vendosim çështjen në të ardhmen.

1 Kërkesa juaq për të pyetur dëshmitarin qëndron.

2 Z. LAWS: [Përkthim] A mund të ngre një çështje në seancë
3 private, ju lutem.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në seancë
5 private.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë publike.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
23 vazhdoni, z. Laws.

24 Z. LAWS: [Përkthim]

25 PY. Z. Ibishi, sikurse mund ta dini unë jam Mbrojtësi i

1 Viktimave në këtë lëndë gjyqësore. Unë do t'ju bëj pyetje
2 lidhur me dy persona, dy burra të cilët ju të dy i keni njohur
3 gjatë luftës dhe të cilët i keni takuar përsëri kur ata kanë
4 qenë të ndaluar. A e kuptoni këtë, z. Ibishi?

5 PË. Po, e kuptoj.

6 PY. Personi i parë të cilit ne do i referohemi si Personi 1.

7 A e keni të qartë këtë, Dëshmitar?

8 PË. Po, ma shpjeguat në seancën e mbyllur.

9 PY. Faleminderit. Personi 1 është një person të cilin ju e
10 keni njohur që pak a shumë nga fillimi i viteve 1990, nëse nuk
11 gabohem. A është kështu, Dëshmitar?

12 PË. Mund të jetë.

13 PY. Në fakt, ju jeni prej së njëjtës zone, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Më pas ju keni qenë koleg me njëri-tjetrin, apo jo?

16 PË. Jo. Ngase ai ka pas një, sa mbaj mend, ka punu në doganë
17 një kohë, ndërsa nuk e di kohën e kyçjes në polici, pra, më
18 vonë ai ka kaluar nga dogana në polici edhe nuk kam njohuri se
19 kur edhe në çfarë pozite ka qenë.

20 PY. Në rregull. Do ta shtjellojmë pak këtë pas një çasti.

21 Megjithatë ju keni pasur një karrierë goxha të pasur sa i
22 takon organeve të zbatimit të ligjit përpara luftës, apo jo,
23 Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Gjithsesi në një pikë, në qoftë se ose thjesht sa për

1 t'ju rifreskuar memorien, ai u bashkua me forcën policore,
2 domethënë, u bë pjesë e forcës policore dhe ju e keni takuar
3 atë në këtë kontekst. A ju rifreskon memorien kjo gjë,
4 Dëshmitar?

5 PË. Jo, vetëm momenti kur Personi 1 është mbajtur atëherë e
6 kam kuptue se ai po punon në polici. Kam menduar që akoma
7 është në detyrën e doganierit apo në doganë ku ka punue
8 përpara.

9 PY. Në rregull. Atëherë do mundohem që t'jua rifreskoj
10 memorien në një tjetër mënyrë.

11 Z. LAWS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares për këtë që
12 të paraqesë në ekran provën P0177.9. Në versionin në anglisht
13 është faqja 6, ndërkohë që në shqip është faqja 5.

14 PY. Ndërkohë që paraqitet në ekran dokumenti përkatës, më
15 lejoni t'ju them z. Ibishi që ka kaluar shumë kohë që prej
16 atëherë, megjithatë unë do t'ju tregoj përshkrimin që ju keni
17 dhënë lidhur me këtë temë në intervistën me ZPS-në në vitin
18 2019. Nëse do të shikoni tekstin në shqip duke filluar nga
19 rreshti 22 --

20 Z. LAWS: [Përkthim] Kështu që për këtë arsye duhet që të
21 zbresim më poshtë në faqe, në faqen që keni në ekran. Ndërkohë
22 që në versionin në anglisht është nga rreshti 6 deri në
23 rreshtin 11.

24 PY. Unë, Dëshmitar, do lexoj një pjesë të dëshmisë tuaj. Në
25 këtë pjesë, sa për t'ju orientuar, flisni lidhur me kohën kur

1 Personi 1 ka qenë i ndaluar dhe ka pasur biseda lidhur me të,
2 domethënë, sa i takon mbajtjes së tij flitej në atë kohë:

3 "Dhe mesazhi që dua t'ju jap është që përveç faktit që
4 Personi 1 është një zyrtar policor serb kjo nuk do të thotë që
5 personi në fjalë kishte bërë ndonjë gjë të keqe në raport me
6 shqiptarët ose ndaj shqiptarëve sepse, me aq sa kam dijeni
7 unë, ai nuk ka bërë asgjë të keqe ndaj tyre. Ai", ti thua, "që
8 ka qenë një ish koleg i dikurshëm i imi. Ka punuar në dogana.
9 Mandej ka punuar në policinë e Kosovës. Ai ka qenë i shoqëruar
10 me të gjitha komunitetet", thoni ju.

11 A ju kujton kronologjinë ose rrjedhën e ngjarjeve kjo
12 pjesë që sapo ju lexova, Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Faleminderit.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Ky dokument nuk duhet të shfaqet për
16 publikun. Duhet ta kisha bërë të qartë edhe më përpara. Ju
17 kërkoi ndjesë për këtë.

18 PY. Tani, Dëshmitar, ju u pajtuat që ju kujtua kronologjia
19 ose rrjedhja e ngjarjeve lidhur me këtë person. Pra, ai u bë
20 oficer policie ndërkohë që ju vetë keni qenë në polici. Dhe
21 juve, në fakt, keni thënë që ai u emërua dhe si inspektor
22 brenda policisë. A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

23 PË. Po unë nuk mund ta lidhi me kohën ngase unë viteve 1990
24 më kanë largu nga shërbimi në polici. Edhe unë këto të dhëna
25 që, po në kontekst kohës, i kam marrë nga, pra, nga zyrtarët,

1 policia ushtarake që më kanë njoftue lidhur me rastin, pra,
2 dhe për të cilat kam kuptue se është inspektor i policisë.
3 Edhe e kam ditë që ai nuk ka pas një sjellje të keqe si
4 doganier. Por edhe normal me të kam mendue edhe në qarqe në
5 rreth detyrave policore që më thanë që është inspektor i
6 policisë. Po unë përgjithësisht, pasi nuk kam krye detyrat,
7 pra, jam përjashtue nga regjimi okupues i Serbisë në vitet
8 1990 nga policia s'kam qenë pjesë e saj dhe nuk kam ditë
9 rrjedhën sesi është emëru ai. Por nga policia ushtarake më
10 kanë njoftue lidhur me atë se ka të bëjë me inspektor të
11 policisë.

12 Edhe e di që personi sa ka qenë në dogana, por edhe më
13 vonë, sa kam dëgjue pra, se s'e kam dit postin e saktësuar në
14 polici, ai ka pas një komunikim të mirë me qytetarët. Në
15 kuptim të asaj që nuk është veçue për shkeljet të caktuara,
16 ashtu sa është dit, ndaj qytetarët e të gjitha komuniteteve.
17 PY. Këtë e bëni të qartë edhe në dëshminë që i keni dhënë
18 Prokurorisë nga pjesa që sapo lexuam. Ti bile thua që "ai ka
19 qenë një ish-koleg i imi". Unë sikurse e thatë juve,
20 domethënë, pavarësisht që ju jeni liruar nga forcat e
21 policisë, ka pas një periudhë kohe që ju të dy keni qenë
22 oficerë policie dhe mbase për këtë arsye ju atij i jeni
23 referuar si ish-koleg në dëshminë tuaj. A është e saktë kjo,
24 Dëshmitar?

25 PË. Jo, nuk është e saktë. Ngase unë, sa mbaj mend, në kohën

1 kur kam qenë unë zyrtar policor, pra, ai nuk ka qenë në, pra,
2 në polici, pra, ka qenë në dogana. Ndërsa periudha më tej, kam
3 kuptue nga policia ushtarake, se ka qenë inspektor i policisë,
4 mirëpo dhe kam dit nga njohuritë e përgjithshme që punon në
5 polici. Unë sa e di, asnjëherë ai nuk ka qenë koleg në polici
6 në kohën kur unë kam ushtru detyrat policore, sa mbaj mend,
7 pra, deri viteve 1990. Ndërsa keni të dhëna për të se kur
8 është transferu ai nga doganat në policinë, pra, e Kosovës.
9 Unë flas për periudhën deri në vitet 1990.

10 Edhe tash njohuritë kanë të bëjnë me situatën aktuale që
11 po i referohem në bazë të dhënave që m'i ka -- më janë dhënë
12 nga tash, jo policia ushtarake, por nga Hyzri Talla, ai më ka
13 njoftue për lidhur me rastin edhe kam marrë informacione se ka
14 të bëj me një zyrtar, me një inspektor policie me emrin po A
15 apo 1 si e apostrofuat.

16 PY. Në rregull.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Të kalojmë më poshtë në të njëjtën
18 faqe, në rreshtin 20 në anglisht -- jo, tek faqja pasuese,
19 faqja 6. Atëherë rreshti 20, në anglisht dhe në fillim të
20 faqes në versionin në shqip nga rreshti 1.

21 PY. Po flasim përsëri për temën e ndalimit të tij, ju thoni
22 që:

23 "Ai ka qenë pjesë e policisë në strukturën e policisë, ka
24 qenë pjesëtar i policisë serbe dhe vlerësimi ka qenë që ai nuk
25 ka bërë asgjë të keqe ndaj shqiptarëve apo nuk ka bërë asgjë të

1 keqe ndaj tyre, ndaj shqiptareve.”

2 A e keni thënë këtë kur e keni marrë informacionin nga
3 policia ushtarake sa i takon ndalimit të tij, Dëshmitar, për
4 këtë e keni pas fjalën?

5 PË. Po, për këtë. Sa unë e kam dëgju, sa kam pas njohuri.

6 PY. A e dini arsyen pse e kanë ndaluar atë atëherë?

7 PË. Pse ka qenë zyrtar policor i një regjimi okupues serb në
8 Kosovë.

9 PY. Faleminderit. Për këtë arsye i takon që atë e kanë
10 konsideruar, në qoftë se mund të shprehem kështu, një
11 shënjestër e justifikuar, a do ishte një përshkrim i saktë ky?

12 PË. Po ajo është çështje që e kanë vlerësue strukturat civile
13 si të tillë dhe për atë ai është arrestuar.

14 PY. Në rregull. Të shohim bashkë një tjetër dokument.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
16 paraqesë në ekran dokumentin si më poshtë, po jo transmetim
17 për publikun. U008-1625 deri në U008-1625-ET. Në versionin në
18 shqip është U008-1602 deri në U008-16036. Dokumenti në shqip
19 është një dokument i gjatë, megjithatë dua që të paraqitet
20 konkretisht faqja 008-81625, diku nga mesi i faqes në të
21 djathtë.

22 Ndoshta ta zmadhojmë pak më tepër te versionin në shqip.

23 PY. Ky është një artikull i publikuar me datën 23 nëntor
24 1998. Dhe sikurse mund ta shihni, ky është një artikull i cili
25 lidhet me Personin 1, megjithëse emri i tij nuk shkruhet ashtu

1 siç është vërtetë, ka një gabim në shkrimin e emrit. Dua t'ju
2 bëj një ose dy pyetje lidhur me atë çfarë keni përpara.

3 Së pari do ju kërkoja që t'i hidhni një sy artikullit që
4 keni përpara në ekran.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se e thashë që nuk
6 duhet të transmetohet për publikun apo jo? Po ju lutem kijeni
7 parasysh këtë gjë, Sekretare.

8 PY. A e keni parë këtë dokument më përpara, z. Ibishi?

9 PË. Jo.

10 PY. Së pari, dua t'ju pyes a e dini ju se çfarë ka qenë
11 Drejtoria Informative e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

12 PË. Më së pari, nuk ka pas drejtori informative çfarë
13 cilësohet këtu në kuadër të organigramës u kanë sektori
14 informativ i zonës operative. Nëse i referohemi nënzonës.

15 PY. Nuk është e qartë në qoftë se po flasim për Drejtorinë
16 Operative të Nënzonës së Llapit. Këtu thuhet që është
17 Drejtoria Informative e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. A dini
18 ju ndonjë gjë lidhur me këtë institucion, Dëshmitar?

19 PË. Mirëpo këtu cilësohet Nënzona Operative e Llapit e ke në
20 titull atje. Mandej një emërtim që realisht nuk ka ekzistuar në
21 organogramë. Ne nuk kemi pas një drejtori të tillë në kuadër
22 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

23 Tash po kufizohem ngase kjo bie që është komunikatë e
24 Nënzonës Operative të Llapit, sipas kësaj që shihet në titull.
25 Shiqoni titullin, pra, ne nuk kemi pas një drejtori të tillë.

- 1 Ne kemi pas sektorin e shërbimit informativ si sektor të
2 veçantë.
- 3 PY. Në qoftë se do shikojmë artikullin në shqip në titull, në
4 fillim fare, thuhet "Në Nënzonën Operative të Llapit".
5 Megjithatë në qoftë se do të futemi në përmbajtje të këtij
6 artikulli, nuk flitet për diçka që lidhet konkretisht me
7 nënzonën e Llapit. Por filloi duke ju referuar një
8 institucioni që quhet Drejtoria Informative e Ushtrisë
9 Çlirimtare të Kosovës, apo jo, Dëshmitar?
- 10 PË. Po nuk kam pas dëgjim që ku ka qenë kjo drejtori, në
11 kuptimin e asaj, në kuadër të zonës apo dikund tjetër.
- 12 PY. Ju thatë që nuk e keni parë këtë dokument më përpara.
- 13 PË. Jo.
- 14 PY. Po është dukshëm që nuk keni qenë ju që keni nxjerrë një
15 komunikatë ose një njoftim për shtyp lidhur me Personin 1, apo
16 jo, Dëshmitar, nuk e keni bërë ju këtë gjë?
- 17 PË. Unë e kuptova fillimisht që pasi që referohet si titull
18 nga Nënzona Operative e Llapit që ka të bëjë me një komunikatë
19 të nënzonës së Llapit. Edhe kohës që i referohet është 23
20 nëntori i vitit 1998. Unë në atë kohë kam qenë komandant i
21 Brigadës 151 Zahir Pajaziti.
- 22 PY. Do ta bëj edhe një herë pyetjen, Dëshmitar. Ti vetë nuk
23 ke nxjerrë një komunikatë apo një njoftim për shtyp të kësaj
24 natyre, apo jo?
- 25 PË. Jo, se së pari s'ka qenë kompetencë e imja. Unë kam qenë

1 komandant i Brigadës 151 Zahir Pajaziti dhe nuk ka qenë në
2 kompetencë time ta as kjo informata apo një informatë tjetër.
3 Është një e vërtetë se unë kam qenë një prej atyre që në
4 kërkesën të KDOM-it e të OSBE-së edh përfaqësuesit tonë të
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Adem Demaçi, kemi
6 kontribuar që ai të lëshohet nga mbajtja edhe është lirue edhe
7 ka fol fjalët më të mira lidhur me trajtimin e tij në gjatë
8 mbajtjes në Zonën Operative të Llapit.

9 Çështjet çka rrjedhin lidhur me të gjithë këto se çështja
10 mbase informacioni është çështje më tepër e strukturave civile
11 që kanë qenë të lidhura me Mbrojtjen Civile, që e kanë cilësue
12 ndoshta si të tillë. Mirëpo, me kërkesën edhe me konfirmimin
13 tonë, pra, ai është lirue edhe mendoj që edhe kur është
14 deklarue para opinionit, para mediave ka fol fjalët më të mira
15 edhe për trajtim gjatë mbajtjes disa ditore në qendrën e
16 mbajtjes në Llapashticë. Dhe vazhdon të ketë një qëndrim,
17 domethënë, pozitiv lidhur me atë se është -- nuk është. Gjithë
18 kjo u zhvillua në konform, pra, rregullave, gjegjësisht, të
19 nenit 75 të konventave, me protokollit të dytë shtesë të katër
20 konventave të Gjenevës. Edhe për këtë mendoj nuk -- ai
21 absolutisht nuk ka pas asnjë vërejtje në këtë drejtim. Për atë
22 duhet ta konfirmoj.

23 PY. Z. Ibishi, nuk të ndërpreva, por kjo nuk është se të
24 pyeta lidhur me këtë gjë, nuk dua ndihmën tuaj lidhur me këtë
25 që sapo thatë. Trupi Gjykues ka dëgjuar shumë dëshmi që kanë

1 të bëjnë me lirim e Personit 1.

2 Megjithatë dua që t'i kthehem dhe njëherë asaj çfarë
3 përmenda më përpara. Me aq sa keni dijeni ju, ky dokument nuk
4 është nxjerrë nga asnjë prej kolegëve tuaj në Zonën Operative
5 të Llapit? Ju lutem përgjigjuni kësaj pyetjeje me "po" ose me
6 "jo"?

7 PË. Unë s'e kam pa këtë dokument. E s'mund t'i referohem.

8 PY. Ju thoni që nuk e dini se kush ka qenë drejtorja
9 informative e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk e dini se
10 çfarë institucioni ka qenë ky apo kush ka qenë pjesë e këtij
11 institucioni, këtë po thoni, Dëshmitar?

12 PË. Po nuk e di. Ngase unë po flas në kuadër të kompetencave
13 të mia, të kufizohem në kuadër të Zonës Operative të Llapit,
14 konkretisht në postin e komandantit të Brigadës 151 Zahir
15 Pajaziti. Nuk mund të flas përtej kompetencave çka s'më
16 takojnë dhe që s'kam pas ingjerenca për këtë.

17 PY. Ju nuk e dini sesi ndodhi që, gjashtë ditë më pas,
18 Drejtorja Informative e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mëson
19 që është arrestuar Personi 1. Nuk mund të na ndihmoni dot me
20 një përgjigje për këtë me aq sa dëgjova deri tani, apo jo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Jo, nuk mund të ndihmoj ngase korrespondimi im ka qenë në
23 drejtim të asaj që jam njoftue në krejt rrethana të rastit për
24 arrestimin e tij. Edhe e di saktësisht që këtë rast ka qenë i
25 involvuar dhe përfaqësuesi jonë politik Adem Demaçi për

1 lirimin e tij. Edhe në këtë, kjo është gjithë deklarata ime.
2 PY. Po. Dhe ai u lirua pjesërisht sepse ishte i qartë, siç na
3 thatë, se ishte një njeri që nuk i kishte bërë njeriut keq,
4 nuk i kishte bërë shqiptarëve, komunitetit shqiptar dhe se
5 respektohej si njeri, ishte i drejtë me të dy komunitetet dhe
6 një punonjës policie deçent. Dhe kjo është pjesërisht arsyeja
7 pse ishte me vend ta lironit, apo jo?

8 PË. Por do të shtoj këtë, ngase ajo nuk është mvarë arrestimi
9 i tij nga ne. Është mvarë nga informacionet që i ka Mbrojtja
10 Civile lidhur me veprimin e ndryshëm të personave, në këtë
11 rast, të Personit 1 që e përfill se ka ndaluar, arrestuar një
12 si një grup bandit i cili ka kanë kolaboru me armikun.
13 Informacioni i kësaj drejtorie u cilësua si spiun vjen, mandej
14 edhe punëtorët specialist të sigurimit serb kanë vjedhur
15 plaçkitur popullatën shqiptare në fshatrat e boshatisura. Pra,
16 ky ka qenë një dyshim i Mbrojtjes Civile në raport me të.
17 Mirëpo na, ndërkohë derisa është kërku lirim i tij, kemi
18 konfirmue se, domethënë, ato baza ndoshta nuk qëndrojnë apo
19 nuk janë verifikuar edhe për atë është liruar.

20 Pra, mendoj që në këtë, pra, raport asgjë nuk ka diçka
21 çka është e jashtëzakonshme. Pra, në aspektin e mbajtjes së
22 personave ka qenë vendim dhe i zonës që Mbrojtja Civile, pra,
23 ka reague fillimisht për personat që kanë kolaborojnë me
24 armikun apo është një pjesë e strukturave të armikut kanë të
25 drejtë t'i ndalojnë. Ndërkohë që verifikohet dhe tregohet

1 arsyeya e mbajtjes ndërkohë nëse konfirmohet ose s'konfirmohet
2 e tillë ata lëshohen.

3 Pra, krejt kjo është konform të, pra, protokollit 75 edhe
4 87 të protokollit 2 shtesë për Konventën e Gjenevës. Mendoj që
5 këtë drejtim absolutisht nuk ka, nuk shoh diçka çka është mes
6 asaj që është një bazë e dyshimit, pra, nga Mbrojtja Civile
7 prej kajit ka ardhë deri te sjellja e tij edhe ma vonë. Pra,
8 duke ju referuar dispozitave të Konventës së Gjenevës, është
9 konfirmuar se personi, pra, nuk ka të bëjë me atë involvim dhe
10 si i tillë është liruar. Dhe kjo është e tëra.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Laws, përpara se të
12 vazhdoni më tej, nuk dua t'ju udhëzoj se çfarë të bëni, po a
13 mund ta sqaroni me dëshmitarin se për çfarë e ka fjalën kur
14 thotë Mbrojtja Civile apo struktura civile? Do ta vlerësoja.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Me kënaqësi do ta bëj.

16 PY. Ju e dëgjuar Gjykatësin Mettraux atë që më sugjeron, pra,
17 që t'ju pyes për këtë. Çfarë doni të thoni me strukturën
18 civile apo Mbrojtjen Civile për të cilën na thatë se ishte
19 përgjegjëse për ndalimin e njerëzve derisa të vlerësoheshin
20 nëse ishte apo jo ashtu? A mund të na ndihmoni?

21 PË. Po çdo në kuadër të kompetencave të Zonës Operative të
22 Llapit edhe mbrojtjen edhe sigurinë e strukturës, po dhe
23 civilëve që kishin në kuadër të zonave, ne kemi pas
24 përgjegjësi t'i ruajmë nga bashkëpunëtorët e armikut se vite
25 me radhë nga vitet 1990 edhe shërbimi i sigurimit shtetëror

1 apo inteligjencës edhe policia serbe ka filluar të bën një
2 rrjetë bashkëpunimi. Për këtë arsye, është lënë pra, konform
3 asaj çfarë ka qenë vendimi që në kuadër, pra, Mbrojtjes Civile
4 në kuadër të brigadave, kërkesat e atyre pasi q'ata disa
5 persona si të dyshuar për kolaborim me strukturat e sigurisë
6 serbe apo okupatore kanë apostrofuat disa persona edhe
7 procedura ka qenë që të shkoj në përmes komandantit të
8 brigadës, policisë ushtarake deri në qendër të mbajtjes në
9 Llapashticë.

10 Pra, kjo ka qenë ajo procedurë kur ka listuar një bazë e
11 dyshimit për një mundësi e tillë.

12 PY. Z. Ibishi, a do të doja ta përmbledhja qëndrimin tuaj
13 para se të merremi me një individ tjetër. Ju doni të thoni se
14 kishte, ekzistonte një dyshim se Personi 1 mund të ishte
15 përfshirë në veprime të këqija, është sjellë aty, është bërë
16 një farë hetimi dhe është vendosur që s'ka bërë ndonjë gjë të
17 keqe dhe se duhej liruar? Duhet të ishte kjo një përmbledhje e
18 drejtë e asaj që thatë lidhur me Personin 1?

19 PË. Po.

20 PY. Faleminderit. Ju do të pajtoheshit me mua se po të
21 kthejmë sytë pas e të shohim drejtorinë informative, atë që
22 thotë Drejtoria Informative e UÇK-së lidhur me Personin 1 dhe
23 po të shohim paragrafin e dytë, aty thotë që:

24 "Personi 1, person i sigurimit serb, që ka qenë
25 organizatori kryesor i plaçkitjeve në Llap edhe ai është

1 ndaluar.”

2 Kjo na jep një ide tjetër krahasuar me atë që thatë se
3 kishte një dyshim dhe pas hetimit ka dalë i pafajshëm dhe
4 është liruar. Pajtoheni me mua, z. Ibishi, me këtë
5 interpretim?

6 Z. DIXON: [Përkthim] Po e kundërshtoj sepse dëshmitari ka
7 thënë disa herë që nuk e di, nuk e njeh këtë dokument.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet
9 kundërshtimi.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Do t’jua përsëris pyetjen, z. Ibishi
11 apo e kuptuat?

12 PË. E kuptuam. Ju duhet ta dini se në aspektin kur ekziston
13 baza e dyshimit, ne në Zonën Operative të Llapit, nuk kemi
14 pas, pra, organe të hetimit. As kemi pas gjykatësa dhe hetues,
15 as gjykata për të procesuar lëndën.

16 Pra, për ta thjeshtësuar për këtë person ka ekzistuar
17 baza e dyshimit se është involvuar në një rast pati organizimi
18 çfarë këtu po shkruhet. Mirëpo, ndërkohë ne, jo veç në këtë
19 rast, por dhe shumë raste tjera, ne nuk kemi pas për mungesë
20 të gjykatës dhe për mungesë të kompetenca të organeve të
21 hetuesisë na këta persona i kemi liruar që në kohë tjetër, në
22 kohën kur të lirohet Kosova, që ata të mund eventualisht për
23 këto vepra ordinere apo këto si janë përshkruar të jetë një
24 çështje, një gjykimi të mirëfilltë.

25 Ne, pra dhe një here, ne kemi bë vetëm një ndalim të

1 përkohshëm. Ia kemi bërë me dije arsyet pse e ndalojmë. Edhe kur
2 u vlerësue se nuk ka ndonjë rrezikshmëri të lartë edhe një
3 vetëbesim që ai nuk do të veprojë, atëherë e kemi lirue. Kjo
4 është krejt. Pra edhe një here, ne nuk kemi pas organet e
5 rregullta gjyqësore. Ne kemi vepruar më tepër në parandalim.
6 edhe normal kur kemi konstatue se një person është zotue se
7 nuk do të mirret me këto vepra apo me diçka të tillë, atëhere
8 kemi lënë që në një situatë të më vonshme kur krijohen organet
9 e drejtësisë që të procesohet rasti për të cilën ekziston një
10 bazë e dyshimit. Pra, ka mbizotërue një sistem i tillë me
11 qëllim që të ndalohet vala e bashkëpunimit, por të
12 kolaboracionistët edhe gjegjësisht edhe te persona që kanë
13 qenë bashkëpunëtorë të armikut.

14 PY. Faleminderit, z. Ibishi. Nuk po ju ndërpres sepse ka
15 rëndësi që të shpreheni, por shpresoj që pyetja ishte e qartë.
16 Do të përpiqem t'ju bëj dhe një herë. Në qoftë se s'ju vjen
17 keq ta dëgjoni pyetjen.

18 Ju u pajtuat me mua se ka ndodhë kjo, pa asnjëfarë hetimi
19 u vendos se Personi 1 nuk kishte bërë asgjë të keqe dhe se
20 duhej liruar. Dhe pyetja që kam: Pajtoheni me mua se paragrafi
21 që pamë në dokumentin e 23 nëntorit na krijon një ide
22 krejtësisht të ndryshme lidhur me statusin e Personit 1 dhe të
23 fajësisë së tij. Apo jo?

24 PË. Dhe më duket se duhet ta përsëris edhe njëherë. Ne nuk
25 jemi marrë me fajësi ose mos fajësi. Nëse kjo --

1 PY. Më lejoni t'ju ndërpres të mos kthehemi prapë tek
2 procesi. Kjo deklaratë që paraqet dokumenti i 23 nëntorit
3 krijon një ide krejt tjetër, e paraqet situatën krejtësisht
4 ndryshe, pra, një person i ndaluar për dyshime, i miratuar si
5 person i pafajshëm, kjo është një -- dhe i liruar, është një
6 paraqitje e saktë? Kurse kjo që thotë ky artikulli, na jep një
7 ide krejt ndryshe, na paraqet një pikturë krejt tjetër të
8 fajësisë së këtij personi?

9 PË. Jo, nuk flasim tash për fajësi. Fajësinë e vërteton
10 gjyqi. Ne s'kemi pas organe kompetente që të konfirmon. Ka
11 ekzistuar baza e dyshimit në bazë të të dhënave të Mbrojtjes
12 Civile se ky person është involvuar në këto raste, mirëpo këto
13 kanë qenë minore në krahasim me një mundësi tjetër të
14 involvimit. Për këtë arsye ka mbretërue besimi që ai nuk
15 është person i keq, nuk ka pas sjellje të keqe ma herët dhe se
16 ashtu ka qenë referenca për të gjithë ata që janë mbajt që një
17 situatë hipotetike për mëvonshme ata t'i nënshtrohen nëse ka
18 baza dyshimit pasi po foli për fajësi, pafajësi në organet
19 gjyqësore, pra, të vërtetohet se a kanë pas faj për këto vepra
20 apo nuk kanë pas.

21 Ne nuk kemi pas organe të drejtësisë në kuadër të
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që të konfirmojnë fajësinë apo
23 jo. Kjo ka qenë një formë kur ka ekzistuar baza e dyshimit për
24 të diçka dhe ka mbizotërue bindja e opinionit atëherë ai është
25 lirue me qëllim që më vonë, nëse ka elemente të përgjegjësisë,

1 shkon në organet e rregulla gjyqësore. Këta s'e kanë lirue kjo
2 pse është liru ai, nuk e ka liru eventualisht nëse ky apo të
3 tjerë kanë qenë të involvume për vepra inkriminuese apo
4 kriminale apo forma tjera të bashkëpunimit.

5 PY. Po vazhdoj, por desha t'ju jepja një rast që të
6 komentoni. E vërteta është që dikush kishte vendosur të
7 thoshte gënjeshtren ndaj Personit 1 në këtë dokument.

8 PË. S'po e kuptoj.

9 PY. Nuk më kuptoni? Personi që doli që ishte i pafajshëm që
10 sipas policisë ushtarake ishte i drejtë me të dy komunitetet
11 dhe që s'kishte bërë asgjë të keqe, nuk ishte ai njeriu që
12 mendohej se ishte organizatori kryesor i plaçkitjeve në Llap.
13 Dikush ka treguar, ka thënë një gënjeshtër për të, apo jo?

14 PË. Jo, ju lutem po bini situata përsërisë për sajten herë.
15 Ne nuk kemi pas organe të hetuesisë, gjyqin. Kanë qenë baza e
16 dyshimit se ky person mund të jetë involvuar në këto raste
17 çfarë janë të përshkruara si bazë e dyshimit, është sjellë
18 aty. Ne nuk ia heqim fajësinë eventuale të tij. Ne e kemi lënë
19 këtë çështje në situatë hipotetike të mëvonshme kur të
20 krijohen organet e rregullta të rendit dhe gjyqësisë që ky të
21 përgjigjet për këtë. Ne në një formë ka mbretërue një besim
22 apo një opinion i përgjithshëm që ai duhet të lirohet ngase ka
23 pas sjellje të mira me komunitetin, nuk është cilësu diçka.

24 Mirëpo, ne nuk e dimë, nuk kemi informacione të sakta
25 lidhur me aktivitetin e tij konkret lidhur me këto raporte me

1 këta grupën e banditëve që kanë kolaboru me armikun. Për këtë
2 arsye po më pyetni diçka inekzistente. Unë them nga baza
3 ligjore edhe e kompetencës, ky person është sjellë nga
4 Mbrojtja civile duke supozuar këtë, këtë, këtë, baza e
5 dyshimit. Ndërsa është mbajtur pas bisedime të gjithanshme me
6 strukturat edhe të përfaqësuesve të Ushtrisë Çlirimtare të
7 Kosovës por edhe pjesëtarëve të Zonës Operative të Llapit është
8 cilësuar se ky ka pas sjellje të mirë sa dihet. Mirëpo nuk
9 lirohet nga përgjegjësia nëse eventualisht në një situatë
10 hipotetike, domethënë, kur të krijohen organet e gjyqësisë që
11 ai të përgjigjet për këto vepra nëse ka pas involvim. Ne nuk
12 kemi gjykuar rastin. Këtu të kuptohemi. Ne nuk jemi marrë me
13 atë drejtësi është i fajshëm apo i pafajshëm.
14 PY. Dhe ju e kuptoni që nuk po flas për ju. Flas për atë që
15 ka shkruar këtë artikull, i cili thotë bardh e zi, qartë pra,
16 se Personi 1 ka qenë njeriu që ka organizuar gjithë plaçkitjet
17 në Llap dhe se nuk kishte bazë për një pohim të tillë. Dhe siç
18 ju thashë, siç ju kam sugjeruar dhe siç ju ftoj të pajtoheni
19 me mua për herë të fundit dikush ka thënë gënjeshtër për këtë
20 person, pra, për Personin 1.
21 PË. Nuk mund të them që janë gënjeshtër apo të vërteta. Ato
22 është çështje e konstatimit të një gjyqi që do të mirret me
23 çështjen e trajtimit të involvimit në këto rrethana çfarë janë
24 ka ekzistuar baza e dyshimit tij. Pra, nuk është te unë ta jap
25 këtë konstatim a është gënjeshtër apo e vërtetë ngase kjo

1 duhet të shkon nëpër proces gjyqësor. Nuk mundet kjo mënyrë,
2 të them, hipotetike apo në formë të pakonfirmuar a është i
3 fajshëm apo i pafajshëm.

4 Por ka mbretëru opinionin se ai duhet të lirohet ngase në
5 bazë të njohurive dhe të rrethanave të jashtme, mirëpo që ka
6 pas sjellje të mira, nuk ka pas sjellje diskriminuese, por nuk
7 e përjashton mundësinë e një involvimi të tillë.

8 PY. Nuk besoj se mund ta çoj më tej këtë diskutim. Dëshiroj
9 që ta paraqit këtë dokument.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
11 kundërshtim?

12 Z. DIXON: [Përkthim] Po, kundërshtojmë. Kemi mocionin, ju
13 keni thënë në mocionin e 27 korrikut se ky dokument nuk mund
14 të pranohet sepse nuk është i qartë dhe nuk dihet burimi i
15 këtij dokumenti. Ju thatë me të drejtë që do të ndihmonte
16 kontekstualizimi i tij nga një dëshmitari gjë që nuk ndodhi.
17 Pra, ju e keni ditur këtë gjë dhe prandaj keni mbajtur këtë
18 qëndrim në mocionin tuaj. Pra, në qoftë se mund të sillni
19 dëshmitar tjetër të flasë për kontekstin dhe burimin.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Mund të përgjigjem unë?

21 Burimi i informacionit, siç e kam përdorur unë
22 dokumentin, nuk ka rëndësi fare. Fakti është se një organizatë
23 e quajtur Drejtoria e Informative e UÇK-së është - sipas atyre
24 që them unë - ka thënë gënjeshtër shumë të rënda ndaj Personit
25 1. Dhe kjo është baza e dukshme se po keqpërfaqësojnë faktin,

1 siç thotë ky Dëshmitar, procesi i brendshëm i UÇK-së i kishte
2 dhënë atij, në fakt, e kishte çliruar nga akuzat.

3 Pra, unë nuk jam i interesuar në burimin. Jam i
4 interesuar në faktin, pra, që ky dokument është futur në
5 domenin publik gjashtë ditë pasi Personi 1 është ndaluar, një
6 diçka që quhet drejtorja e informacioni apo informative, e ka
7 thënë këtë.

8 Gjithashtu, dua të shtoj, që nuk është hera e parë që
9 kemi parë një komunikatë apo një deklaratë për shtyp që
10 përdoret për të ndryshuar qëndrimin faktik lidhur me viktimat
11 të cilat unë i përfaqësoj dhe, në emër të tyre, ne themi, se
12 meritojnë të komentohen në fund të kësaj çështjeje.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Me gjithë respektin që kam,
14 qëllimi që kolegu do ta përdorë nuk e ndryshon faktin që s'ka
15 bazë. Ne vazhdojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim që keni
16 mbajtur ju Trup Gjykues kur vendosët që duhet të kemi një
17 dëshmitar që mund të flasë për dokumentin dhe për burimin e
18 tij.

19 Dhe këtu pajtohem me kolegun tim, z. Dixon, që ky
20 dëshmitar e ngatërroi edhe më tepër origjinën e dokumentit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i japim
22 një numër provizor dhe do të marrim vendim më vonë.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për të konfirmuar, ka
24 të bëjë vetëm me faqen që është në ekran sepse shqipja është
25 një dokument më i gjatë?

1 Z. LAWS: [Përkthim] Dua vetëm pjesën që është nga gazeta.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo pjesë do të ketë
3 numrin V8, pra, është shënuar për identifikim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

5 Z. LAWS: [Përkthim]

6 PY. Së fundi, z. Ibishi dua t'ju bëj dhe disa pyetje për
7 Milovan Stankovic dhe me siguri ju kujtohet?

8 PË. Po.

9 PY. Ai ka qenë një rojtar pylli. Dhe në 2 gusht 1998 është
10 ndaluar dhe ndodhi që juve ishit aty në atë kohë kur atë e
11 sollën aty, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe ju e njihnit njeri-tjetrin sepse e kishit takuar në
14 shtëpinë e vëllait për shkak se vëllai kishte pasur disa
15 marrëdhënie pune me të në lidhje me drunjtë e prerë nga pylli.
16 Ju kujtohet kjo?

17 PË. Kjo është gënjeshtër e pastër.

18 PY. Nuk e njihnit më parë z. Stankovic?

19 PË. Absolutisht. As kam dëgju për të.

20 PY. Vërtetë?

21 PË. Deri në momentin kur e kam takue të arrestuar. Edhe nuk
22 është -- ai ka sulmue pozicionet tona në Potok me armë.

23 PY. Nuk ka rëndësi po thjesht --

24 PË. Jo, ka rëndësi. Ka rëndësi se thoni "e kemi sjellë". Ai
25 ka sulmu pozicionet tona. Nuk është njëjtë. Sikur në një

1 situatë hipotetike ky objekt e ka perimetrin e sigurisë nëse
2 dikush hyn i armatosur në këtë perimetër, ai do të arrestohet,
3 si duhet të bëhet, plus i armatosur.

4 Në asi situatë çfarë ka qenë me uniformë, në situatë
5 stresi të ushtarëve a mund ta dinë është uniformë e ushtrisë,
6 policisë, paramilitarëve. Ai ka qenë me uniformë, ka qenë me
7 armë në dorë. Çka tjetër duhet? Duhet ta ledhatoj. Ai ka pas
8 një fat shumë që ka shpëtue. Po.

9 PY. Z. Ibishi?

10 PË. Po.

11 PY. Më lejoni t'ju ndërpres sepse po ecën shumë përpara.

12 PË. Jo, s'po eci por po ju përgjigjem. Nëse ai është sjellë,
13 nuk është sjellë por personi ka sulmuar pozicionet tona në
14 Potok dhe i armatosur. Ai është arrestue në mënyrë flagrante
15 dhe ka pas fatin që ka qenë një përmbajtje në aspektin e
16 reciprocitetit e përdorjes të armës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
18 Dëshmitar.

19 Vazhdoni.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Kam dhe nja dy pyetje për atë. Po që
21 ta kuptoni, nuk kisha parasysh asgjë tjetër kur thashë" e
22 sollën aty, vetëm se faktin që e kishin arrestuar diku dhe "e
23 sollën aty" dhe ju qëlluat, ishit aty. Kaq kisha parasysh. Nuk
24 sugjerova asgjë tjetër. Që ta keni të qartë.

25 PË. Ai ka sulmu pozicionet tona. Domethënë, të kuptohemi. Për

1 atë si po jam i qartë. Ne s'kemi shku ta arrestojmë atë apo
2 diçka. Po ai na ka sulmu neve.

3 PY. Po, ta shohim këtë. Ju nuk ishit i pranishëm në çastin
4 kur ai është ndaluar dhe ju mbështeteni në atë që ju kanë
5 thënë ushtarët që e kishin hasur në pyll dhe që e kishin
6 arrestuar, kështu?

7 PË. Jo. Dhe ju po shtoni që kanë hasur. Po unë e kam raportin
8 prej eprorit të njësitit, pra, që ai ka sulmuar pozicionet
9 edhe është arrestuar e sjellë. Ai është sjellë në Bajgorë, ku
10 unë në atë kohë kam qenë në stërvitje me një gjeneratë
11 kadetësh edhe jam takue drejtpërdrejt në sjellje të tij në
12 kazermë të Bajgorës.

13 PY. Po. Ta bëj të qartë. Ato që thatë ju lidhur me arsyen pse
14 ai është arrestuar mbështetet në fjalët, në raportimet që u
15 kanë bërë ushtarët, a nuk është kështu?

16 PË. Jo ushtarët, po eprori i pikës, komandanti i togut.

17 PY. Në rregull. Dhe juve ju kanë thënë se ky pylltar, rojtar,
18 që ishte në atë kohë 49 vjeç duhet të ketë qenë, kishte
19 sulmuar vetë ai një pozicion të UÇK-së ku ishin katër burra të
20 armatosur me armë automatike kurse ai ishte armatosur vetëm me
21 një pistoletë. Kjo është, pak a shumë, përmbledhja e atyre që
22 u thanë, që u raportuan, kështu?

23 PË. Ashtu është.

24 PY. Nga pikëpamja ushtarake, nuk ju duket ju një veprim i
25 arsyeshëm të themi që një roje pylli të bënte atë që bëri?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Ai nuk është ekspert. Është thjesht
2 dëshmitar fakti.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet
4 kundërshtimi.

5 Z. LAWS: [Përkthim]

6 PY. Pra, nga pikëpamja ushtarake nuk ju duket si një veprim i
7 pranueshëm, madje i arsyeshëm për t'u ndërmarrë nga një njeri
8 në këto kushte?

9 PË. Unë po ta përshkruaj një situatë hipotetike. Në këtë
10 objekt ku jemi perimetrin e sigurisë, nëse dikush futet i
11 armatosur brenda këtij perimetri, sigurimi si duhet të sillen
12 në raport me të? Njëjtë edhe me rastin e tij. Ai ka hy në
13 zonën që e ka dit fort mirë që janë pjesëtarët e Ushtrisë
14 Çlirimtare të Kosovës. Ka hy atje i armatosur, se kam
15 raportet, krejt po i referohemi raporteve, se unë s'kam qenë
16 në vendngjarjes. Më kanë informue se ai ka hy në pozicionet
17 dhe ka nxjerrë armën dhe këta e kanë arrestue në flagrancë.

18 Çka tjetër përtej kësaj? Si është dashtë të sillet me të
19 edhe në një situatë stresi, kur dikush të vijë a mund ta
20 dallosh se është uniformë sidomos krejt laramani në uniformat
21 që kanë pas regjimi okupues serb pej policisë uniforma të
22 ndryshme kjo ushtria, armata, mandej forcat paramilitare. Edhe
23 ku është ditë është një apo ma shumë në pjesën e malit.

24 Për këtë arsye unë mendoj që ata kanë veprue drejt. E
25 kanë arrestue edhe e kanë sjellur në objektin e kazermës për

1 mbajtje. Çka duhet tjetër të bësh në një situatë të tillë
2 sipas jush?

3 PY. Do t'jua bëj edhe një herë pyetjen. Nga pikëpamja
4 ushtarake, nuk ju duket një veprim i arsyeshëm për t'u
5 ndërmarrë nga një rojtar i tillë 49 vjeçar?

6 PË. Në po ju them se ata kanë veprue drejt në bazë të asaj që
7 më është raportue se kam gjet gjendjen si ma kanë përshkru
8 gjendjen faktike. Si ju, çfarë ideje keni ju që është dashtë
9 ndryshe të veprohet?

10 PË. Në rregull. E keni ndjekur dëshminë e z. Stankovic, ju ka
11 qëlluar kur e ka dhënë këtu në Gjykatë?

12 PË. Po ndoshta pjesë-pjesë. S'e mbaj mend me shumë sekuenca.
13 Edhe të lutem për atë gënjeshtër që ju e keni përcjellë,
14 gënjeshtër e tij se vëllau im është marrë me prerje druri, në
15 çka e bazoni atë gënjeshtër të tij? Ai trillon. Nuk është vetë
16 për ta thënë. Të lutem nëse ke prova thuaj e jo pse ka thënë
17 Stankovic. Vëllau im asnjëherë s'është marrë me çështje të
18 transportit apo tregtimit me dru apo diçka tjetër. Dhe
19 absolutisht s'kam pas kurrfarë njohurie lidhur me të. Të lutem
20 a ki, a keni baza apo vetëm në bazë të deklaratave që i
21 referohet deklaratave të Stankovic.

22 PY. Po ju bëj nja dy pyetje dhe do të mbarojmë në kohë për
23 pushimin. Do t'i referohem transkriptit në faqen 5005, i 19
24 qershorit 2023 dhe citimi fillon në rreshti 16. Ja ç' tha z.
25 Stankovic:

1 "Kur arrita aty, befas mu fanepsën katër burra me armë
2 automatike. Unë ngrita krahët. Ata m'u afruan. Më zunë sytë,
3 m'i mbuluan sytë dhe më lidhën duar mbas shpine ..."

4 Kjo është ajo që tregoi ai kur e arrestuan. E keni parë
5 këtë pjesë ju në dëshminë e tij, z. Ibishi?

6 PË. Jo, s'e kam pa.

7 PY. Pyetja e fundit. Mendoni se mund të ishte e mundur që
8 ndryshe nga rrëfimi dramatik që ju kanë dhënë njerëzit tuaj
9 për arrestimin e tij, a mendoni se mund të jetë e mundur që ka
10 qenë në një farë mënyre e ekzagjeruar ajo që ata bënë për t'u
11 dukur më heroike, pra, kur arrestuan këtë 49 vjeçar, rojën?

12 PË. Unë s'mund ta cilësoj heroike. Ata kanë krye detyrën e
13 vet. Kjo është deklarata e Stankovic që s'mund as ta marrë të
14 vërtetë apo të pavërtetë. Është çështje çfarë i referohet. Unë
15 e kam marrë raportin nga eprori i njësitit që ka qenë aty i
16 pozicionum. Dhe sipas mendimit tim dhe në bazë të përshkrimit
17 të tij, mendoj që ka veprue drejt.

18 Ndërsa aspekti tjetër që Stankovic ka deklaruar, ajo
19 është, pra, një deklaratë nga ana e tij dhe mendoj që në këtë
20 drejtim nuk ka pas tejkalim të autorizimit, përveç asaj që ai
21 është sjellë pa përdorim të dhunës, por normal me detyrim për
22 t'u sjellë në objektin e përqendrimit, pra, në kazermë.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Kaq kisha unë. Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Dëshmitar, tani ka ardh koha për pushimin e mëngjesit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 60

1 Kemi gjysëm ore pushim. Në 11.30 do të jeni përsëri këtu. Ju
2 lutem mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë kësaj
3 salle dhe do të shihemi përsëri në orën 11.30.

4 DËSHMITARI: Faleminderit.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi pushim
7 deri në 11.30.

8 --- Pauza fillon në orën 11.04

9 --- Seanca rifillon në orën 11.32

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 uleni.

12 Zonja Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Z. Ibishi, tani do të
15 vazhdojmë me pyetjet nga ekipet e Mbrojtjes. Do të fillojmë me
16 z. Misetic që është avokati i Z. Thaçi. Ju lutem, dëgjojeni me
17 vëmendje.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Z. Kryegjykatës.

19 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Mirëdita, Z. Ibishi, unë quhem Luka Misetic, jam avokati
22 i Hashim Thaçit. Kam disa pyetje për ju. Dua të filloj t'ju
23 bëj një pyetje lidhur me një dokument që ua tregoi znj.

24 Prokurore sot më herët paradite.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë arsye, do i kërkoja

1 Sekretares të paraqes në ekran provën P01764 me numër provizor
2 prove dhe konkretisht dua të paraqitet 123265.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Besoj që numri i provës
4 është 1765, jo numri që thatë ju më përpara.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, keni të drejtë. Të kalojmë te
6 faqja tjetër.

7 PY. Dëshmitar, do flasim lidhur me shënimet në dokumentin
8 origjinal, domethënë janë këto shënime me ngjyrë blu për të
9 cilët ju bëri pyetje edhe gjykatësi Gaynor.

10 Në transkriptimin e përkohshëm të ditës së sotme ju, në
11 përgjigje të pyetjes së Prokurores, në rreshtin 7 deri në 11
12 në faqen 14, thatë që shënimet, përfshirë këtu dhe këto
13 shënimet me -- që kanë të bëjnë me BIA-n në të djathtë në cep
14 të faqes, dhe shënimet e tjerë që ke -- që jepen nën emrin
15 Toni, janë bërë në dhjetor të vitit 1998. A e kam kuptuar
16 drejtë unë këtë, Dëshmitar, apo dëshironi që ta ndryshoni këtë
17 që sapo thashë?

18 PË. Jo ka pas -- ky ka qenë dokument pune që në vazhdimësi ka
19 qenë në progres, në ndryshim, prej takimit në takim, sikur ka
20 -- ka ardh prej idesë në ide, edhe me propozime konkrete për
21 poste e caktuara, kështu që nuk mund të flas për një datë
22 konkrete në pyetjen që parashtroi.

23 PY. Mënyra si e kuptoj unë është kjo që pjesët e dokumentit
24 që janë me ngjyrë të zezë mund të jenë shkruar gjatë luftës.
25 Megjithatë, jam konkretisht i interesuar për shënimet që janë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 62

1 me ngjyrë blu. Për shembull, në qoftë se shohim në cep, në
2 krah të djathtë të faqes, duket sikur është në -- me --
3 domethënë, shënimet me blu janë bërë me të njëjtat -- me të
4 njëjtin stilolaps ose me të njëjtin shënjuer që ju keni
5 nënshkruar dokumentin më 19 i dhjeti, i vitit 2024. Domethënë,
6 duket sikur këto shënime me blu janë bërë me të njëjtin
7 stilolaps që ju keni bërë nënshkrimin në cep në të majtë të
8 dokumentit. A është kështu apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Po, po edhe këto të tjerat, me siguri që janë të shkruar
10 brigadat, nëse e shihni në këtë pjesën e shtyllës kryesore --
11 Brigada 151, 152, 153, edhe mbrojtja civile, edhe këto i janë
12 shtue organigramës për në kontekst të kohës më herët. Mandej
13 kur janë fotokopjue, kanë dalë -- ndoshta kanë qenë në -- në
14 ngjyrë blu, [E pakuptueshme] të kaltër, kur janë fotokopjuar,
15 atëherë kanë dalë me ngjyrë të zezë. Kështu që krejt po flas
16 nuk mund t'i referohem kohës saktë se kur janë -- këto shënime
17 kur janë vu këtu -- se këto kanë qenë si material pune në
18 takimet që kemi pas me komandantin e zonës, zëvendës
19 komandantin edhe -- edhe shtabin lidhur me postimet e caktuara
20 --

21 PY. Në rregull.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem
23 zmadhojeni pak nga mesi i faqes, në pjesën e djathtë, në
24 mënyrë të tillë që ta shikojmë pak më qartë -- të shikojmë pak
25 këto ndryshimet e ngjyrave.

1 PY. Nuk e di në qoftë se e shikoni dot më mirë tani në ekran
2 dokument -- këtë dokument, Dëshmitar. Megjithatë, siç mund ta
3 shikoni, kur shkruhet Brigada 151, 152, 153, këto janë të
4 gjitha me të zezë. Por ndërkohë, sipër Brigadës 151, ka disa
5 shënime të tjera. Për shembull, mund të lexoj unë këtu fjalën
6 "Rama". Kjo është me ngjyrë blu.

7 PË. Po.

8 PY. Pyetja ime është kjo: Unë dua të di në qoftë se këto
9 shënime me ngjyrë blu që i shikojmë këtu --

10 Z. MISETIC: [Përkthim] -- dhe do i kërkoja Sekretares që
11 të tregojë edhe pjesën e sipërme, në cep në të majtë.

12 PY. Edhe kjo -- edhe ky shënimi këtu në fillim fare, është me
13 blu. Pyetja ime është kjo: Këto shënime, nënshkrimin që ke
14 bërë me 18 -- me 19 tetor të vitit 2024, dhe këto shënime që
15 i pamë pak më përpara, i keni bërë në të njëjtën kohë, me të
16 njëjtin stilolaps, apo jo? Kjo është pyetja.

17 PË. Jo, jo. Kjo është shumë më herët, në kohën aktuale të
18 luftës.

19 PY. Në rregull.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta tregojmë edhe një herë
21 pjesën e dokumentit që e zmadhuam më herët?

22 PY. A mund të na e shpjegoni se si mund të ndodhë që kur
23 bëhet një fotokopje, pjesa tjetër e dokumentit del me të zezë
24 ndërkohë që këto shënime e tjera dalin me ngjyrë blu? Si ka
25 ndodhur kjo?

1 PË. Kjo ka ndodhur ngase këto të mëhershmet janë -- kur janë
2 fotokopjue, domethënë nga një material, për sa unë -- kanë
3 shpërnda të tjerë, pjesëmarrësve të tjerë në atë takim, këto
4 me të kaltër kanë -- nga fotokopja kanë dalë në të zezë,
5 ndërsa këto në të kaltër kanë pasuar në takimet e mëvonshme.
6 Pra në takimet e radhës.

7 PY. Në rregull. Tani do të kaloj te një temë tjetër.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares ta heqë
9 nga ekrani dokumentin.

10 PY. Por para se sa të bëheshit pjesë e UÇK-së, ju keni qenë
11 pjesë e stërvitjeve ushtarake. Domethënë, jeni -- keni qenë i
12 trajnuar në aspektin ushtarak, apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Gjithashtu, keni përfunduar shkollën teknike të policisë,
15 apo jo?

16 PË. Kam përfunduar të gjitha trajnimet policore. Edhe të --
17 domethënë në ish-Jugosllavi, por edhe këto trajnimet policore
18 në -- të OSBE-së, mbasi kam ushtruar edhe detyrën e --
19 domethënë, të zyrtarit policor edhe në Shërbimin Policor të
20 Kosovës nga viti 1999.

21 PY. Dhe sikurse u diskutua edhe me Mbrojtësin e Viktimave, ju
22 u bëtë oficer policie. Pyetja që kam për ju është kjo: ju nuk
23 keni përjetuar probleme me UÇK-në për shkak të formimit tuaj
24 policor ose ish-përvojës tuaj të mëparshme me armatën
25 jugosllave. Nuk është se ka krijuar ndonjë problem kjo sa i

1 takon kyçjes në UÇK, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Jo, aspak.

3 PY. Në fakt, i keni thënë ZPS-së që UÇK-ja, citoj:

4 "përgjithësisht ishte e hapur që të pranonte" -- ju kërkoj

5 ndjesë, do jem më konkret. Ju keni thënë, dhe këtë konkretisht

6 e keni thënë në pjesën 2, faqen 5 të intervistës:

7 "... ne kemi pasur shumë zyrtarë ushtarakë në grupin

8 tonë. Kemi qenë shumë liberalë, shumë të hapur. Çfarë dua të

9 them me këtë gjë është që ishim të hapur që të pranonim

10 zyrtarë që kishin përvojë të mëparshme dhe ishim goxha

11 liberalë lidhur me personat që u qasën ndaj nesh dhe që kishin

12 përvojë të mëparshme me armatën jugosllave. Këto mund të

13 kishin qenë me armatën jugosllave ose mund të vinin edhe nga

14 përvoja të tjera të mëparshme."

15 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, e saktë.

17 PY. Komandant Remi nuk ka shprehur ndonjë armiqësi lidhur me

18 ish oficerët e armatës jugosllave. A është e saktë kjo,

19 Dëshmitar?

20 PË. E saktë. Po.

21 PY. Kur ju u bëtë pjesë e UÇK-së në qershor të vitit 1998, a

22 -- komandant Remi në atë kohë ka qenë komandant i zonësës

23 Llapit, apo jo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. I thatë ZPS-së që kur u kyçët në UÇK, ju nuk e dinit se

1 kush ishte komandanti i përgjithshëm i UÇK-së. A është e
2 vërtetë -- e saktë kjo?

3 PË. Po, e vërtetë.

4 PY. Në pjesën 1, faqe 21, në intervistën me ZPS-në, thoni,
5 kur u pyetët lidhur me lidhjet ndërmjet zonës dhe Shtabit të
6 Përgjithshëm, në përgjigje të kësaj pyetje ju thatë që:

7 "...nuk kishit lidhje fizike dhe distanca gjeografike
8 ishte shumë e madhe, dhe si rezultat nuk ka pasur lidhje
9 fizike."

10 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. E saktë.

12 PY. I thatë ZPS-së që kontaktet, dhe këtu citoj, "Me Shtabin
13 e Përgjithshëm" nuk ishin shumë të shpeshta në atë kohë. A
14 është e vërtetë kjo?

15 PË. Po, po e plotësoj me atë se gjithsej sa mbaj mend, dy
16 vizita i kemi të -- ka Shtabi i Përgjithshëm gjatë gjithë
17 luftës, pra në gusht edhe në tetor të vitit 1998.

18 PY. Në rregull. Po ashtu, thatë që ndërkohë që u mundat që
19 të krijonit komunikime, kjo ishte e vështirë, pra ishte e
20 vështirë që të krijoheshin komunikime për shkak të terrenit të
21 vështirë dhe për shkak të distancave të konsiderueshme. A
22 është e saktë kjo?

23 PË. Të shtoj edhe masat e sigurisë nga se [E pakuptueshme]
24 terreni ka qenë pjesë prej tij mbuluar nga [E pakuptueshme]
25 por në masë ka qenë nga -- pra, territorit që kanë mbizotëruar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 67

1 forcat okupuese serbe dhe një pjesë e territorit të -- së --
2 ka -- kemi pas ne në kontroll. Për këtë arsye edhe çështja e
3 kalimit, pra, ka qenë edhe nga aspekti i sigurisë. Pra
4 rreziqet nga komunikimi -- gjithësisht, shkuarja e ardhja.
5 PY. Gjatë intervistës me ZPS-në, i thatë ZPS-së që të gjitha
6 pozicionet e larta komanduese brenda zonës së Llapit janë
7 propozuar nga komandant Remi. A është e saktë kjo?

8 PË. Po, sa e di unë, po.

9 PY. Dëshiroj t'ju tregoj diçka që ka thënë që ka thënë
10 komandant Remi në një intervistë dhe ju kërkoj më pas që ta
11 komentoni atë çfarë ka thënë ai.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] E kam fjalën për provën P188, në
13 faqen SPOE00053301. Ndërkohë që versionin në shqip është në
14 faqen SPOE00330258.

15 PY. Është nga libri i komandant Remit "Lufta për Kosovë".

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faqja 6 e versionit në PDF.

17 PY. Do ju kërkoja që të lexonit paragrafin që keni përpara në
18 ekran. Pyetja është kjo:

19 "Ndërkohë në Shalë të Bajgorës, UÇK-ja e Llapit kishte
20 filluar stërvitjet. Kur dhe si nisën ato, cilët ishin të parët
21 që u afruan, dhe cilët ishin eprorët?"

22 Komandant Remi thotë si më poshtë:

23 "Ishte diku muaji prill kur ne morëm vendim që në muajin
24 maj të dilnim në mal dhe të fillonim stërvitjet. Menjëherë
25 kemi marrë masat e duhura dhe kemi caktuar personat përgjegjës

1 për fshatrat që do të mobilizonin ushtarët. Unë do t'i përmend
2 disa nga personat përgjegjës, siç janë Kadri Avdiu, Sabri
3 Hamiti, Ali Potera, Beqir Hajrizi, e një varg aktivistësh të
4 tjerë nëpër fshatrat që në atë kohë ne i konsideronim si të
5 verifikuara që të mobilizonin ushtarët."

6 Ai vazhdon më tej duke thënë drejt fundit:

7 "Hamit Hamiti është caktuar si personi përgjegjës për
8 logjistikën që do kujdesej për regjistrimin si dhe për
9 mobilizim të përgjithshëm. Muhamet Latifi [Sipas përkthimit]
10 ishte përgjegjës për mobilizim të përgjithshëm, i cili më vonë
11 mori detyrën e komandantit të mbrojtjes civile. Në atë kohë ka
12 qenë i krijuar edhe shtabi i zonës. Unë isha komandant zone,
13 ndërsa Latif Gashi, Latif Humolli, Hyzri Talla, Sejdi Rama dhe
14 Avdi Keçmari ishin anëtarë të shtabit."

15 E shikoni këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 PY. Këtu ai flet për situatën në maj të vitit 1998. Kështu e
18 kuptoni ju, Dëshmitar?

19 PË. Po, ashtu, ky i referohet.

20 PY. A është kjo situata kur -- që keni gjetur në zonën e
21 Llapit kur u bëtë pjesë e zonës së Llapit në qershor të vitit
22 1998, sa i takon strukturës komanduese? Kjo ka qenë situata
23 atëherë?

24 PË. Po, vetëm i shtohet këtu edhe ardhja e zëvendës
25 komandantit, Kadri Kastratit.

1 PY. Po.

2 PË. Edhe lidhja ime ka qenë Hyzri Talla, ky që apostrofohet
3 këtu, dhe më këtë kohë kam qenë në kontakt me të. Akoma s'isha
4 i kyçur por isha në kontakt me -- me Hyzri Tallën.

5 PY. Me aq sa dini ju, a është e saktë se këto emërime janë
6 bërë -- pra me aq sa dini ju -- a e dini ju që këto janë
7 emërime të cilat janë bërë përpara se sa të vinte Shtabi i
8 Përgjithshëm në zonën e Llapit?

9 PË. Po, përpara.

10 PY. Në shënimin përgatitor 2, paragrafi 9, ju thoni diçka të
11 ngjashme. Thoni që Zahir Bajaziti ka qenë një ndër të parët së
12 bashku me Rustem Mustafën, Fatmir Humollin, Hyzri Tallën, dhe
13 persona të tjerë, që janë përpjekur të organizojnë strukturën
14 e UÇK-së në zonën e Llapit.

15 A ja keni thënë këtë gjë ZPS-së përpara një jave,
16 Dëshmitar?

17 PË. Po. Po, disa prej ta unë s'mujt ndoshta krejt t'i
18 apostrofoj, por, po.

19 PY. Në rregull. Komandant Remi, z. Mustafa ka dhënë dëshmi
20 publikisht në seancë të hapur publike në këtë gjyq, në korrik
21 të vitit 2023. Dua t'ju lexoj një pjesë të dëshmisë që ja ka
22 dhënë përpara Trupit Gjykses dhe pastaj do ju pyes në qoftë se
23 pajtoheni me mendimin e tij.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është marrë
25 nga transkriptimi i gjykimit në faqet 5500, rreshtat nga 3

1 deri në 19.

2 PY. Ai i identifikon komandantët e brigadave, dhe thotë si më
3 poshtë:

4 "Ata ishin Izri [Sipas përkthimit] Shabani, nga fillimi
5 deri në fund. Ai ka qenë komandanti i brigadës 151. Nuredin
6 Ibishi, fillimisht ishte komandanti i Brigadës 152, dhe më pas
7 atë e pasoi Arif Muçolli. Sejdi Veseli fillimisht ishte
8 komandanti i Brigadës 153, dhe pastaj Adem Shehu."

9 A dëshironi që të komentoni lidhur me këtë fragment të
10 dëshmisë së komandant Remit?

11 PË. Po, vetëm se fillimisht jam -- unë nuk kam qenë komandant
12 i brigadës 151. Lat -- Pra Idriz Shabani a ka qenë. Luta ka
13 qenë i Brigadës 152, edhe Sejdi Veseli ka qenë
14 zëvendëskomandant, po një -- njëkohësisht edhe si ushtrues i
15 detyrës së komandantit të Brigadës 153. Tash veç -- më fal,
16 kohës që i referohet -- s'po shoh. Cilës kohë?

17 PY. Ai thotë që:

18 "Izri Shabani ka qenë komandant nga fillimi deri në fund.
19 Ai ka qenë komandanti i Brigadës 151."

20 Ju po thoni tjetër gjë?

21 PË. Ka ndryshuar në kontekst të kohës. Pra, nga fillimi, në
22 fillim kam qenë unë komandant i Brigadës 15 -- pra 151, Zahir
23 Pajaziti. Ndërsa më vonë kur jemi shtri në terren dhe kemi
24 zënë pozicionet finale në -- për shkak vetë të rreshtimit të
25 brigadave që kanë, që aktualisht kanë qenë pozicione, atëherë

1 vetëm ka ndryshue pra, numrat. Përgjithësisht, ose emërtimi i
2 brigadave, 151-shi -- komandanti, përgjithësisht krejt stafi i
3 151-shit është ba 152, dhe këta të 152 janë ba 151. Domethënë,
4 vetëm kanë ndërrue - pra -- në, në -- kjo -- u ba ndryshimi i
5 brigadave 151-shi me 152-shin. Asgjë tjetër. Personeli ka qenë
6 i njëjtë dhe -- sikur ka qenë më herët. Pra, diku, nëse nuk
7 gaboj, kjo është në nëntor. Nëntor të vitit 1998, ka ardhur
8 deri te ndryshimi, pra i emërimeve, nga 151-shi në 152-shin.
9 Deri në atë kohë unë kam qenë komandanti i Brigadës 151 Zahir
10 Pajaziti. Ndërsa më vonë bahet -- pra vetëm ndryshon për shkak
11 të pozicionimit frontal dhe numërimit nga e majta në të
12 djathtë. Ky 15 -- ka që qenë 152 është ba 151, ndërsa ky që ka
13 qenë 151, është ba 152. Domethënë, kurrëgjë në lartësi nuk
14 ndryshon, vetëm emri.

15 PY. Në rregull. Faleminderit. Përfundimi i kësaj pjesës që ju
16 lexova nga dëshmia e z. Mustafa është ky, që atij i pyetet --
17 i bëhet pyetja më konkretisht që:

18 "Kush e ka caktuar komandantët e këtyre brigadave?"

19 Ai përgjigjet:

20 "Unë i kam caktuar."

21 A përkon kjo me atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me këtë
22 temë?

23 PË. Po.

24 PY. Në rregull. pastaj ai vazhdon më tej, në transkriptimi në
25 faqen 5484, rreshtat 24 deri në 5445, rreshti 11. Më lejoni

1 një çast ju lutem.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po kontrolloja citimet e
3 transkriptimit për t'i dhënë shifrat e sakta.

4 PY. Megjithatë, Dëshmitar, ai thotë si më poshtë:

5 "Z. Prokuror, emërimet mund të bëheshin gjithashtu edhe
6 nga Shtabi i Përgjithshëm. Megjithatë, vendimin përfundimtar
7 se kush do bëhej shef shtabi, zëvendës komandanti i zonës dhe
8 zëvendës komandant ishte i imi. Për hatër të bashkëpunimit dhe
9 mundësisë për të operuar me Shtabin e Përgjithshëm, emërimet
10 mund të bëheshin edhe nga ata."

11 Vazhdohet më tej dhe i bëhet pyetja e radhës z. Mustafa
12 që -- e cila është:

13 "Po Nuredin Ibishi kujt i raportonte?"

14 Ai thotë:

15 "Më raportonte mua."

16 Tani -

17 Z. MISETIC: [Përkthim] -- referenca e saktë e
18 transkriptimit është 5484 deri në 5485.

19 PY. Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: A e keni
20 kuptuar edhe ju situatën si të tillë, që vendimi përfundimtar
21 se kush do të ishte komandant apo zëvendës komandant -- këtë
22 vendim e bënte komandant Remi?

23 PË. Po, në aspektin të them praktik dhe faktik, ai e ka ba.

24 Ndërsa, të them, atë vendimin por e ka marrë në gusht të vitit
25 1998, pra është diçka tjetër, domethënë, është ana formale, të

1 them ashtu, e një miratimi për të cilin unë veç kam qenë i
2 caktuar nga komandant Remi si komandant i brigadës 151 Zahir
3 Pajaziti. Pra, kjo është me 18 korrik, nëse nuk gaboj, të
4 vitit 1998.

5 PY. Sa i takon emërimin tuaj si komandant i Brigadës 151, ju
6 keni dhënë dëshmi që nuk keni njohuri faktike lidhur me
7 marrëdhëniet midis komandant Remit dhe anëtarëve të Shtabit të
8 Përgjithshëm. A e saktë kjo?

9 PË. Nuk kam dëshmi për arsye se ajo ka qenë kompetencë e
10 komandantit të zonës të ketë kontakte me Shtabin e
11 Përgjithshëm, kështu që nuk kam pas një, të them -- të them,
12 ingjerenca të ndërhyj në atë raport. Për këtë arsye ndoshta i
13 jam referue ashtu që ka qenë në -- domethënë, në diskrecion të
14 tij të -- jo diskrecion, por ka qenë detyrë e tij të
15 komunikojë me Shtabin e Përgjithshëm. S'ka qenë detyrë e imja
16 apo ide e imja, apo e dikujt tjetër.

17 PY. Sa i takon vizitës së Shtabit të Përgjithshëm në zonën e
18 Llapit në gusht të vitit 1998, ju thatë që e keni parë z.
19 Thaçi si pjesë të Shtabit të Përgjithshëm të atij grupi që
20 erdhi nga Shtabi i Përgjithshëm për të vizituar zonën e Llapit
21 në atë kohë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Ju më përpara atij momenti nuk e kishit takuar asnjëherë
24 z. Thaçi, apo jo?

25 PË. Jo, asnjëherë.

1 PY. Keni dëshmuar që në atë kohë ju nuk e dinit se çfarë roli
2 kishte z. Thaçi. Thjesht dinit që ai ishte anëtar i Shtabit të
3 Përgjithshëm dhe kaq. Është e saktë kjo?

4 PË. Ashtu është.

5 PY. I thatë ZPS-së në Pjesën 2 në faqen 14 të intervistës me
6 ZPS-në që nuk keni folur me z. Thaçi dhe me asnjë anëtar
7 tjetër të Shtabit të Përgjithshëm gjatë vizitës së tyre në
8 Llap. A është e saktë kjo?

9 PË. Po s'mund të them që s'kam fol unë, po s'kam fol me
10 kompetencë. Mund të folsha unë, përshëndet dhe një aspekt
11 kështu, joformal. Mirëpo këtu duke mos i ditur pozicionet,
12 s'kam pas një komunikim zyrtar, të them, të një qasjes së
13 drejtpërdrejtë për të pyetur diçka konkrete. Pasi s'i kam dit
14 pozicionet e tyre.

15 PY. Do ju lexoja dhe çfarë i keni thënë ZPS-së në faqen 2, fa
16 -- në faqen 2, rreshti 14 [sipas përkthimit]. Ju keni thënë që

17 "Unë nuk i njihja ata kështu që nuk kisha asgjë për të
18 diskutuar me të. Më pas kam biseduar me Bislīm Zyrapin, shefin
19 e Shtabit. Duhet të sqaronim diçka. Ne kishim komunikime të
20 vazhdueshme me të për çështje të personelit dhe stafit dhe ai
21 ishte më i informuar se sa shefi i Shtabit."

22 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Po ashtu, i keni thënë ZPS-së në Pjesën 2, në faqen 15,
25 rreshti 23, se ju nuk i keni kërkuar urdhra apo udhëzime

1 Shtabit të Përgjithshëm dhe se nuk keni marrë urdhra apo
2 udhëzime nga Shtabi i Përgjithshëm gjatë vizitës së Shtabit të
3 Përgjithshëm. A është e saktë kjo?

4 PË. E saktë.

5 PY. Dhe ju i thatë ZPS-së, dhe kjo gjendet në intervistën
6 tuaj Pjesën e 2, faqja 15, duke filluar në rreshtin 24, thatë:

7 "Në atë kohë nuk isha shumë i sigurt se kujt i
8 drejtohesha për çfarë, sepse nuk isha i sigurt për rolet e
9 tyre apo për postet që kishin, apo çfarë detyrat që kishin."

10 Kështu?

11 PË. Ashtu është. Po.

12 PY. Në rregull. Lidhur me vizitën e dytë të Shtabit të
13 Përgjithshëm në zonën e Llapit në tetor të vitit 1998, i thatë
14 ZPS-së se një nga njerëzit që vizituan zonën e Llapit ishte
15 edhe z. Thaçi. Kështu?

16 PË. Po.

17 PY. A është e saktë që në kohën e kësaj vizite, në tetor të
18 vitit 1998, ju ende nuk e dinit se çfarë pozicioni apo posti
19 kishte z. Thaçi? Kështu?

20 PË. Jo, akoma.

21 PY. T'i kthehemi kohës kur jeni emëruar shefi i shtabit e
22 komandës së zonës. Keni thënë që edhe pas asaj kohe, kontakti
23 i juaj me Shtabin e Përgjithshëm ishte vetëm gjatë vizitave të
24 tyre. Kështu?

25 PË. Edhe i përmenda, i përshkrova ato.

1 PY. Po. Thatë se për shkak të mungesës të rregullores së
2 përgjithshëm që nuk e kishe marrë, nuk e kishit marrë nga
3 Shtabi i Përgjithshëm, vepronit në bazë të logjikes suaj, të
4 vendimeve tuaja brenda zonës. Kështu?

5 PË. Jo -- po, normal dhe

6 PY. -- krijuat materialet tuaja?

7 PË. Po, krijonim materialet tuaj -- tona me -- si materiale
8 të përkohshme, të miratuara nga komandant Remi, pra këto --
9 një prej hartuesve kam qenë unë me Kadri Kastratin, edhe ato
10 miratoheshin në -- në -- të them në atë kohën provizore, deri
11 sa Shtabi i Përgjithshëm do të na binte rregulloren, [E
12 pakuptueshme] të asaj fushe, dhe automatikisht do të
13 zëvendësohej me atë ekzistuese me autoritet të komandant
14 Remit.

15 PY. Tani të flasim konkretisht për çështjen e trajtimit të
16 njerëzve të dyshuar si bashkëpunëtorë.

17 I thatë ZPS-së në pjesën 3, faqe 5 e intervistës, se nuk
18 kishte udhëzime konkrete lidhur me trajtimin e civilëve që
19 vazhdonin të punonin në punët -- detyrat e tyre në vende,
20 ofiqe publike. Kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Gjatë intervistës me ZPS-në, ju kanë treguar disa
23 komunikata të UÇK-së. Ju kujtohet? Sidomos komunikata 53 dhe
24 54?

25 PË. Po.

1 PY.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani, ju lutem të paraqesim në
3 ekran Komunikatën 53, që është prova materiale P00157 dhe në
4 anglisht dhe në shqip. Në shqip mund ta ngremë lart që të
5 duket data -- që të shikoni datën e dokumentit.

6 PY. Është 24 shtator, e vitit 1998. E shikoni në qoshen e
7 djathë lartë?

8 PË. Po. Po, e shoh.

9 PY. Tani të kalojmë te komunikata që u tregua, ju paraqitën
10 në intervistën e ZPS-së . Paragrafi i 3 diskuton:

11 "Veprime -- se veprimet e ndryshme ndëshkuese po
12 ndërmerren ndaj elementëve bashkëpunëtorë që i shërbejnë
13 pushtuesve."

14 E shikon këtë? Paragrafi 3.

15 PË. Po.

16 PY. Në përgjigje të kësaj komunikate, kur ua tregoi ZPS-ja, i
17 thatë që nuk janë ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj
18 bashkëpunëtorë në zonën tuaj në përgjigje të kësaj komunikate.
19 Kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Po.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe të shikojmë tani Komunikatën
23 54, 0836 -- jo. P00173-ET. Është pranuar tani si provë, në të
24 dy versionet, dhe anglisht dhe shqip. ju lutem.

25 PY. Ju kujtohet që ua treguan këtë komunikatë dhe data aty

1 është, siç e shihni, 24 shtator e vitit 1998. E shihni?

2 PË. Po.

3 PY. Ju kujtohet që ua treguan këtë komunikatë gjatë
4 intervistës me ZPS-në?

5 PË. Më kujtohet këtu -- jo saktë por -- po më kujtohen disa
6 detaje. Vetëm sa ta lexoj.

7 PY. Dua të përqendrohemi te paragrafi që fillon: "Pas
8 tërheqjes së forcave serbe, vendi i tyre u mbu -- u zu nga
9 disa kolaboracionistë dhe bashkëpunëtorë..."

10 E shikoni këtë?

11 PË. Jo, nuk -- nuk po e shoh. Në cilin paragraf?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ta ngremë lart faqen.

13 DËSHMITARI: Ah, po. Tash

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Thotë:

16 "Pas tërheqjes së forcave serbe, vendin e tyre e zunë
17 edhe disa kolaboracionistë dhe veprimtarë tanë [Sipas
18 përkthimit] politikë, të cilët mbjellin disfatizëm,
19 propagandojnë kundër UÇK-së, dhe kërkojnë që populli t'ia
20 dorëzojë armët armikut. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë
21 Çlirimtare të Kosovës bën me dije se armët janë marrë për të
22 luftuar për lirinë e Kosovës, deri në fitore. Të gjithë
23 emisarët e armikut dhe përhapësit e luftës speciale, kudo
24 ndodheshin, do të trajtoheshin sipas ligjeve në rrethanat e
25 luftës. Komandantët dhe luftëtarët trima të Llapit, Shalës së

1 Bajgorës dhe të Drenicës, së Dukagjinit, dhe të tërë Kosovës,
2 nuk kanë nevojë për emisarët që mbjellin në popullin huti e
3 disfatizëm. Ata e dinë mirë detyrën e tyre. Ata janë duke
4 kryer detyrën e shenjtë për mbrojtjen dhe çlirimin e popullit
5 dhe të atdheut.”

6 E shikoni?

7 PË. Në se ka mundësi veç me e ngrit ma lart, kështu këtë
8 versionin shqip. Mirë. E tash po e shoh.

9 PY. Dua që ta analizojmë pak këtë. Ua dhashë datat. Po flasim
10 për 22 dhe 24 shtator. Të shohim se çfarë ka ndodhur me
11 njerëzit e mbajtur të ndaluar në zonën e Llapit në këtë kohë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të paraqesim në ekran
13 provën materiale P6 -- P0167 [Sipas përkthimit], edhe në
14 anglisht, edhe në shqip.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të jetë
16 e qartë për ne, por për procesverbal përmendni edhe vitin kur
17 përmendni datat.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Pra, komunikata për të cilën po flisja është e 22 e 24
20 shtatorit, të vitit 1998, Dëshmitar, dhe kjo që shikoni tani
21 në ekran dy ditë mbas komunikatësës fundit, pra e 26
22 shtatorit të vitit 1998: Vendim për çlirimin -- lirimin e
23 Milovan Stankoviçit. Dhe ju keni dëshmuar në vitin 2003 në
24 SPOE0003841 -- 341 [Sipas përkthimit], deri 00885352 [Sipas
25 përkthimit] dhe SPOE008834 [Sipas përkthimit] që tani provë me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 80

1 numër P1754, se ju personalisht keni marrë pjesë në vendimin
2 për lirimin e Stankoviçit. E mbani mend këtë kur keni
3 dëshmuar në vitin 2003?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe vendimi për ta liruar këtë person u mor nga
6 komandanti i zonës së Llapit, kështu? Komanda --

7 PË. Komanda e zonës së Llapit.

8 PY. Dhe -- të kalojmë tani te dëshmia juaj në gjyqin e Latif
9 Gashit në vitin 2003. Prova P1754, faqja SPOE00088346 deri në
10 SPOE00088347. Aty keni thënë se -- keni diskutuar lirimin edhe
11 të dy të tjerëve që ishin mbajtur të ndaluar. Fadil Sulejviç
12 dhe Islam Mishica, që janë ndaluar në Majac. Ju kujtohet kjo?

13 PË. Po. Po.

14 PY. Dhe keni diskutuar lirimin e tyre bashkë me lirimin e
15 Milovan Stankoviçit, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe të gjithë janë liruar pothuaj në të njëjtën kohë, në
18 shtator. E saktë?

19 PË. Në -- po. Stankoviçi është liruar, ndërsa këta dy të
20 tjerët kanë vazhduar të mbeten në kuadër të zonës operative të
21 Llapit, domethënë si të lirë, si pjesë e strukturës së
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

23 PY. Po --

24 PË. Pa detyra të caktuara, por në kuadër të zonës.

25 PY. Po, por u liruan si të ndaluar --

1 PË. Po, po. Domethënë --

2 PY. -- Rreth të njëjtës kohë. Si Milovan Stankoviçi.

3 PË. Po. Po, u liru. Janë liruar [E pakuptueshme].

4 PY. Së pari do t'ju them se sipas aktakuzës së Prokurorisë në
5 këtë rast, lista A, faqja 59 i -- dëshmitari i fundit i
6 personave që ishin ndaluar në zonën e Llapit në Bajgorë, u
7 liruan jo më vonë se mesi i shtatorit të vitit 1998. E
8 kuptoni?

9 PË. Po.

10 PY. Përputhet kjo me ato që dini ju, që në apo rreth mesit të
11 shtatorit, nuk kishte më të ndaluar në Bajgore, kështu?

12 PË. Jo, nuk koïncidon ngase në shtator na kemi pas luftimet
13 dhe lirimi i Stankoviçit, por edhe të dy të tjerëve ka --
14 është prolongue për më vonë, edhe ajo vendimi është marrë në -
15 - më vonë në Majac. Kështu që në shtator, nëse i referohesh 15
16 shtatorit, është koha e luftimeve. Beteja e Kaçanollit, 15
17 deri më 18. Atëherë kjo do të jetë më vonë.

18 PY. Ajo që dua të them është jo më vonë se fundi i shtatorit
19 --

20 PË. Jo --

21 PY. Të gjithë që ishin mbajtur të ndaluar, janë liruar.
22 Kështu?

23 PË. Po. Kjo ishte edhe arsyeja për shkak u prolongu, u shty
24 lirimi i tyre, mu për shkak të betejës dhe sigurisë së tyre
25 gjatë -- që të mos bien në dorë të armikut, po ata në një

1 situatë pak më të qetë. Dhe vetë beteja ka diktuar që ky lirim
2 të vijë më vonë.

3 PY. Por, edhe një herë, siç e pamë në vendimin e mëhershëm,
4 Stankoviçi është liruar në njëzetë -- deri në 26 shtator,
5 1998. Kështu?

6 PË. Po. Duhet jetë aty. S'jam i sigurt ngase kjo formë edhe
7 s' -- këtë vendim nuk po e njoh, ngase edhe nënshkrimi është i
8 panjohur, por realiteti është që ai është liruar përafërsisht
9 në atë kohë.

10 PY. Po, në rregull. Pra, në lidhje me idenë që keni ju për
11 Fadil Syleviçin dhe Islam Mehicën [Sipas përkthimit] që kishin
12 lidhje me Shtabin e Përgjithshëm, për të cilin keni folur, i
13 keni thënë ZPS-së se nuk keni pasur njohuri të drejtpërdrejta
14 për këtë, porse e keni dëgjuar nga Hyzri Talla dhe nga të
15 tjerët këtë gjë, kështu?

16 PË. Po. Ashtu është.

17 PY. T'i kthehemi komunikatave. Ajo që shohim këtu është se
18 komunikatat e 22 dhe 24 shtatorit të vitit 1998 janë lëshuar
19 rreth të njëjtës kohë kur janë liruar të gjithë të ndaluarit e
20 Bajgorës. Kështu? Nga --

21 PË. Ashtu duhet të jetë.

22 PY. Pajtoheni me mua se ju nuk keni dijeni për ndonjë lidhje
23 midis Komunikatës 53 dhe 54 dhe trajtimit të të ndaluarit në
24 zonën e Llapit?

25 PË. Jo, s'më -- s'po kuptoj çfarë njohurish. Pra po flasim

1 për këta të tre që kanë qenë të mbajtur apo -- s'po e kuptoj
2 pyetjen. Më fal edhe një herë, z. Luka.

3 PY. Pra, pajtoheni me mua se nuk ka lidhje midis Komunikatës
4 53 dhe 54, dhe mënyrës se si të ndaluarit po trajtoheshin në
5 zonën e Llapit në shtator të vitit 1998? Kështu?

6 PË. Jo. Jo, nuk ka lidhje.

7 PY. Faleminderit. Tani të flasim për rastin e Goran Sbiliçit.
8 I thatë ZPS-së se Goran -- lirimi i Goran Zbiliçit erdhi
9 pjesërisht për shkak të presionit që ka bërë Azem Demaçi. Keni
10 përdorur fjalën presion apo trysni, në Pjesën 9 të
11 intervistës, faqe 6. Është -- kështu është?

12 PË. S'po di si ta quaj, por ka qenë kërkesë.

13 PY. Këtu është përdorur fjala trysni, apo presion. Po ua
14 lexoj të gjithë fjalinë. Ju thoni në atë pjesë:

15 "Realiteti ishte se kishte presion dhe janë bërë kërkesë,
16 presion nga Adem Demaçi, si edhe nga KDOM-i dhe përfaqësues të
17 tjerë të organizatave ndërkombëtare. Personalisht, ja kalova
18 mesazhin Hyzri Tallës dhe Remit."

19 Kështu është?

20 PË. Po.

21 PY. Me sa dini, Adem Demaçi po e bënte këtë presion -- po ja
22 bënte këtë presion drejtpërdrejtë komandantit të zonës.

23 Kështu?

24 PË. Po, kërkesa e tija -- e tij ishte që, domethënë, ai të
25 lirohet, në kuptim të asaj, nëse -- ndërsa ato çka i shpjegova

1 më herët, për çështje të tjera që mund të ndërlidhen me
2 përgjegjësinë e tijna që ka pas bazat apo ka pas baza dyshimi,
3 që ka qenë i involvum në aspektet -- në diçka kriminale me atë
4 -- me persona të tjerë, ato mbetet në gjykim të mëvonshëm, në
5 aspektin hipotetik, kur krijohen në një situatë të re
6 institucionet e drejtësisë. Për këtë arsye edhe -- pra, edhe
7 zona e akceptoi edhe e pranoi, domethënë, kërkesën e z. Demaçi
8 që, pra, personi i caktuar të lirohet.

9 PY. Pra, nëse e kuptoj drejt, personi ishte i ndaluar në --
10 nën mbikëqyrjen e zonës. Z. Demaçi bëri kërkesë drejtpërdrejtë
11 ndaj komandës së zonës për ta liruar, dhe zona -- komanda e
12 zonës e liroi. Kështu?

13 PË. Po, ashtu është. Dhe [E pakuptueshme] të arsyeshme, në
14 kuptimin, një kërkesë të tillë.

15 PY. Dua t'ju tregoj një dokument dhe të shohim se çfarë
16 dijeni keni ju për të. Ju kanë bërë disa pyetje, ju bëri
17 pyetje Mbrojtësi i Viktimave, lidhur me një entitet të njohur
18 apo që pretendonte se ishte --

19 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Më thotë, z. Kryetar, që përpara
21 se të fillonim këtë seancë, ne kërkuam që të shtohet një
22 dokument, por s'e kemi marrë ende pëlqimin nga ju.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
24 kundërshtim?

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk ka.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 shtohet ky dokument në listën e dokumenteve.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare. Ju lutem
4 ta paraqisni në ekran materialin SPOE00227422 deri në
5 SPOE00227423. Të kalojmë në faqen e dytë të dokumentit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Një minutë, mbajeni aty që të
7 orientohet dëshmitari.

8 PY. Dëshmitar, do të lexoj se si përshkruhet ky dokument si
9 një dokument i shtypur në shqip, që ka titullin "Shtabi --
10 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së", shkruar nga Jakup
11 Krasniqi.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë te faqja e dytë. Do
13 t'iu lexoj paragrafin që diskuton drejtorinë politike të UÇK-
14 së. Thotë:

15 "Drejtoria politike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
16 fillimisht ka qenë në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të
17 UÇK-së. Me eskalimin e Luftës Çlirimtare të popullit të
18 Kosovës, për shkak të pa aftësisë së obj -- së subjekteve
19 politike për të drejtuar politikisht luftën, SHP-ja e ngarkon
20 DP të udhëheqë me politikën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
21 Në fillim, udhëheqjes të DP-së ishin Hashim Thaçi, Jakup
22 Krasniqi, Bardhyl Mahmuti, Sokol Bashota, dhe Xhavid Haliti.
23 Pas eskalimit të Luftës Çlirimtare dhe nevojave për komunikim
24 të brendshëm dhe me faktorin ndërkombëtar, DP-ja do të
25 zgjerohet me anëtarë të rinj, brenda dhe jashtë vendit.

1 Anëtarët e rinj do të jenë Adem Demaçi, Ramë Buja, brenda
2 vendit, dhe Ramadan Avdiu, Pleurat Sejdiu dhe Sabri [sipas
3 përkthimit] Kiçmari jashtë.”

4 Dhe po e lë me kaq. Ju keni dëshmuar duke e ditur se --
5 duke ditur rolin e z. Demaçi në lirimimin e Goran Zbiliçit. E
6 keni ditur ju që z. Adem Demaçi kishte përgjegjësi apo kishte
7 rol në komunikimin e brendshëm në Kosovë, si pjesë e Shtabit
8 të Përgjithshëm në atë kohë?

9 PË. Po. Ai ishte edhe përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm
10 në Prishtinë, pra luante rolin e përfaqësuesit të Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës në Prishtinë, dhe komunikonte me koma --
12 komandantin -- komandën edhe komandantët e zonave në të gjithë
13 Kosovën.

14 PY. Po, por e dini ju që Adem Demaçi komunikonte
15 drejtpërdrejtë me komandantin Remi?

16 PË. Po, gjithsesi, ai është -- domethënë, ishte një simbol i
17 veçantë i qendrës dhe përkushtimi i tij për Kosovën shtet edhe
18 vetë autoriteti i tij, por njëkohësisht edhe vetë posti bënte
19 që ai të ishte në kontakt të vazhdueshëm me komandantët e
20 zonave por njëkohësisht edhe me një, pra -- bashkëluftëtarët
21 të niveleve të ndryshme. Ka qenë jo vetëm autoriteti i tij --
22 jo vetëm për shkak të postit por edhe bagazhit të tij si
23 Mandela i Kosovës, person që tanë jetën ja ka kushtue lirisë
24 dhe -- edhe shtet-formimit të Kosovës.

25 PY. Në përgjigjen e fundit thoni që "ishte në kontakt të

1 vazhdueshëm me komandat e zonës -- me komandën e zonës dhe me
2 komandantë të ndryshëm". Edhe me ju ka qenë në kontakt të
3 vazhdueshëm si komandant i Brigadës 151?

4 PË. Po, ndoshta edhe të vazhdueshëm, por unë -- më ka vizitu
5 dhe disa herë, por edhe -- edhe na ka përkrah për shkak të
6 suksesit, sidomos në betejën e Kaçanollit, dhe na ka
7 inkurajuar për vazhdimin e luftës, pra. Kam pas kontakte, më
8 ka vizitu, dhe kemi kontaktue, por janë bazat të rregullta,
9 por sikur në komandën e zonës, por ma tepër në baza të them
10 personale, si komandant brigade, e ashtu.

11 PY. Është e saktë të themi se Adem Demaçi fizikisht ishte --
12 e kishte qendrën në zonën e Llapit?

13 PË. Pasi që Prishtina është, pra zona e përgjegjësisë.
14 Prishtina, Podujeva, Fushë Kosova, dhe Obiliqi, është zona e
15 Llapit, pasi emërtimet i kanë marrë në aspektet gjeografike.
16 Ndërsa selia e UÇK-së në Prishtinë ishte në Prishtinë dhe
17 vetë, pra, Adem Demaçi kryente atë detyrë. Për këtë arsye ka
18 qenë, kështu -- selia e zyrës së tij ka qenë në Prishtinë edhe
19 në kuadër të zonës së përgjegjësisë të zonës operative të
20 Llapit.

21 PY. Faleminderit. Pyetja tjetër që kam është se ju i thatë
22 ZPS-së se kishte një urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm lidhur
23 me bashkëpunëtorët apo kolaboratorët. Ju kujtohet?

24 PË. Po, më kujtohet.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws?

1 Z. LAWS: [Përkthim] Po të ndryshojmë temën nga dokumenti
2 që u shtua si rezultat i pyetjeve të mia, unë pyeta për diçka
3 që quhet Drejtoria Informative, dhe jo Drejtoria Politike. Për
4 procesverbal.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Dosja paraprake e ZPS-së e quan
6 drejtoria politike dhe informative.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, do kërkonte
8 pranimin e dokumentit si provë?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, sepse dokumenti tjetër ka një
10 numër provizor prove, kështu që për aq kohë që nuk pranohet ai
11 dokument, nuk do kërkoj pranimin e këtij dokumenti.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ta them më qartë, e rezervoj
13 pozicionin, qëndrimin tim lidhur me këtë dokument për më vonë,
14 kur ju të vendosni lidhur me dokumentin që aktualisht ka një
15 numër provizor prove.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptuam.

17 Z. MISETIC: [Përkthim]

18 PY. I keni thënë ZPS-së, dhe sapo ju pyeta në fakt, që ju
19 thoni që ka pasur një urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm sa i
20 takon kolaboracionistëve, por ZPS-së i keni thënë që nuk ka
21 pasur ndonjë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm por që kjo ka
22 qenë njohuri publike, e dinin të gjithë publikisht. A ju
23 kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

24 PË. Unë këtë urdhër s'e kam pa asnjëherë gjatë luftës. Pra,
25 edhe në atë aspekt i referohem kësaj, domethënë, se vetëm si

1 komunikatë. Për shembull, në komunikatën 53, 54 dhe një urdhri
2 që -- pra në kohën e luftës, nuk e kam parë atëherë q'atë
3 urdhër që po referoheni.

4 PY. Po, do ta bëja këtë pyetje në fakt tani. Megjithatë, ZPS-
5 së i keni thënë në Pjesën 5, faqja 4, rreshti 20 i intervistës
6 me të, që ju e imagjinoni Remi ka qenë i pranishëm kur është
7 dhënë ky urdhër, kur është lëshuar ky urdhër. A është e saktë
8 kjo, Dëshmitar?

9 PË. Jo, unë, unë kam thënë se ju kam referua, atë e kam
10 diskutu në fazën aty, domethënë nuk, nuk them, nuk kam thënë
11 se Remi ka qenë, por Remi na ka përfaqësuar aty edhe ato ka
12 qenë një si pyetje sugjestive. E kam përdorur "sigurisht". Për
13 këtë arsye [E pakuptueshme] dhe -- edhe Prokuroren që në këtë
14 rast diskutuam, ngase nuk jam i sigurt se për këtë që është
15 apostrofuat aty. Edhe këtë e kemi diskutuar. Pra, nuk është e
16 saktë që kam thënë -- e kam konfirmu. Ka qenë si pyetje
17 sugjestive. E këtu e kam përdorur si "sigurisht". Mund të jetë
18 apo -- mirëpo nuk jam i sigurt në rast se s'kam qenë unë në
19 atë takim eventualisht, nëse se është marrë ai vendim. Do t'ju
20 tregoj dëshminë që keni dhënë në gjykimin kundër Latif Gashit.

21 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretarisë që të
22 paraqesë provën P1754, faqe SPOE00088347. Të shkojmë te
23 paragrafi që thotë "Stankoviçi ishte i ndaluar ...". Në shqip
24 duhet të jetë 88359, që i takon faqja tjetër. Pra "Stankoviç
25 ishte në burg ...".

1 PY. Ajo çfarë keni thënë ju, siç është regjistruar dëshmia
2 juaj, është si më poshtë:

3 "Stankoviçi ishte në burg për rreth një muaj, edhe pse
4 nuk jam shumë i sigurt. Në tetor ne kemi shkuar më poshtë, dhe
5 dikur në dhjetor të vitit 1998 të burgosurit së pasi janë
6 mbajtur në Llapashticë. Pas urdhrave nga Shtabi i
7 Përgjithshëm, komandanti Remi, i cili ishte në kontakt të
8 vazhdueshëm me Shtabin e Përgjithshëm, dhe pastaj Shtabi i
9 Përgjithshëm duke vepruar sipas urdhrave të tij, ka urdhëruar
10 që personat që kanë bashkëpunuar me armikun, duhet të thirren
11 dhe të burgosen duke i izoluar..."

12 A e shikon këtë pjesë, Dëshmitar?

13 PË. Jo, veç me e ngrit pak më lartë. Këtu me siguri e kam
14 referuar Komunikatës 53 dhe 54 dhe --

15 PY. Komunikata 53 dhe 54 kanë ndodhur tre muaj më përpara
16 kësaj.

17 PË. Po, për atë edhe ne nuk -- nuk kemi pas raste të -- pra,
18 të -- të mëhershme, ngase kishim obligime rreth funksionimit
19 në det -- në [E pakuptueshme] e re, dhe për këtë arsye ajo në
20 -- ishim të preokupuar me çështje të mihjes së istikameve, dhe
21 pozicionimit të forcave, edhe deri sa -- edhe gjetjes së
22 bazave të brigadës edhe të zonës. Për këtë arsye që ajo fa --
23 ajo fazë tranzitore ishte me ngarkesa tona për shkak të
24 avancimit të -- në mbulimin e territorit. Kjo ndoshta [e pa
25 kuptueshme], përndryshe, unë po -- nuk kam parë asnjë urdhër

1 përveçse ne ushtarakët e përdorim atë urdhër kur si [E
2 pakuptueshme] si rekomandim, si komunikatë. E konvertonim në
3 atë kuptim, edhe për atë ndoshta -- duke ju referuar
4 komunikatës, kanë qenë publike. 53 dhe 54.

5 Ndërsa çështjen e, domethënë, komunikimit të komandant
6 Remit, ai ka qenë i vetmi kompetent që ka komunikuar me
7 Shtabin e Përgjithshëm. Domethënë, veç në akseptin e -- e
8 përgjegjësi -- përgjegjësisë së tij si shefi i zonës.
9 PY. Së pari, dua t'ju them që në dëshminë që i keni dhënë
10 ZPS-së, ju kanë bërë pyetje konkretisht se për kë urdhër të
11 Shtabit të Përgjithshëm po flisni. Përgjigjen e keni dhënë në
12 faqen 12, rreshtat 7 deri në 12 të Pjesës 4. Pyetja që ju
13 bëhet konkretisht është kjo:

14 "A ju ka thënë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së se si duhet
15 që të menaxhoheshin ose të mbaheshin të ndaluar persona të
16 tjerë?"

17 Përgjigja që ju jepni është:

18 "Jo."

19 Pyetja pastaj vazhdon me -- si më poshtë:

20 "Po komandant Remi apo ndokush tjetër brenda Shtabit të
21 Përgjithshëm, a ju ka thënë në fakt -- a ka dhënë urdhër në
22 fakt lidhur me këtë? Ose kush e ka dhënë urdhrin lidhur me
23 këtë?"

24 Dhe ju keni thënë:

25 "Nuk e di."

1 A është e saktë kjo?

2 PË. Jo, nuk e di, por ai ka qenë një vendim i i komandës.
3 Domethënë, lidhur me ndalimin e personave ka qenë vendim i
4 komandës. Nuk e di tash në mënyrë specifike kush e ka thënë,
5 mirëpo vendimi lidhur me ndalimin e personave ka qenë në nivel
6 të komandës së zonës.

7 PY. Po, pajtohem me këtë. Megjithatë, të shohim dëshminë që
8 keni përpara në ekran. Është pak e paqartë për mua dhe ju
9 kërkoj që ta sqaroni. Së pari ju thoni që "Shtabi i
10 Përgjithshëm, duke vepruar sipas urdhrave të tij, domethënë,
11 të Remit, të komandant Remit, ka urdhëruar që personat që kanë
12 bashkëpunuar me armikun, duhet të thirren dhe të burgosen duke
13 u izoluar..."

14 Për çfarë e keni fjalën këtu? A mund të na e shpjegoni
15 pak, Dëshmitar?

16 PË. Po unë këtu e kam pas për dy komunikatat, pra 53, 54 që u
17 apostrofuan më herët. Po, të mëhershme janë por që reflektojnë
18 me gjendje edhe normal në shtator e kemi paraqitjen edhe të
19 një -- për këtë ka ekzistue një -- vetëm është përfol. Unë
20 gjatë luftës nuk e kam parë atë, atë vendim që është përfol
21 për krijimin e milicisë. Pra, nga komuniteti shqiptar në
22 kuadër të ministrisë së punëve të brendshme të regjimit serb
23 në Kosovë, dhe kanë dalë listat me -- pra, për pjesëtarë të
24 komunitetit shqiptar kur kanë qenë me emra, pra në zonën e
25 Dukagjinit, gjithësisht, në Gjakovë, kur kanë dalë me emra,

1 mbiemra, me të dhëna personale, me uniformë dhe ngarkesë me
2 armë. Ato janë edhe në -- pra në rrjete sociale të -- në
3 Google dhe të tjerë. Mund t'i gjeni.

4 Ato, dhe njëra prej atyne arsyeve ka qenë ndërmarrja e
5 masave parandaluese që është marrë në emër të zonës. Pra kjo i
6 drejtohet, sa kam dëgjue, sa është përfol kjo, një urdhër nga
7 -- pra, nga -- domethënë -- pra, është komentue. Nuk -- s'e
8 kam pa si vendim, që të ndërmerren masa nga policia ushtarake
9 në parandalim të krijimit të kësaj strukture. Pra të milicë
10 shqiptare në kuadër të -- pra policisë serbe, që një front do
11 të sillte deri te lufta ndër -- brenda kombëtare, dhe të
12 krijonte shumë, shumë probleme në një vend.

13 Mirëpo, në masat që kemi ndërmarrë na, nuk e kemi pas
14 asnjë rast të paraqitje të kësaj milicie, pra të them,
15 shqiptare në kuadër të -- ajo ka mbet e kufizuar vetëm në
16 zonën e Dukagjinit dhe gjithësisht, në Gjakovë. Pra, vetëm
17 këtë dua ta lidhi. Pra, në -- për këtë vendim që eventualisht
18 lidhet me -- që është përfol, a që s'e kam parë, gjatë luftës.
19 Për -- ndoshta të bëhet një shtab i përgjithshëm, që lidhur me
20 këtë -- pra, policinë është, është -- milicinë, në të vërtetë,
21 prej shqiptarëve, në kuadër të milicisë së punëve të brendshme
22 të regjimit okupues, edhe që më vonë, pra, nuk ka gjetur
23 zbatim në zonën tonë pasi që janë ndërmarrë masat, se nuk ka
24 pas shtrirje të kësaj strukture në këtë zonë. Për këtë arsye
25 llogaris se edhe nëse ka ekzistuar një vendim i tillë, që s'e

1 kam parë, atëherë kjo nuk ka -- nuk kemi pas prezencë të tillë
2 të kësaj milicie në zonën operative të Llapit apo të zonës së
3 përgjegjesisë tonë.

4 PY. Dëshmitar, të lash që të shprehesh për një kohë të
5 gjatë, megjithatë shkuat përtej pyetjes time. Kështu që do ju
6 kërkoja që të dëgjonit me vëmendje pyetjen që të bëj, dhe të
7 përqendrohemi te dëshmia juaj. Dhe pyetja ishte që çfarë keni
8 dashur të thoni me fjalët në faqen që keni përpara në ekran.
9 Do ua bëj edhe një herë pyetjen.

10 Atëherë në ekran keni këtë paragrafin që fillon me
11 "Stankoviç ..." dhe thuhet që "Stankoviç ishte në burg për
12 rreth një muaj ..."

13 Vazhdohet më tej me një fjali, ku thuhet të paktën në
14 anglisht, sipas së cilës:

15 "... pas urdhrave nga Shtabi i Përgjithshëm, komandant
16 Remi, i cili ishte në kontakt të vazhdueshëm me Shtabin e
17 Përgjithshëm, dhe pastaj Shtabi i Përgjithshëm, duke vepruar
18 sipas urdhrave të tij, domethënë, sipas urdhrave të komandant
19 Remit, ka urdhëruar që personat të kenë bashkëpunuar -- që
20 kanë bashkëpunuar me armikun duhen të thirren dhe të burgosen
21 duke u izoluar."

22 A shikon këtë paragraf, Dëshmitar?

23 PË. Po, e shikoj, por kjo -- unë i kam referuar --

24 PY. Ndaloni këtu. thjesht të pyeta, e sheh apo nuk e sheh?

25 PË. Po, e shoh. E shoh.

1 PY. Pyetja konkrete që kam për ty është kjo: Çfarë do të
2 thotë Shtabi i Përgjithshëm po vepronte sipas urdhrave të
3 Remit, që personat që kanë bashkëpunuar me armikun, duhet të
4 thirren dhe duhet të burgosen".

5 PË. Me siguri është -- ose -- ëh -- është keqinterpretuar se
6 s'mundet Remi t'i -- t'i dirigjojë Shtabit të Përgjithshëm.
7 Unë po i referohem vetëm një mundësie për këtë policinë, apo
8 milicinë e shqiptarëve që ka qenë si rrezik për përhapje, që
9 ka mund të vijë një urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm, unë s'e
10 kam pa, dhe që realisht, ëh, aktiviteti këtu nuk kanë gjetur
11 elementë të shtrirjes së kësaj strukture në zonë këtu, përveç
12 në zonë të Dukagjinit.

13 Ndërsa kjo s'ka, mendoj, nuk ka kuptim kjo pjesë e
14 fjalisë që thotë se Remi i ka diktuar -- pra, Shtabit të
15 Përgjithshëm masa të tilla. Kjo, domethënë -- këtë anakron ka
16 si me, me raport.

17 PY. Po, por i vetmi urdhër të cilin ju e keni dëgjuar ose e
18 keni parë personalisht, ka qenë urdhri i Remit, që personat që
19 kanë bashkëpunuar me armikun, duhet të thirren dhe të burgosen
20 duke u izoluar. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Jo, kjo është urdhër i komandës së zonës për, për një
22 veprim të tillë. Urdhër i komandës së zonës, mbasi komandant
23 Remi është autoriteti që -- përfundimtar, por urdhrin për --
24 apo marrjen e vendimit për ndalimin e personave është në
25 kuadër të komandës së zonës operative të Llapit.

1 PY. Në rregull. Në Pjesën 7, në faqen 14, në rreshtat nga 11
2 deri në 17, ju i thoni ZPS-së që nuk jeni në dijeni të
3 raporteve për temat lidhur me bashkëpunëtorët që mund t'i jenë
4 dhënë Shtabit të Përgjithshëm nga zona e Llapit. A është e
5 saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. E saktë.

7 PY. Thoni në Pjesën 8, në faqen 11, rreshtat 11 deri në 17,
8 që nuk jeni në dijeni në qoftë se komandant Remi i ka
9 raportuar Shtabit të Përgjithshëm lidhur me bashkëpunëtorët. A
10 është e saktë kjo?

11 PË. E saktë.

12 PY. I keni thënë Dëshmitarit [Sipas përkthimit] në pjesën 7,
13 faqja 20, rreshtat nga 13 deri në që çështja e
14 bashkëpunëtorëve me aq sa dini ju, nuk është diskutuar gjatë
15 vizitës së anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm në tetor të
16 vitit 1998. A është e saktë kjo?

17 PË. E saktë.

18 PY. Tani do shohim Shënimin Përgatitor numër 2, në paragrafin
19 3 të këtij shënimi. Këtu flitet me dëshminë tuaj që kishte një
20 urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm për të mos marrë në pyetje të
21 ndaluarit. Në këtë paragraf thuhet:

22 "I pyetur që të sqaronte se çfarë dinte lidhur me urdhrin
23 e Shtabit të Përgjithshëm që të mos merreshin në pyetje të
24 ndaluarit, ju thatë që ishte e ndaluar që të bëheshin biseda
25 informative sepse nuk kishte polici hetimore, nuk kishte

1 prokurorë dhe nuk kishte gjykatë funksionale". Po ashtu ju
2 shtoni që "ka pasur një urdhër të nxjerrë nga zona operative e
3 Llapit, që ishte nxjerrë nga zona e Llapit dhe që i drejtohej
4 policisë ushtarake të zonës dhe që kishte të bënte me mos
5 keqtrajtime, ose urdhëronte mos keqtrajtimin e personave të
6 ndaluar. Më pas Shtabi i Përgjithshëm ka nxjerrë një urdhër të
7 ngjashëm sa i takon bisedave informative me të ndaluarit dhe
8 çështjes së diskutuar brenda zonës."

9 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Prokurorisë para një
10 jave, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Tani do shohim disa urdhra të Shtabit të Përgjithshëm,
13 dhe të diskutojmë lidhur me to, përderisa e keni cekur
14 çështjen e urdhrave të Shtabit të Përgjithshëm.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
16 paraqesë në ekran provën 1D29 në shqip, që është dokumenti me
17 P00741_ET.3 në anglisht.

18 PY. Dëshmitar, hidhini një sy këtij dokumenti dhe më thoni në
19 qoftë se e keni parë këtë urdhëresës më përpara.

20 PË. Gjatë luftës nuk e kam parë, por pas luftës e kam parë.

21 Veçse pak më poshtë, të lutem, me e ngritë më lartë, në të
22 vërtetë. Mirë, po. Gjatë luftës vetëm janë përfol, kështu,
23 pasi që s'e kemi -- këtë urdhëresë sikurse edhe deklarova edhe
24 më herët nuk e kam -- nuk e kam parë. Pas luftës po.

25 PY. Në rregull. Sa i takon njohurive që ju keni për urdhrat e

1 Shtabit të Përgjithshëm, ju vetë nuk keni parë asnjë urdhër
2 gjatë luftës që kishte të bënte me çështjen e
3 bashkëpunëtorëve, apo jo, Dëshmitar?

4 PË. Jo.

5 PY. Ky urdhër, kjo urdhëresë në pikën 3, dhe ky është në
6 urdhëresë që mban datën 28 nëntor të vitit 1998. Pra në pikën
7 3 thuhet që

8 "Në të gjitha institucionet e UÇK-së parandalohen
9 sjelljet jo korrekte ndaj popullsisë civile."

10 Ndërkohë që në pikën 4, nda -- thuhet që:

11 "Ndalohet arrestimi, paraburgimi ose burgosja e personave
12 pa urdhër të komandantit të brigadës e më lartë, vetëm në
13 rastet kritike të situatave luftarake, apo kur kryhen vepra
14 penale të ndryshme si ndaj pjesëtarëve të UÇK-së, ndaj
15 individëve, apo edhe pushtetit civil."

16 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. A mendoni që ky mund të jetë një urdhër ose mund të jetë
19 urdhëresa që ju i referoheni kur flisni për urdhrin e Shtabit
20 të Përgjithshëm për ndalimet dhe trajtimet e të ndaluarve?

21 PË. Po, mund të jetë, ngase ne edhe kështu -- pra,
22 kompetencat -- apo është ko incidencë mund të them. Unë thashë
23 edhe një herë, s'e kam parë, po ndoshta janë diskutue në zonë
24 atëherë këto, këto -- pra, detaje që, domethënë, nga kujtesa -
25 - pra, s'po -- s'i mbaj mend, por është e vërtetë që kjo ka

1 mbetur mandej aspekti i ndalimit të përkufizohet në
2 autoritetin e komandantit të brigadës, që më kupton, se
3 personat që janë të involvum në -- pra, në çështjet e
4 caktuara, pra, ato të kufizohen me autoritet të komandantit të
5 brigadës, pra, në territorin e përgjegjësisë së tij, me qëllim
6 të -- mos të bëhen keqpërdorimet të -- në këtë drejtim.

7 PY. Në rregull. Ju ishit shefi i shtabit të komandës së zonës
8 duke filluar nga dhjetori. E saktë?

9 PË. Po.

10 PY. A keni qenë në dijeni të arrestimit ose ndalimit, ose
11 burgimit të personave që bëheshin me urdhër të komandantit të
12 brigadës ose më lart, pas nxjerrjes së kësaj urdhërese?

13 PË. Po, normal. Ajo ka qenë kompetencë të -- pra, iu ka
14 delegu kompetenca komandantëve të brigadës, dhe ata kanë
15 vepru, kanë zbatu atë çfarë edhe u diskute.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më thonë
17 që ka në gabim në transkriptim në faqen 84, në rreshtat 17
18 deri në 18. Duhet që në vend të "komandantit" është "zonës" të
19 jetë "komandanti i brigadës".

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Dëshmitar, do ju pyes që të
21 sqaroni diçka. Në transkriptim thuhet që:

22 "Është e vërtetë që sa i takon ndalimit, këtë e kishte në
23 dorë, ose ishte në diskrecionin e komandantit të zonës."

24 Thatë komandantit të zonës apo të komandanti i brigadës?
25 Mund të na e sqaroni këtë ju lutem?

1 PY. Po, jo ky ishte në diskrecion të komandantit të brigadës,
2 ngase komandanti i zonës nuk ka pas mbikëqyrjen në kuptim të -
3 - pra të raporteve në mbrojtjen civile, pra edhe në -- edhe
4 policinë ushtarake që ka vepruar në kuadër të territorit të
5 caktuar, sikur që ka pas territorin komanda e -- e brigadës.

6 PË. Në rregull. Tani, Llapashtica. Qendra e ndalimit të
7 Llapashticës është krijuar në fillim të nëntorit, apo jo,
8 Dëshmitar?

9 PY. Duhet -- ashtu duhet të jetë.

10 PË. Pra, zona krijoji ambientet në Llapashticë përpara se sa
11 të lëshohej ky urdhër, kështu? Qendra e ndalimit në
12 Llapashticë i takon që është krijuar përpara se sa të nxirrej
13 ky urdhër. Është e saktë?

14 PY. Po sikur është më herët, dhe ky ka qenë vendim i komandës
15 së zonës operative të Llapit për ndalimin e personave, edhe,
16 edhe të delegimit të komandantët e brigadave për mbrojtjen
17 civile edhe të krijimit pra, dhe -- dhënies autoritet policisë
18 ushtarake që të krijojnë një vend - një vend për krejt zonën,
19 në qendër të mbajtjes për shkak që policia ushtarake, shumica
20 e të cilëve kanë qenë pjesëtarë të ish policisë së Kosovës,
21 dhe kanë pasur njohuri lidhur me të drejtat, detyrat,
22 autorizimet, por edhe të -- edhe të drejtave të individëve, të
23 njeriut.

24 PË. Sa i takon kronologjisë, këtu, zona kishte filluar që të
25 ndalonte persona në Bajgorë diku nga fillimi i gushtit? Është

1 e saktë kjo?

2 PY. Po, tash ato janë raste, të them, aksidentale, apo të
3 rastit, sikur çështja e arrestimi i Stankoviçit, apo grupi i
4 Grashticës apo të Fadil Sulejviçit, por -- por --

5 PË. Pavarësisht në qoftë se janë raste spontane apo jo,
6 thjeshtë unë po përpiqem që të përcaktojme kronologjinë. A
7 jeni në dijeni ju që personat, pavarësisht arsyeve, janë
8 ndaluar në gusht ose rreth gushtit, dhe janë mbajtur në
9 Bajgorë?

10 PY. Po.

11 PË. Dhe disa prej tyre, të paktën, janë mbajtur aty për
12 gjashtë javë, shtatë javë, përpara se sa të liroheshin nga
13 mesi i shtatorit ose nga fundi i shtatorit të vitit 1998? A
14 është e saktë kjo?

15 PY. Po, ata janë ftuar por janë ftu për disa ditë, dhe
16 rrethanat kanë ba që ndoshta kjo mbajte të shtyhet, për shkak
17 të gjendjes së luftës. Pra, kishim betejat, ishin qasje të
18 tjera që eventualisht kjo mbajtje që përkon me autorizimet dhe
19 policisë, dhe që ka të bëjë me mbajtje, është prolongu për pak
20 më -- apo në një kohë përtej asaj çfarë e -- ishte
21 parashikuar.

22 PË. Dhe pastaj të gjitha këto ndalime kanë ndodhur përpara se
23 sa të lëshohej komunikata 53 dhe 54. A është e saktë kjo?

24 PY. Po, gjithsesi.

25 PË. Pastaj ndodhi ofensiva serbe. Kështu?

1 PY. Më 15-18 shtator.

2 PË. Po. Pastaj ndodhi armëpushimi në tetor, kështu?

3 PY. Po.

4 PË. Pastaj zona e Llapit, duke filluar nga nëntori, përsëri

5 krijoi një qendër ndalimi, por kësaj here e krijoi në

6 Llapashticë. A e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PY. E saktë.

8 PË. Ju thatë, dhe i keni thënë ZPS-së që nuk keni dijeni

9 lidhur me kushtet në qendrën e ndalimit në Llapashticë. A

10 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

11 PY. S'mund të them -- pjesërisht ndoshta, për kushtet nga se

12 një autoritet tjetër ka qenë kompetent, por kam pasur njohuri,

13 ngase dy herë e kam vizitu këtë qendër. E keni në deklaratat e

14 mia atje. Por, jam kufizuar në kuptim të -- domethënë, s'kam

15 qenë përgjegjës direkt për at[, për këtë arsye, për sa vetë

16 përgjigja është ndoshta, të them, e -- e -- jo e plotë, por

17 unë e kam vizituar. E keni në raport -- dy herë qendrën, edhe

18 e kam marrë raporte nga shefi i policisë ushtarake, i cili ka

19 qenë kompetent për këtë, me kërkesat e tij, të cilat i janë

20 aprovuar në raport me kushtet e personave të mbajtur aty.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Shikoj që ka shkuar ora 13.00, z.

22 Kryegjykatës. Nuk kam shumë pyetje të mbetura, megjithatë dua

23 që të vazhdojmë me këtë temë pas pushimit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani kemi

25 pushimin e drekës, Dëshmitar. Do të kthehemi këtu në orën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 103

1 14.30 përsëri. Shihemi përsëri më 14.30. ju lutem, mos flisni
2 me askënd lidhur me dëshminë.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vlerësim
5 tjetër për kohën që ju duhet për pyetjet e ekipeve?

6 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besoj që nuk do
7 më duhet më shumë se sa një orë. Shpresoj që edhe më pak se
8 kaq.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë i qëndroj vlerësimit që kam
10 bërë më përpara, mbase edhe një çikë më pak se aq.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] rreth një orë, pak a shumë, i
12 nderuar Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

15 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

16 --- Seanca rifillon në orën 14.30

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare,
18 silleni dëshmitarin në sallë.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ibishi,
21 Mbrojtësi i z. Thaçi vazhdon të ketë disa pyetje të tjera për
22 ju.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

24 PY. Mirëdita, z. Ibishi. Përpara se të vazhdojmë me
25 diskutimin e Llapashticës dua t'i kthehem një përgjigjeje që

1 dhatë para dreke. Është faqja 79 e transkriptit, rreshti 19
2 deri në faqen 80, rreshti 19. Ju kujtohet që diskutuam
3 krijimin e një milicie të përbërë nga shqiptarë në forcat e
4 okupatorit si pjesë e forcave të tyre dhe me emra nga zona e
5 Dukagjinit. Ju kujtohet? Sidomos në Gjakovë.

6 PË. Po.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të paraqesim në ekran
8 provën P00168 në shqip dhe në anglisht.

9 PY. Dhe lexojeni me vete për këtë urdhër -- këtë urdhër dhe
10 më thoni pasi të mbaroni.

11 PË. Po.

12 PY. Urdhri mban datën 2 dhjetor '98. Dhe së pari ju pyes, e
13 keni parë më parë këtë urdhër?

14 PË. Jo, gjatë luftës jo, po pas luftës e kam pa.

15 PY. Në rregull. Mesa keni dijeni, ky urdhër lidhet me këtë
16 çështje që diskutuam para dreke lidhur me formacionin e
17 njësive, krijimin e njësive policore me shqiptarë në
18 strukturat e regjimit serb?

19 PË. Mendoj se po, ngase kjo i referohet edhe komandës, po i
20 referohet policisë ushtarake që ndërmerr masa edhe mendoj që
21 kjo ka qenë një situatë jashtëzakonisht e rrezikshme ngase veç
22 filluan të krijohet ky formacion nga, pra, në një qytet i
23 Rrafshit të Dukagjinit, në Gjakovë, me tendencë që të
24 zhvillohet në gjithë Kosovën që të krijojë një, të them, një,
25 një gjakderdhje brenda shqiptarëve.

1 Edhe mendoj që kjo ka pas domethënë arsye [E
2 padëgjueshme] një urdhër i tillë, se s'e kam pa në atë formë,
3 po është komentue si i tillë, dhe të cilit i jam referue edhe
4 tendenca ka qenë që ky formacion të bëhet në të gjithë
5 Kosovën. Pra, njerëz të uniformuar në milicinë serbe të
6 armatosen edhe të vehen përballë, me siguri, përballë
7 formacioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

8 Ne -- nëse mund të vazhdoj. Ne, në zonën operative të
9 Llapit kemi ndërmarrë masa që me iu referu kësaj, është përfol
10 kjo diçka lidhur me këtë urdhër, që në mes policisë ushtarake
11 të parandalojmë një gjë të tillë, dhe fatmirësisht ne në
12 kuadër të zonës së përgjegjesisë të zonës operative të Llapit,
13 nuk kemi pas paraqitje të tilla, ndoshta dhe prej ndërmarrjes
14 së masave, veprimeve proaktive.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.
16 PY. Tani t'i kthehem Llapashticës, objektit të ndalimit aty.
17 Çfarë roli keni luajtur ju në krijimin, në ngritjen e këtij
18 njësie, kësaj njësie të paraburgimit?

19 PË. Unë kam qenë anëtar i komandës, si komandant brigadave.
20 Më vonë, vetëm si pjesë e shtabit, po kam qenë në kuadër të
21 asaj, pra, që të, pra, të ndërmerret pra, të ndërmerret ky një
22 vendim i tillë për parandalim ngase rreziqet kishin dhe pasoja
23 të mëdha. Unë duhet t'i referohem edhe një herë me pasoja
24 çfarë e ka pas për pjesëtarët e Ushtria Çlirimtare e Kosovës
25 edhe po prej personales, po filloj në përgjithësi. Kemi

1 vrasjen e Hyzri Tallës, Ilirit, edhe Afrimit, pra gjerisa kanë
2 vizitue familjarët e vet.

3 Kemi ma vonë, pra, Hyzri Talla ka qenë zëvendës i shefit
4 të shërbimit informativ, sektorit informativ në zonën e
5 Llapit. Gjithashtu kemi vrasjen e Agim Gashit, shefit të
6 logjistikës në brigadën teme, Brigada 151, derisa ka vizitu
7 familjen e tij. Mandej, duhet ta arsyetoj, në kuptim të asaj,
8 pasojave nga ky bashkëpunim apo këta bashkëpunëtorë të -- pra,
9 edhe të shërbimit inteligjent serb, gjegjësisht, shërbimi i
10 sigurimit shtetnor, por edhe atij shërbimit policor apo
11 policisë serbe.

12 Në planin personal, duhet t'i referohemi gjithashtu, pra,
13 largimit të familjarëve të mi në banesa në Prishtinë, ku në
14 mënyrë arbitrare, familja jeme është larguar nga rruga me
15 kërcënim se do t'i vrasin, pra, fëmijët e mitur me
16 bashkëshorten. Dhe për këtë ka qenë i njoftum edhe shefi i
17 KDOM-it, z. Shaun Byrnes. Gjithashtu kemi rastin tjetër që më
18 është djeg shtëpia në fshat, edhe më e rënda ndër ta, fqiu im
19 i parë, gjegjësisht, djali motrës -- jo --
20 PY. Dëshmitar.

21 PË. -- duhet t'ju ta përfundoj, të lutem. Vetëm edhe këtë
22 edhe... edhe është vrarë, pra, Beqir Jakupi me gjashtë anëtarë
23 të tjerë të familjes, shumica të mitur, mu për shkak, civilë,
24 flas për civilë.

25 Edhe kjo tregon që ky bashkëpunim ka pas pasoja në

1 strukturën edhe të -- pra, me pasoja të rënda, por
2 njëkohësisht edhe me pasoja në zonën në, në zonën operative të
3 Llapit.

4 PY. Tani, e vlerësoj përgjigjen, por, pyetja ime dhe e po e
5 riformuloj pak, ju keni marrë pjesë në vendimin për ngritjen e
6 objektit të ndalimit në Llapashticë?

7 PË. Po.

8 PY. Përveç jush, kush u mor me atë vendim tjetër?

9 PË. Kanë qenë anëtarët e komandës së zonës të Llapit.

10 PY. Komandant Remi është një prej tyre?

11 PË. Po.

12 PY. Kadri Kastrati?

13 PË. Po.

14 PY. Të gjithë komandantët e brigadës?

15 PË. Shefat e sektorëve të gjithë, domethënë, s'i mbaj mend po
16 realiteti është ai.

17 PY. Për këtë u mbaj një mbledhje e komandës së zonës?

18 PË. Po, sigurisht.

19 PY. Dhe kur u mbajt kjo mbledhje, ky takim?

20 PË. S'e mbaj mend. Ky ka ndodh me siguri ka fundi i vitit
21 '98.

22 PY. Llapashtica u ngrit në fillim të nëntorit, kështu?

23 PË. Mund të jetë ashtu.

24 PY. Në fund, është vendimi i komandantit të zonës për ta
25 krijuar këtë qendër, apo jo?

1 PË. Po normal, përveç të gjithëve, domethënë është ai është
2 komandanti kryesor i zonës së Llapit edhe i përket, domethënë,
3 vendimi është marrë nga të gjithë.

4 PY. Tani të flasim për Llapashticën. Përpara pushimit na the
5 që ke qenë në Llapashticë. Je futur në ambientet e qendrës së
6 ndalimit në Llapashticë? Je futur brenda?

7 PË. Po, brenda në dy raste. Një herë i referohet vizitës të
8 një mikut tim që ka dashtë të vizitoj një person një nga ata
9 të mbajturit, dhe kam thirr policinë ushtarake, e kam shoqërue
10 deri te oborri aty, i kam -- policia ushtarake i ka vu në
11 kontakt, ka biseduar me te, edhe kjo ka përfunduar kështu.

12 Ndërsa rasti tjetër është kur duke vizituar poziconet,
13 fortifikat, kam vizitu edhe objektin e policisë ushtarake edhe
14 normale edhe objektin e mbajtjes. Nuk kam hy në brendi të --
15 pasiqë ishin orët e vona. Nuk kam hy në objekt. Ishte pas orës
16 22.00, ku ta di unë sa ishte, dhe nuk ishte koha e vizitave.
17 Kam vizitu policinë ushtarake, dhe aty ndër të tjera kam parë
18 disa ëmbëlsira në tavolinë. Kam pyt, normal, për gjendjen
19 krejt rreth asaj, ata që ishin kujdestarë aty. I kam pyt për
20 ato ëmbëlsira për kënd janë. Pasi kishte pak me shumicë, disa
21 ma shumë ashtu sa i kishte personeli i policisë ushtarake
22 prezente aty, pra, këta i kanë sjellë qytetarë aty lokalë për
23 personat që janë në mbajtje. Pra, përgjithësisht personat kanë
24 qenë një trajtim liberal, në kuptim të vizitave edhe qasjeve
25 të tjera.

1 Këtë mund ta përshkruaj, këto dy vizita në këtë. Objekti
2 ka qenë afër rrugës, në mes të shtabit apo komandës së zonës
3 në Llapashticë edhe pjesës për atë komunës së Podujevës, që ka
4 qenë një formë [E pakuptueshme] apo shikueshme nga qytetarët
5 që kanë mujt ta kalojnë aty pari.

6 PY. Me këtë përgjigje doni të thoni se nuk ishit i njohur me
7 kushtet në të cilat mbaheshin të ndaluarit në këtë objekt?

8 PË. Po nuk mund të them me detaje, për atë jam [E
9 pakuptueshme] është në deklaratë time, por gjithashtu i
10 referohem edhe, pra, komandantit, zëvendëskomandantit të
11 policisë, Nazif Mehmeti, i cili ka raportuar për nevoja shtesë
12 për kushte ku ka kërku batanije ma shumë dhe disa që realisht
13 ju kanë plotësu nga logjistika. Nga kjo, dua të bëj me dije
14 kemi qenë në aspektin koherent në çështje [E pakuptueshme] të
15 përmbushjes së kërkesave në kushtet në këtë qendër të
16 ndalimit.

17 PY. Pak minuta përpara dreke më konfirmuat se nuk e dinit
18 nëse komandanti Remi raportonte në Shtabin e Përgjithshëm për
19 bashkëpunëtorët, kështu?

20 PË. Jo, nuk mund ta di. Ai ishte autorizimi i tij në nivel --
21 për aspektin e komunikimit. Domethënë, ai e ka pas atë
22 kompetencë komunikimit me Shtabin e Përgjithshëm, kështu që
23 s'kam njohuri për këtë, për kontakte të tij.

24 PY. Dhe nuk keni njohuri për ndonjë tjetër në komandën e
25 zonës që njoftonte Shtabin e Përgjithshëm për bashkëpunëtorët,

1 kështu?

2 PË. Jo.

3 PË. Ju keni dëshmuar në 2021 se kur shtabi i zonës së Llapit
4 lëvizi nga Lllapashtica, komanda e zonës vendosi t'i lirojë të
5 ndaluarit nga Lllapashtica, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe në Shënimin Përgatitor 1, paragrafi 30, i javës që
8 shkoi, i thatë ZPS-së:

9 "Komandanti i zonës kishte autoritetin përfundimtar për
10 të liruar të ndaluarit dhe për t'i amnistuar. Megjithatë këto
11 çështje diskutoheshin në takimet e komandës së zonës".

12 Kështu?

13 PË. Po. Ai ka pas autoritetin përfundimtar në bazë të
14 propozimeve ç'ka vinin në kuadër të komandës me dhanë pra, të
15 drejtën qoftë për amnesti, sikur ç'ka ndodh, pra, për vitin e
16 ri, me 31, mos gaboj, dhjetor, por edhe ma vonë, s'e di, disa
17 ditë ma vonë për amnistinë e disa persona para se të jipej
18 amnestia e përgjithshme, për të cilën nuk kam njohuri, përveç
19 që e di që janë liru që të gjithë.

20 PY. Po, por thatë që kishte të drejtën ai dhe autoritetin.

21 Kurse ZPS-së i thatë javës që shkoi "kishte autoritetin
22 përfundimtar, të fundit". Pra, ai ishte personi me rangun më
23 të lartë për të marrë këtë vendim apo për amnistinë e tyre,
24 kështu?

25 PË. Po kështu është. Domethënë pozita e tij e pozita e tij e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 111

1 përcakton atë kompetencë si komandant zone.

2 PY. Në rregull. Pak minuta më parë më thatë që arsyeja pse
3 njerëzit mbaheshin të ndaluar ishte kërcënimi që ekzistonte --
4 rreziku që ekzistonte për njerëzit e UÇK-së dhe ju na
5 përmendët disa njerëz që janë vrarë për shkak të
6 bashkëpunimeve, kështu?

7 PË. Po, supozoj se për atë edhe rreziku ka qenë jo vetëm për
8 ne si strukturë pra, e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën
9 e operative të Llapit, po ka qenë edhe për civilë, si për
10 mbrojtjen civile, ka qenë për personat që kanë qenë
11 bashkëpunëtorë që na kanë përkrahë qoftë në vendosje qoftë në
12 logjistikë, qoftë në aspektin e përkrahjes me personel, kështu
13 që ky rrezik nga këta bashkëpunëtorë ka qenë permanent edhe
14 qëllimi jonë ka qenë që të ndërmarim masa me qëllim që duke
15 respektuar dispozitat e katër konventave të Gjenevës e dy
16 protokolle shtesë, sidomos protokollin II shtesë, që flet, pra
17 neni 75 e 87 lidhur me detyrimet.

18 Edhe ne si zonë operative e Llapit i kemi përmbushur në -
19 - jemi munduar në kushtet ekzistuese t'i përmbushim ato
20 kondita duke i ofruar, duke u siguruar edhe nga ky element që
21 ka rrezikue edhe misionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
22 por edhe civilët, edhe në atë zonën e përgjegjësisë tonë, po
23 edhe përtej asaj që ka qenë si pjesë nën okupim, nën
24 administrim të forcave serbe.

25 PY. Tani, thatë ndërkohë që nuk kishit njohuri që komandant

1 Remi apo dikush tjetër në zonë njoftonte Shtabin e
2 Përgjithshëm për bashkëpunëtorët. Pyetja që kam për ju është:
3 Duke pas parasysh kërcënimin që përbënin këta bashkëpunëtorë
4 çfarë informacioni merrnit në komandën e zonës për këta
5 bashkëpunëtorë dhe për veprimtaritë e tyre?
6 PË. Këto informacione na sillnin vetë qytetarët. Ata e dinit
7 për aktivitetet e këtyre bashkëpunëtorët, kontaktet e
8 vazhdueshme me pjesëtarët e policisë serbe, me pjesëtarët e
9 inteligjencës serbe, gjegjësisht të, pra, të shërbimit të
10 sigurimit shtetëror serb të cilët kanë pas lista, aty duhet ta
11 përkujtoj edhe këtë, që listat që janë edhe kanë qenë pjesë të
12 dokumentarit në televizionin publik të Kosovës "Udhëve", ku
13 nën shtatë persona që janë të listum, aty, nga atë janë pra,
14 ndër ta jam edhe une për likujdim, pra, domethënë, është
15 autoriteti i shërbimit të sigurimit shtetëror serb, ku nga
16 shtatë janë likujdue pesë, ndër ta është edhe një person, pra,
17 i zhdukur, Xhavit Beqiri, nëse nuk gaboju me emër.

18 Edhe me këtë dua të them se të gjithë informacionet që
19 kanë rrjedhë këta bashkëpunëtorë, kanë reflektu në pasoja për
20 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj detyrimisht na është
21 dashtë të ndërmarim masa me qëllim që ta mbrojmë edhe
22 misionin, gjegjësisht, angazhimin tonë, por t'i mbrojmë edhe
23 civilët që na kanë përkrahë në misionin tonë të luftës të
24 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke pas parasysh, normal,
25 edhe dispozitat e katër konventave të Gjenevës edhe dy

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 113

1 protokolleve shtesë çfarë i përmenda ma herët.
2 PY. Megjithatë, ka të bëjë me personat e ndaluar. Pra,
3 mbrojtja civile sjell në Llapashticë ata njerëz që dyshohet si
4 bashkëpunëtorë. Kush i merrte në pyetje këta njerëz për të
5 parë se çfarë informacion mund të merrej prej tyre dhe pastaj
6 çfarë ndodhte me këtë informacion, si i kalohej ai, si i
7 transmetohej ai autoriteteve më të larta në zonë?
8 PË. Pra, jo së pari, në kuadër të zonës së përgjegjësisë së
9 brigadave kanë qenë edhe mbrojtja territoriale, në kudër të
10 çdo fshati apo lokaliteti. Edhe për personat e caktuar për të
11 cilët ekzistonte dyshimi i bazuar se janë bashkëpunëtorë të
12 regjimit serbët, gjegjësisht, të sektorit të sigurisë, ata i
13 paraqitshin në policinë ushtarake të brigadës që ishin në atë
14 territor ku ishin njësitë e mbrojtjes civile. Domethënë, deri
15 komandanti i brigadës jepte urdhër që atë person të raportonte
16 normal, edhe [E pakuptueshme] komandës lidhur me atë person,
17 mandej ai person u sillke nga policia ushtarake në, pra, në
18 qendrën e ndalimit në Llapashticë ku ishte edhe policia
19 ushtarake e zonës, edhe aty u bojke vetëm njoftimi. Arsyet nuk
20 ka pas marrje në pyetje ngase ajo ka qenë e ndaluar.

21 Edhe si u apostrofu edhe aty nga më herët që edhe me
22 vendim të Shtabit të Përgjithshëm, gjegjësisht, me
23 rekomandime, jo marrje në pyetje apo intervistimi, por vetëm
24 njoftimi themelor për ç'ka bohet ndalesa, edhe normal, ne ma
25 vonë posa të përfundojnë ato pra, shkaqet për të cilat ata

1 janë mbajt, ata lëshoheshin.

2 Kështu rridhte procedura. Ne kemi zgjedhur mënyra të
3 ndryshme, domethënë, edhe parandaluese për këtë. Unë te
4 Prokurorja kam përmend një rast për të cilën e diskutuam dje
5 gjatë seancës së mbyllur për një person të caktuar për të
6 cilin unë kur e kam pas -- okej...

7 PY. Nuk mund të diskutojmë në publik dëshmi që është dhënë në
8 seancë të mbyllur, prandaj me kaq e mbyllim.

9 PË. Pa emra, pa vend, po vetëm desha ta përshkruj rastin, por
10 dje, e bisedum atë.

11 PY. Dhatë përgjigje të hollësishme, por pikësëpari, e pamë
12 urdhrin e lëshuar nga Bislim Zyrapin në 28 November [Sipas
13 përkthimit] lidhur me civilët dhe personat që kishin autoritet
14 për t'i ndaluar njerëzit. Por, përpara kësaj, ju ishit
15 komandanti i Brigadës 151, në fillim të nëntorit '98 apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Pra, me sa e kuptoj unë dëshminë tuaj, mbrojtja
18 territoriale sillte dikë në brigadë, person të dyshuar dhe ju
19 --apo e sillte policia ushtarake në brigadë?

20 PË. Policia, policia ushtarake, pra mbrojtja civile,
21 pjesëtarët e mbrojtjes civile binin informacione te komandanti
22 i brigadës, i cili e kishte atë diskrecionin për të marrë atë
23 informacion, mandej ai raportonte në komandën e zonës, aty u
24 merrte vendimi, mandej, lidhur me persona të caktuar, mandej
25 policia ushtarake e brigadës, nëse ekzistonte ky person që ka

1 elemente, u sillte në qendrën e mbajtjes në Llapashticë edhe
2 aty u mbante për disa ditë.

3 PY. Po lexoj faqe 69 të transkriptit të sotëm, dhe thatë që:

4 "Personat e dyshuar për bashkëpunim me autoritetet e
5 regjimit serb, apo organet e sigurisë raportoheshin në
6 brigadë, në atë zonë, dhe pastaj komandanti i brigadës
7 lëshonte urdhër që ai person të paraqitej në komandën e
8 brigadës. Policia ushtarake pastaj e sillte atë person në
9 qendrën e ndalimit në Llapashticë ku ishte stacionuar policia
10 ushtarake dhe aty pastaj bëhej hetimi."

11 Është e saktë kjo?

12 PË. Ashtu.

13 PY. Pra, ti ke qenë komandanti i Brigadës 151 në fillim të
14 nëntorit '98. Të kujtohen raste konkrete, persona konkretë të
15 cilët janë mbajtur të ndaluar në bazë të urdhrit që ka dhënë
16 brigada policisë ushtarake për t'i ndaluar dhe për t'i sjellë
17 në Llapashticë?

18 PË. Mbaj mend vetëm këtë rast për të cilin diskutim në
19 seancën e mbyllur edhe atë e spjegova, nëse ju kujtohet, pa hi
20 në detaje.

21 PY. Pyetja tjetër që kam, pyetja fillestare që kisha është:
22 Duke pasur parasysh rreziqet që përbënin bashkëpunëtorët duhet
23 të ketë pasur ndonjë komunikim me ju si komandant brigade nëse
24 këta i individë përbënin vërtetë një rrezik real për UÇK-në, a
25 ka ndodh kjo?

1 PË. Më fal, s'e kuptova. S'e kuptova pyetjen për ç'ka i
2 referoheni.

3 PY. Në qoftë se një person ndalohej për shkak të një dyshimi
4 se përbënte rrezik ky person për jetën e UÇK-së -- e
5 oficerëve, ushtarëve të UÇK-së, a ndodhte, bëhej një raportim
6 mbasi merreshin në pyetje, mbasi bëhej intervista, raportimi -
7 - policia ushtarake ju sillte juve informacion lidhur me këta
8 persona nëse vërtetë përbënin rrezik?

9 PË. Po ishte në diskrecionin e komandantit të brigadës që kur
10 merr informacionin nga pjesëtarët e mbrojtjes civile ishte
11 diskrecioni i tij të vlerësojë se ai person a ka, a përmban
12 një rrezik potencial për edhe misionin apo gjegjësisht për
13 pjesëtarët e forcës së UÇK-së apo edhe për civilët në zonën e
14 veprimit. Edhe në bazë të kësaj, ai bënte pra, merrte vendimin
15 për që personi të sillet nga policia ushtarake e brigadës në
16 qendrën e mbajtjes në Lllapashticë. Kjo ishte procedura.

17 PY. Pra, dhe ju thatë që ata silleshin në qendrën e ndalimit,
18 merreshin në pyetje nga policia ushtarake. Po më pas kush e
19 merrte vendimin në qoftë se personi në fjalë duhej që të
20 vazhdonte që të mbahej aty te qendra e ndalimit apo duhej që
21 të lirohej? Në qoftë se ata silleshin me urdhër të komandantit
22 të brigadës, a ishte përgjegjësi e komandantit të brigadës që
23 të jepte urdhrin për lirim të tyre në qoftë se vendosej që
24 ata duhej të liroheshin?

25 PË. Jo. E thashë edhe një herë edhe të kufizohemi rreth saj.

1 Nuk ka pas as intervistë as bisedë informative. Policia
2 ushtarake në qendrën e mbajtjes vetëm ju komunikojke arsyen e
3 mbajtjes aty, a kupton, ajo i kufizonte në atë veprim, pasi që
4 intervistës, gjegjësisht, marrja në pyetje nuk është lejuar
5 nga zona. Prandaj dhe kompetencat për lirim të tyre mbetnin
6 në komandën e zonës, jo ma te komandanti i brigadës.

7 Ai ka mund të sjellë informacione që -- apo garancione
8 nga mbrojtja civile e qytetarëve ai do të jetë i ndëgjueshëm
9 sikur që unë e përmenda rastin e mëhershëm si kam menaxhu me
10 një situatë të tillë, edhe personi pasi vijshin garancionit
11 kthyes nga Mbrojtja civile, familjarët e tij se do ta
12 zbatonin atë që ai nuk do të vazhdonte bashkëpunimin, pra,
13 autoritetet serbe, atëherë automatikisht komanda e zonës
14 merrte vendim që ai të lirohet.

15 PY. Në rregull. Atëherë do të bëj një pyetje tjetër mbi bazën
16 e kësaj që thatë. Fillimisht ishte komandanti i brigadës ai që
17 informohej nga mbrojtja civile për një person të dyshuar.

18 Pastaj komandanti i brigadës urdhëronte policinë ushtarake që
19 personi ta sillnin në Llapashticë. Pastaj kush e informonte
20 komandantin e zonës që personi i ndaluar për dyshimin përkatës
21 do kishte qenë bashkëpunëtorë. Kush e kishte këtë punë, kush e
22 bënte këtë raportim ose këtë njoftim?

23 PË. Po raportonte mandej në komandën e zonës për, pra,
24 personin apo personat e ndaluar.

25 PY. Në rregull. Ju vetë para se ta vazhdoj pyetjen, ju lexova

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 118

1 urdhëresën e 28 nëntorit të Bislrim Zyrarit ku ai u mundua që
2 të nxirrte disa urdhra për mënyrën sesi duhej të funksiononte
3 ky proces. Ju kujtohet kjo?

4 PË. Po.

5 PY. A jeni në dijeni që është nxjerrë ose lëshuar një urdhër
6 për krijimin e Gjykatës ushtarake? Jeni në dijeni të kësaj?

7 PË. Jo.

8 PY. Kur e keni dëgjuar për herë të parë?

9 PË. Pas lufte.

10 PY. Në rregull. Pra, në zonën e Llapit ju nuk kishit
11 informacion që ishte krijuar një gjykatë ushtarake me Sokol
12 Dobrunën si personi përgjegjës për të, kështu?

13 PË. As në zonë të Llapit, as në asnjë zonë tjetër, s'ka dëgju
14 deri në fund. Pas lufte kur kam dëgju këto që ç'ka ju
15 shpjegoni tani. Pas lufte.

16 PY. Në fund, Dëshmitar, ne më herët e kemi diskutuar që në
17 fund fare ishte përgjegjësia e komandant Remit që të krijohej
18 qendra e ndalimit në Llapashticë. Juve u pajtuat me mua lidhur
19 me këtë pikë. Unë do ju parashtroj atë çfarë ka thënë
20 komandant Remi, pastaj do ju pyes në qoftë se pajtoheni ose jo
21 me të, dhe në qoftë se nuk pajtoheni më thoni arsyen se pse. E
22 kam fjalën për transkriptin në faqen 5727, gjatë dëshmisë që
23 ai ka dhënë në Gjykatë. Atij i bëhet pyetje:

24 "A pajtoheni me mua që nuk kishte lidhje midis
25 komunikate", domethënë, Komunikatës 54, "dhe ndalimeve në

1 zonën tuaj?"

2 Përgjigje, ai thotë:

3 "Po, pajtohem që kjo komunikatë nuk ka lidhje me vendin
4 ku kam shërbyer unë."

5 Pyetje e parë është kjo: A pajtoheni me këtë deklaratë të
6 tij apo jo dhe në qoftë se jo, më thoni arsyen se pse jo?

7 PË. Po, pajtohem.

8 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon,
10 fjala për ju.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

13 Z. DIXON: [Përkthim]

14 PY. Z. Ibishi, unë quhem Rodney Dixon. Unë do t'ju bëj disa
15 pyetje në emër të Kadri Veselit. Do filloj duke ju orientuar,
16 duke orientuar të gjithë pjesëmarrësit, sepse ju folët për
17 vende të ndryshme gjatë dëshmisë tuaj. Unë do kërkoj që të
18 Sekretarja të paraqesë një hartë, në mënyrë të tillë që të
19 shikojmë zonën tuaj, zonën e Llapit.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Kështu për këtë do i kërkoj

21 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin DKV1585.

22 Faleminderit.

23 PY. Mos e zmadhoni akoma. Është më mirë që ta shikojmë hartën
24 e plotë fillimisht pastaj do ju kërkoj ta zmadhoni. Besoj që e
25 dalloni aty Prishtinën në jug. Pastaj Podujevën diku nga mesi

1 në drejtim të kufirit. Kufiri është me këtë hijen që kjo është
2 pjesa e kufirit me Serbinë.

3 A e shikoni këtë pjesën e hartës, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Kjo zona këtu, dhe janë kufijtë ose jo ekzakt të zonës
6 tuaj të shënjuar aty, por kjo zonë përfshin deri sipër --

7 PË. Veç pak me e rrit zërin, sorry.

8 PËRKTHYESJA: Më dëgjoni mirë tani z. Ibishi?

9 PË. Po vetëm pak zërin ma shumë se ... sorry. Më fal, vazhdo.

10 Z. DIXON: [Përkthim]

11 PY. Faleminderit. Atëherë kjo zona këtu ose kufijtë e kësaj
12 zone që janë të shënuar këtu, kjo është zona e Llapit që shkon
13 deri tek kufiri me Serbinë, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Pra, thjesht për të na orientuar gjithë neve, domethënë
16 deri në pjesën veri-lindore të Kosovës në cepin veri-lindor të
17 Kosovës deri në kufi me Serbinë, deri aty shtrihet kjo zonë,
18 apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Këtu shohim një rrugë që shkon për Serbi dhe vazhdon më
21 poshtë pastaj përmes Podujevës, domethënë, vazhdon, fillon nga
22 Serbia pastaj kalon nga Podujeva në drejtim të Prishtinës. Kjo
23 është rruga kryesore, ose magjistranja, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Rrugët e ndajnë pothuajse në gjysmë zonë tuaj, apo jo? E

1 ndajnë në dy pjesë, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Jo, kjo nuk ndahet, ashtu bash rruga e ndan në dy pjesë.

3 Ngase veç sa për shpjegim kjo përfshin, zona operative e

4 Llapit, përfshin komunën e Prishtinë, e shihni këtu në jug. Në

5 veri Podujeva edhe më poshtë nëse mundet edhe pak me e ngrit

6 hartën më lart.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Po, mund ta zmadhojmë tani.

8 DËSHMITARI: Më lartë, edhe pak. Mirë, në rregull jemi,

9 po. Mandej është pra, ndoshta edhe pak. Është Fushë Kosova

10 edhe Obiliqi. Janë, domethënë, katër komuna që përfshijnë

11 zonën operative të Llapit. Ndërsa këto ç'ka ju e thoni se

12 është në fakt përafërsisht magjistralia Prishtinë-Merdarë e

13 ndan në dy pjesë zonën e Llapit.

14 PY. Është e drejtë të thuhet, apo jo, që kjo magjistrale, kjo
15 rrugë, ishte një rrugë shumë e rëndësishme për forcat serbe.

16 Pra, ishte një rrugë që përshkohej shumë shpesh nga forcat

17 serbe për ta kontrolluar zonën, domethënë, teksa ato udhëtonin

18 nga Serbia për në Prishtinë, kalonin pikërisht nga kjo rrugë.

19 Është e drejtë të thuhet kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po. Këtu kanë qenë të them, ma shumë kalime, po dy kanë

21 qenë shumë frekuentuese domethënë Podujevë -- Prishtinë-

22 Podujevë-Merdarë edhe Prishtinë-Motivodë-Medvegjë. Po ka edhe

23 rrugë të tjera. Gjerësia e kufirit apo të zonës operative të

24 Llapit me Serbinë ka qenë diku rreth 100 km. Gjatësia në të

25 vërtetë e vijës kufitare.

1 PY. Po. Dhe pikërisht kjo e bënte zonën shumë të rrezikshme
2 për ju dhe forcat tuaja sepse bëhej fjalë për një pikë shumë
3 të rëndësishme hyrëse të forcave serbe në Kosovë, kështu? Pikë
4 kryesore.

5 PË. Po.

6 PY. Ju keni qenë në vijë të frontit këtu, apo jo?

7 PË. Po, unë kam qenë disa epror për shkak që kishim një staf
8 të ri akoma pa përvojë edhe ushtarake edhe luftarake, çdo herë
9 edhe niveli i komandantëve të brigadave po edhe të zonës, [çdo
10 herë kemi qenë në vijë të parë. Për këtë me ja u dëshmu une në
11 dy beteja jam plagos. Sidomos në betejën e dytë shumë më
12 rëndë. Kjo tregon që në vazhdimësi ne kemi qenë afër ushtarëve
13 në vijën e parë të frontit në gati çdo betejë.

14 PY. Keni thënë që ky ishte -- kjo ishte një zonë relativisht
15 e izoluar. Dhe shtuat tani që ishte edhe një zonë shumë e
16 rrezikshme. A ka pasur beteja të shumta në këtë zonë, në
17 veçanti përgjatë kësaj rruge me forcat serbe? Ka pasur beteja
18 me forcat serbe në veçanti përgjatë rrugës që përmendët?

19 PË. Po. Ne kemi qenë më shumë të përqendrum në pjesën
20 perëndimore, që flas nga dalja nga Prishtina, pra këtu, me
21 detaje, rruga Prishtinë-Podujevë, pra te fshati Majac, e deri
22 në kufi me Serbinë në drejtim të aksit rrugor të magjistrale,
23 dikun në gjerësi prej gati 25 km në një vijë të frontit. Kemi
24 pasë tri vija të frontit te këto, pra kemi qenë më tepër të
25 përqendrum në këtë pjesë ngase ashtu jemi shtri prej formimit

1 nga Shala e zonës kemi filluar të zbresim në pjesën më [E
2 pakuptueshme] të zonës me qëllim që të kontrollojmë këtë
3 lëvizje, pra, të forcave serbe të cilën, pra, bishin forca nga
4 pjesa e Serbisë dhe që realisht na shkaktonin shumë, pra,
5 probleme, në kuptim të përforcimeve që ishin përtej kufirit të
6 Kosovës.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Dixon, a mund të më
8 ndihmoni të kuptoj rëndësinë e këtyre pyetjeve? Çfarë
9 relevance kanë? E di që ju, apo ekipi juaj kanë përdorur shumë
10 harta në të shkuarën dhe për të caktuara vende të caktuara në
11 hartë megjithatë do të na ndihmoni në qoftë se do të na
12 shpjegonit se çfarë relevance kanë këto pyetje.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do vazhdoj
14 gradualisht duke bërë pyetje lidhur me vendin ku gjendeshin,
15 ku gjendej shtabi. Do bëj pyetje që kanë të bëjnë me distancën
16 dhe gjeografinë. Megjithatë këto pyetje janë të rëndësishme
17 për të përcaktuar kontekstin lidhur me natyrën e operacioneve
18 me të cilat duhej që të përballej zona dhe vështirësia për të
19 pasur qasje në këtë zonë. Këtu dua të dal. Ky është konteksti.
20 Dhe për këtë arsye dua që të pyes se çfarë vëmendje i janë
21 dhënë këtyre çështjeve në raport me çështje të tjera.

22 Kështu që janë pyetje të rëndësishme që lidhen me detyrat
23 e ndërmarra, me kohën kur janë realizuar këto detyra, po
24 gjithashtu edhe kontrollin e komandës dhe mundësinë e tyre për
25 të pasur qasje në këtë zonë, duke pasur parasysh faktin që

1 Prokuroria pretendon që ka pasur një NPK mbulonte çdo gjë,
2 përfshirë këtu edhe këtë zonë kaq të largët.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë të paktën po flas për
4 veten, lidhja është shumë e largët, megjithatë mund të
5 vazhdoni.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk planifikoj që të zgjatem shumë
7 për këtë temë. Por thjesht mendoj që është e rëndësishme që të
8 tregojmë se ku kanë ndodhur, ku kanë ngjarë aktivitetet dhe
9 çfarë detyrash ju janë kërkuar ushtarëve që të kryejnë.

10 PY. Atëherë do të mundohem që të përfundoj me këtë linjë
11 pyetjesh sa më shpejt që të jetë e mundur. Dëshmitar, ju thatë
12 që në pjesën më të madhe të rasteve ju keni qenë në vendosur
13 në pjesën perëndimore të rrugës. Ju lutem, shikoni hartën dhe
14 caktoni aty se ku është Bajgorja, bëni një shënim ku është
15 Bajgorja, sepse në fund të gushtit ju si komandant i Brigadës
16 151 keni qenë pikërisht këtu, domethënë, Bajgorë në atë
17 periudhë. Do ju japë Sekretarja një marker për të shënuar, ju
18 lutem shënoni Bajgorën në hartë.

19 PË. Q'ajo ku kam fillu një këtu.

20 PY. Në rregull. Pastaj drejt fundit të shtatorit ju jeni
21 zhvendosur, keni shkuar në Bradash. A është e saktë kjo?

22 PË. Tash kronologjia Zabërgj, mandej Bajgore, edhe mandej qe
23 edhe Bradash.

24 PY. Po, Bradash. Ju lutem, shënoni me 1 Bajgorën, pastaj
25 tjetrën me 2, dhe tjetrën me 3. Domethënë që të ndjekim

1 kronologjinë që na thatë ju.

2 PË. [Shënon]

3 PY. Faleminderit. Në fund të dhjetorit ne dëgjuaam që kur ju u
4 bëtë shefi i shtabit të zonës, ku keni qenë i stacionuar
5 atëherë, ku e keni pas qendrën, në qoftë se mund të na thoni,
6 edhe jo vetëm të na e thoni, po edhe shënojeni në hartë.

7 PË. Në Katunishtë.

8 PY. Katunishtë, në rregull. Mbase nuk është në hartë sepse
9 disa prej këtyre vendeve janë shumë të vogla dhe jo të gjitha
10 paraqiten në hartë.

11 PË. Po këtu mund të jetë dikund.

12 PY. Ju lutem diku shënojeni aty me numrin 4 ku mendoni që
13 mund të jetë.

14 PË. Po. [Shënon]

15 PY. Më pas prej aty keni shkuar në Buricë, apo jo, që është
16 pak më në jug. A është kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po jo në Buricë ka qenë kjo Brigada 151.

18 PY. Po komanda e zonës është vendos aty apo jo, nuk është
19 vendos në Buricë?

20 PË. Llapashticë. Jo, jo, në Llapashticë ka qenë. Qe mund ta
21 vendosi këtu.

22 PY. Shumë faleminderit.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
24 pranohet në provë harta së bashku me shënimet që bëri
25 dëshmitari.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoli çaktivizuar].

3 [Përkthim] A mund ta përsërisni edhe një herë numrin ERN.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Ishte DKV1585.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet si

6 provë. Ju lutem jepini një numër.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

8 harta bashkë me shënimet përkatëse do të marrë numrin e provës

9 2D32.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

11 DËSHMITARI: S'e vendosa këtë, tash po më intereson

12 kronologjia e brigadës apo kronologjia e postimeve të mia, se

13 s'po kuptoj, zotëri.

14 Z. DIXON: [Përkthim]

15 PY. Unë thjesht isha i interesuar të dija se ku keni qenë të

16 stacionum juve, ku keni qenë të vendosur ju, dhe për këtë

17 arsye ju tregova hartën dhe ju kërkova që të bënit shënimet

18 përkatëse. Tani do ta heqim hartën dhe do ju bëj disa pyetje

19 të tjera.

20 PË. [Në anglisht] *Yes. Just ...* [E padëgjueshme] *yes, gjysëm*

21 *go one --* këtu institucion Burica.

22 PY. Dëshmitar, harta u pranua. Në qoftë se ka ndonjë gjë

23 tjetër që do të shpjegosh ose do të ose të shtosh mund ta bësh

24 përmes dëshmisë tuaj.

25 PË. Jo, jo, asgjë.

1 PY. Mund ta bësh përmes dëshmisë tuaj, mund të na shpjegoni
2 ne, mund t'i shpjegoni Trupit Gjykses se çfarë donit të
3 shtonit në mënyrë se kështu do regjistrohet për procesverbal.
4 Kështu që në qoftë se ka ndonjë gjë që mund të doni ta shtoni,
5 mund ta bëni me gojë tani, Dëshmitar.

6 PË. Jo, kjo është kronologjia e angazhimit tim domethënë prej
7 Zabërgje në Bajgorë, domethënë deri në Bradash edhe në
8 Katunishtë. Ndërsa unë e shkrujta edhe pozicionin e komandës
9 së brigadës në Llapashticë e Poshtme edhe, edhe pozicionin e
10 brigadës 152, pra në Buricë. Kjo. Tash e shpjegova.

11 PY. Po. Po. E shpjeguat, faleminderit. Na interesonte të
12 dinim vendet dhe shpjeguat qartë këtë gjë.

13 Tani do të kalojmë te intervista që i keni dhënë ZPS-së
14 që tani është pranuar si provë gjyqësore. Nuk do kërkoj që të
15 paraqitet në ekran dëshmia juaj, megjithatë do kaloj një pjesë
16 të intervistës që i keni dhënë ZPS-së. Për të qenë i qartë,
17 dua t'ju shpjegoj që do ju lexoj ose do përsëris ato çfarë
18 keni thënë ju. Dhe pasi të kem lexuar pjesët përkatëse të
19 dëshmisë tuaj, do ju bëj pyetje lidhur me ato pjesë. A e keni
20 të qartë procesin se si do zhvillohet?

21 PË. Jo.

22 PY. Atëherë, do t'ju shpjegoj edhe njëherë tjetër me sa më
23 fjalë të shkoqitura që të jetë e mundur. Do ju bëj pyetje
24 lidhur me dëshminë që i keni dhënë me Prokurorinë. Domethënë
25 do ju lexoj pjesë të caktuar atë dëshmisë dhe do ju bëj

1 pyetje. E kuptuat?

2 PË. Po.

3 PY. Në intervistën me ZPS-në thatë --

4 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe këtë e keni thënë në faqen 7,
5 dhe në faqen 15 e në vijim.

6 PY. Pyetja që ju bëhet është kjo:

7 "A e dini ju se kush në atë kohë" dhe bëhet fjalë për
8 nëntorin '98 "ka qenë drejtuesi i shërbimit të zbulim-
9 kundërzbulimit të UÇK-së ..."

10 Përgjigja që ju keni thënë është:

11 "Pas luftës e kam kuptuar që ky person ka qenë Kadri
12 Veseli. Nuk kam pasur mundësi që ta mësoja këtë gjë. Unë nuk
13 jam takuar asnjëherë me të gjatë luftës."

14 Këtë përgjigje e keni dhënë ju për Prokurorin. Pastaj ju
15 bëhet pyetja tjetër:

16 "A e dini se kush ka qenë shefi i përgjithshëm, shefi i
17 sektorit të G2-shit, i sektorit të G2-shit gjatë luftës?"

18 Përgjigja që ju jepni, z. Ibishi, është:

19 "Jo, sapo ju thashë që e kam mësuar vetëm pas luftës se
20 kush ka qenë ky shef. Kush ishte shefi i zbulim-kundërzbulimit
21 atëhere."

22 Tani pyetja që kam për juve është kjo:

23 Kur keni thënë që nuk jeni takuar asnjëherë me z. Kadri
24 Veseli gjatë luftës, a është e drejtë të thuhet që ju nuk e
25 keni takuar zotin, klientin tim, domethënë, nuk e keni takuar

1 në zonën tuaj, apo nuk e keni takuar fare në të gjithë vendin
2 gjatë luftës?

3 PË. As në takimet e zonës, pra, në dy takimet, asnjëherë
4 s'jemi takuar, pra, gjatë luftës.

5 PY. Më pas Prokurori ju pyet:

6 "A keni qenë në dijeni të ZKZ-së gjatë luftës?"

7 Përgjigja që ju jepni është:

8 "Nuk e di çfarë doni të thoni çfarë është kjo."

9 Dhe pyetja tjetër është kjo:

10 "Si oficer i lartë i zonës, a mund të ma shpjegosh t'i
11 mua se çfarë do të thotë kjo?"

12 Dhe ti thua:

13 "Po, sigurisht tani e di se çfarë ka qenë kjo, që ka qenë
14 zbulim-kundërzbulim."

15 Ajo çfarë dua t'ju pyes unë është kjo: Kur thoni që e di
16 tani, a do të thuash që e ke mësuar pas luftës se çfarë ka
17 qenë ZKZ-ja, por nuk e ke ditur se çfarë ka qenë ZKZ-ja gjatë
18 luftës, këtë keni dashtë të thoni?

19 PË. Po ashtu si është shkruar, pra, i referohen që kohës
20 përpara lufte nuk e kam ditë po këtë e kam mësue pas lufte.
21 Kjo është përgjigja.

22 PY. Juve ju bëhet pyetja se kur e keni mësuar pas luftës se
23 çfarë kuptimi kishte ky akronim, ky shkurtim. A mund të na
24 thoni se kur në çfarë periudhe pas luftës keni mësuar se çfarë
25 kuptimi kishte ky shkurtim, ZKZ?

1 PË. Po me të thënë të vërtetën janë përdorë do dy termine
2 simuluarë për -- domethënë kjo ZKZ shumë pak e kemi, e kemi
3 terminologjisë [E pakuptueshme] strukturat organizative, po ma
4 tepër shërbimi informativ, ashtu në atë formë. Domethënë
5 strukturë organizative e kemi has edhe, edhe ma mu më është
6 fikuse si, si shërbim informativ sesa kjo si ZKZ. Mirëpo
7 kuptimi për afërsisht mendoj që është i njëjtë. Mund të jetë i
8 njëjtë.

9 PY. Për të qenë i qartë, ky shkurtimi ZKZ, a është e vërtetë
10 që ju në fakt e keni mësuar që çfarë kuptimi kishte ky
11 shkurtim vetëm pasi ka përfunduar lufta? Është e drejtë, është
12 e vërtetë kjo?

13 PË. E vërtetë.

14 PY. Më pas ju bëjnë disa pyetje të tjera lidhur me sektorin e
15 zbulimit në zonën e Llapit. Ju thoni që:

16 "Ky sektor ishte pak a shumë një sektor me dy anëtarë
17 shtabi -- me dy anëtarë aty. Sikurse e përmenda Latif Gashi ka
18 qenë njëri prej tyre, si dhe Hyzri Talla ka qenë tjetri. Ai
19 është vrarë nga forcat serbe në dhjetor të vitit 1998."

20 PË. Po.

21 PY. Kur flisni për stafin, personelin e zonës, të këtij
22 sektori, nga dhjetori '98 kur është vrarë shoku juaj, z.
23 Talla, domethënë pas vrasjes së tij ka qenë vetëm një person
24 që ka qenë personel i këtij sektori, apo jo? Është kështu,
25 Dëshmitar?

1 PË. Ka qenë një person tjetër apo? S'kuptova. S'e kuptova
2 pyetjen, më fal. Pas vrasjes së tij.

3 PËRKTHYESJA: Pas vrasje së tij ka qenë vetëm një person,
4 kështu, i takon?

5 PË. Po, vetëm një person. Në kuadër të zonës.

6 Z. DIXON: [Përkthim]

7 PY. Po, këtë pyetje të bëra, domethënë që mbasi vdiq z.

8 Talla, mbeti vetëm një person, një personel.

9 PY. Juve ju bënë pyetje dhe ju thatë që:

10 "Z. Latif Gashi prej korrikut '98 ka qenë shefi i
11 sektorit të zbulimit të zonës."

12 Dhe ju keni thënë:

13 "Po, besoj se po."

14 Ju kujtohet ta keni thënë këtë?

15 PË. Po, edhe mendoj ashtu. Në bazë të asaj [E padëgjueshme].

16 PY. Ai është emëruar nga komandant Remi në këtë kohë, në
17 korrik '98, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Sikurse edhe z. Talla, domethënë, të dy ata janë emëruar
20 nga komandant Remi, kështu?

21 PË. Po supozoj se po, tash. Mendoj se në të njëjtën kohë,
22 s'jam i sigurt.

23 PY. Faleminderit. Më pas ju bëhen disa pyetje lidhur me
24 personin të cilit i raportonte z. Gashi. Pyetja është kjo:

25 "... mendoj se ju thatë që Latif Gashi i raportonte në

1 mënyrë të drejtpërdrejtë komandës së zonës, apo komandantit të
2 zonës?"

3 Dhe ju përgjigjeni:

4 "Po."

5 Pastaj ju bëhet kjo pyetje:

6 "A keni pas ndonjë zinxhir tjetër komandimi apo a keni
7 pas ndonjë linjë tjetër raportimi?"

8 Në përgjigje të kësaj pyetje ju thoni:

9 "Jo, jo, me aq sa di unë të paktën."

10 Pastaj ju bëhet një pyetje tjetër:

11 "A i ka raportuar atij drejtpërdrejt shërbimit të zbulim
12 kundërzbulimit brenda Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?"

13 Ti përgjigjesh që:

14 "Jo, nuk kam njohuri lidhur me këtë."

15 Pastaj Prokurori vazhdon më tej:

16 "Po informacioni që mblidhej nga Latif Gashi, çfarë bëhej
17 me këtë informacion? Ku përfundonte ky informacion? Kujt i
18 dërgohej ky informacion? Ku ruhej ky informacion?"

19 Dhe përgjigja që ju jepni është:

20 "Nuk di ç'të them. Më duket pak absurde mua që i gjithë
21 informacion që pretendohej të ishte mbledhur të mbahej vetëm
22 nga dy persona ... dhe të paktën duke ardhur nga i njëjti
23 profesion ose nga e njëjta fushë ekspertize, nuk mendoj që ka
24 qenë e mundur me aftësitë e tyre që të mbahej i gjithë ky
25 informacion."

1 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjatë intervistës,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po me siguri e kam thënë q'aq prespektivë pas.

4 PY. Duhet t'ju bëj disa pyetje për mundësitë, aftësitë apo
5 mundësitë luftarake që kishit. Kur thoshit nuk ishte e mundur,

6 keni parasysh se ishin vetëm dy persona, po, në fakt, ishte
7 një në atë post që kishte për të kryer dhe shumë detyra të
8 tjera? Këtë kishit parasysh kur thatë atë që thatë?

9 PË. Po. Ngase ne si eprorë aty sa ishim nuk ishim vetëm të
10 angazhum vetëm në çështjet ekskluzive të postit, po kryenim
11 edhe detyra të shumta tjera dhe në aspektin e logjistikës. Për
12 shembull, unë isha i angazhum edhe komandant brigade në
13 detyrat e shefit të operativës bashkë me zëvendëskomandantin
14 Kadri Kastratin. Mandej edhe çështjet, pasi betejat ishin
15 kështu të pandërprera apo ishin shumë intensive, atëherë
16 domosdoshmërisht ishim kyçun edhe në luftë, sikurse që është
17 edhe rasti i Latif Gashit, i cili është shquar me angazhim në
18 shumicën apo në të gjitha luftërat, shumicën e luftërave në
19 zonën e Llapit.

20 Për këtë arsye, nuk mund t'i referohemi vetëm postit, por
21 më shumë angazhimeve ngase ashtu e kërkonte momenti,
22 gjegjësisht edhe performanca jonë. Por edhe prania jonë në
23 mesin e ushtarëve të cilët ishin pjesa më e madhe të rinj edhe
24 kishin përkrahje nga më të vjetrit që ishin njerëz me
25 eksperiencë. Po flas për operacionet luftarake, por edhe

1 shërbime tjera.

2 PY. Pra, kryheshin njëkohësisht shumë detyra në të njëjtën
3 kohë, përfshirë edhe beteja të panumërta me forcat serbe, këtë
4 po thoni?

5 PË. Po.

6 PY. Pastaj ju lejuan që t'i përgjigjeshit pyetjeve lidhur me
7 zbulimin. Dhe po jua lexoj dhe do t'ju bëj disa pyetje:

8 "Pra, që të bëhej puna si duhej mblidhej informacioni,
9 analizohej, bëheshin kërkime dhe analizoheshin këto të dhënat
10 e kërkimeve lidhur me pozicionet e armikut, pikat ku bëheshin
11 luftime si dhe zonat që ishin me interes nga pikëpamja
12 luftarake. Pastaj ky informacioni ju transmetohej autoriteteve
13 kompetente për ta trajtuar më tej."

14 Pastaj ju pyetën:

15 "Kush ishin autoritet kompetente?"

16 Ju thatë:

17 "Komanda e zonës."

18 "Pra, këto të dhëna të zbulimit i dërgoheshin nga komanda
19 e zonës Shtabit të Përgjithshëm?"

20 Dhe ju i jeni përgjigjur:

21 "Nuk kam dijeni për këtë."

22 PË. Ashtu është.

23 PY. Faleminderit. Unë dua t'ju pyes për këtë: Kur thoni që
24 bëheshin raporte, hartoheshin raporte që i dërgoheshin
25 komandës së zonës, ju vetë keni parë ndonjë raport ku

1 analizoheshin pozicionet e armikut, pikat e luftimit, i keni
2 parë ndonjë syresh kur keni qenë aty në zonë?

3 PË. Po ka pas raste të ndryshme informacioni. Q'ashtu se nuk
4 thashë se i referohem specifik ndonjë të dhëne. Por realisht
5 secili ka sjellë informacionet e duhura për të cilët kanë
6 qasje, por dhe normal edhe Latif Gashi. Për këtë arsye ai pak
7 në mënyrë ma specifike, por edhe të tjerët që kanë pas mundësi
8 për një burim informacioni me qëllim që me pas permanente të
9 dhënat.

10 Unë, për shembull, një prej detyrave të mia, jo detyra po
11 një aktivitet timin, kam pas në vazhdimësi kam përgjue
12 komunikimin, kam pas një radio të veçantë që kam përgju
13 komunikimin mes forcave të ndryshme dhe ushtarake dhe policore
14 serbe dhe për afërsisht kam mujt të parashikoj rrjedhën e një
15 operacion apo ofensive serbe duke ju referuar edhe përbërjes
16 së forcave po dhe drejtimit të sulmit të tyre.

17 PY. Pra, shkurt, kishe informacion i cili transmetohej dhe i
18 transmetohej komandantit të zonës për këto çështje, apo jo?

19 PË. Po. Mirëpo nuk ishte ekskluziv vetëm Latif Gashi, po
20 ishim të gjithë ne për me u mundu prej burimeve, të gjithave
21 burime të mundshme me marrë informacione edhe në sistemin e
22 përgjimit të komunikimeve.

23 PY. Ju po përpiqeni, ju përpiqeshit të bënit më të mirën tuaj
24 në rrethana të vështira, apo jo?

25 PË. Ashtu është.

1 PY. Dua të që shohim një dokument tani i cili flet për rolin
2 tuaj dhe rolin e sektorëve të tjerë.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk e di nëse mund të vazhdoj, të
4 nderuar Gjykatës, apo mos bëjmë ndonjë pushim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Të shohim materialin me numër
7 P00149, ju lutem.

8 PY. Aty, Dëshmitar, do të shihni një dokument që është nga
9 zona juaj në shqip dhe në anglisht. Është një dokument që ka
10 datën 29 dhjetor 1998 dhe ju keni dhënë dëshmi për të. Ka qenë
11 një dokument që ju thatë në të cilin kontribuar për ta
12 përgatitur në zonë. E njihni?

13 PË. Po.

14 PY. Ai përcakton detyrat e njerëzve të ndryshëm në strukturën
15 e zonës, përfshirë dhe detyrat tuaja si shef shtabi.

16 PË. Po.

17 PY. Dhe në dëshminë tuaj thatë që është një dokument që e
18 keni përgatitur në mungesë të një rregulloreje të përgjithshme
19 të ofruar nga UÇK-ja, pra, e keni bërë në bazë të përvojës
20 tuaj, gjykimit tuaj, për ta përgatitur sa më mirë këtë
21 dokument për përcaktimin e roleve dhe detyrave, kështu?

22 PË. Po. Jo vetëm këtë po edhe disa dokumente tjera. Në
23 mungesë të dërgimit nga Shtabi i Përgjithshëm, ne kemi
24 hartuar, pra, konform kësaj dokumente me karakter të
25 përkohshëm. Dhe kjo mendoj që referohet në fund të këtij

1 udhëzimi për Zonën Operative të Llapit që është dokument i
2 kufizuar me kohë, derisa Shtabi i Përgjithshëm dorëzon një
3 udhëzim të ngjashëm që rregullon fushat edhe detyrat dhe
4 përgjegjësitë e personelit, gjegjësisht, komandës së një zone.

5 Po mendoj që është fund të këtij dokumenti.

6 PY. Po dua që të shohim bashkë një pjesë që ndodhet në faqen
7 2 të shqipes, që fillon "Sektori informativ" dhe tregon disa
8 përgjegjësi të këtij sektori duke filluar me:

9 "- Përcjellë gjendjen e forcave të armatosura të
10 agresorit."

11 A e shihni? Në fillim të faqes.

12 PË. Ëhë.

13 PY. Pra, aty në fillim të faqes thotë "Sektori informativ:
14 ..." dhe jep detyrat.

15 PË. Po.

16 PY. Shoh që e lexuat?

17 PË. Po.

18 PY. Më herët dëgjuam se komandant Remi ka dëshmuar këtu. Ai
19 ka thënë se këto ishin qëllime, me shumë aspirata për t'u
20 përpjekur për të organizuar strukturat, por nuk arriheshin
21 gjithmonë në realitet. Pajtoheni ju me këtë deklaratë si shef
22 shtabi që jeni përpjekur të krijoni organizimin dhe ta
23 realizoni në praktikë?

24 PË. Po, sigurisht. Na e kemi fillu nga zero, të them ashtu,
25 për një kohë të shkurt jemi mundue të krijojmë kapacitetet.

1 Edhe kjo normal që ndoshta ndonjëherë ka qenë sikur një aspekt
2 i një parashikimi, por ndoshta që s'ka mund një kohë të
3 caktuar të realizohet. Mendoj që kjo drejtë është e akceptume.
4 PY. Po. Një nga pikat këtu, e parafundit më duket, thotë që
5 sektori informativ duhet "të ketë një togë dhe duhet ta
6 trajnojë këtë togë". A ka ndodhur kjo në praktikë, nëse po,
7 kur ka ndodhur?

8 PË. Jo. Unë sa di, jo.

9 PY. Nuk kishte një, pra, togë siç përshkruhet këtu?

10 PË. Jo. Jo.

11 PY. Pamë disa diagrama apo organigrama. Nuk ka nevojë t'i
12 kthehem për të kursyer kohë. Pra, do të ishte korrekt të
13 thoshim që në seksionin e zbulimit edhe pse në organigramë
14 thuhet që duhet të ketë një divizion, një departament për
15 planifikimin për mbledhjen e informacionit edhe pse planifikim
16 nuk u krijua një departament i tillë? Ishin, mbetën vetëm në
17 letër, apo jo?

18 PË. Ashtu është.

19 PY. Siç thatë ishte vetëm një person që punonte aty?

20 PË. Më kuadër të zonës, po. Pas vrasjes së Hyzri Tallës.

21 PY. Faleminderit, z. Ibishi. Unë kaq pyetje kisha për ju.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Pasi
24 dëgjova pyetjet që u bënë dhe temat që u trajtuan, nuk kam më
25 pyetje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Znj. Alagendra.

3 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

5 PY. Mirëdita, z. Ibishi.

6 PË. Mirëdita.

7 PY. Unë jam znj. Alagendra, përfaqësoj z. Jakup Krasniqi.

8 Dua së pari t'ju pyes për anëtarësinë tuaj në LDK.

9 Aktualisht jeni anëtar i degës së Prishtinës së LDK-së, është
10 e saktë kjo?

11 PË. Po. Jam anëtar i thjesht pa një pozitë udhëheqëse në LDK.

12 PY. E ju jeni bashkuar me LDK-në në 2014, keni hyrë në LDK,
13 kështu?

14 PË. Për herë të parë, po.

15 PY. Dhe në atë vit jeni zgjedhur edhe si anëtar i
16 parlamentit, po për këtë parti politike, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Pajtoheni, besoj me mua që gjatë kësaj kohe dhe pasi u
19 bëtë parlamentar nuk keni pas ndonjë problem midis jush dhe
20 ish-shokëve tuaj të mëparshëm të UÇK-së, kështu?

21 PË. Jo. Me bashkëlloftëtarët kam respekt të përhershëm.

22 PY. Nëse nuk gabohe, komandant Remi u bë anëtar i PDK-së,
23 apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe u bë anëtar i parlamentit për këtë parti në 2007 deri

1 në 2010, kështu?

2 PË. Më duket se po. Po.

3 PY. Dhe aleancat tuaja politike, po t'i lëmë mënjanë këto,
4 besoj që të gjithë keni pasur marrëdhënie të mira me njëri-
5 tjetrin, kështu?

6 PË. Ashtu është.

7 PY. Më herët na thatë se z. Mustafa ka dhënë dëshmi në këtë
8 Gjykatë, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Besoj që e keni ndjekur dëshminë e tij, apo jo?

11 PË. Pjesërisht.

12 PY. Z. Mustafaj i ka thënë kësaj Gjykate se LDK-ja ishte në
13 shërbim të UÇK-së gjatë luftës. Pajtoheni ju me këtë?

14 PË. Po mendoj LDK-ja është prej partive më të vjetra dhe,
15 mendoj se, po, ka qenë në shërbim të Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës.

17 PY. Dhe sekretari i përgjithshëm i LDK-së Muharrem Latifi ka
18 qenë komandant i mbrojtjes territoriale në Llap, e saktë ë
19 kjo?

20 PË. Muhamet Latifi. Muharrem --

21 PY. Muhamet, po.

22 PË. Muhamet, po.

23 PY. Dhe kryetari i degës së LDK-së në Prishtinë, Shefki
24 Bashi, ka qenë komandant batalioni, apo jo?

25 PË. S'po di. Ndoshta mos mbiemri --

1 PY. Shefki Gashi.

2 PË. Nejse, s'po më kujtohet.

3 PY. Anton Çuni, ka qenë ministër i mbrojtjes në emër të LDK-
4 së edhe ai ka qenë anëtar i UÇK-së, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Lutfi Haziri, një person anë realitet kyç në LDK. Edhe ai
7 ka marrë pjesë në UÇK? Po?

8 PË. Si pjesë aktive nuk e di që ka marrë pjesë, po ka qenë
9 lëvizje. Unë s'kam njohuri sa ka qenë aktiv në uniformë, por
10 si aktivist po. Aktivist në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare
11 të Kosovës pasi që aty janë më shumë kategori përkrahëse. Unë
12 po flas nëse përkon si veteran është diçka tjetër. Mirëpo
13 kategori tjera janë mbështesë në aspektin dhe logjistikës edhe
14 përkrahje tjera janë të kategorizu gati pesë kategori. Dhe për
15 këtë arsye, nuk mund të jap përgjigje saktë. Por nuk ka qenë
16 pjesë aktive të them e luftës në uniformë dhe i armatosur.

17 PY. Pra, shkurt të qenit anëtar i LDK-së nuk ishte ndonjë
18 pengesë që të kyçeshe në UÇK apo ta mbështesje UÇK-në, kështu?

19 PË. Po tash them shumica, një pjesë dërrmuese e lidërshit
20 të UÇK-së ka kalu nëpërmes, sa kanë qenë të rinj, nëpërmes
21 forumit rinor të LDK-së, ashtu sa unë e kam në dëgjime. E ma
22 vonë mandej kur janë bërë pluralizmi politik më i gjerë, atëherë
23 kanë kalu dhe kanë formu parti tjera dhe janë kyç liderë në
24 parti të ndryshme. Kështu që kjo nuk previdikon se nëse ka
25 qenë në fillim në LDK që s'ka kaluar në parti tjetër. Por një,

1 nga sa kam njohuri unë, shumë udhëheqës të UÇK-së kanë qenë
2 dikur në forumin rinor të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

3 PY. Po. Faleminderit. Tani ta kalojmë tek zyrtarizimi i
4 emërimit tuaj si komandant brigade.

5 Ju konfirmuat sot emërtimi juaj u bë nga komandant Remi
6 dhe kjo ka ndodhur në 18 korrik 1998, kështu?

7 PË. Ashtu është.

8 PY. Gjithashtu konfirmuat që i raportoni komandant Remit në
9 këtë pozicion?

10 PË. Ashtu është.

11 PY. Ju na thatë se posti juaj si komandant brigade zyrtarisht
12 u miratua në gusht të 1998 dhe vendimin ua dha Jakup Krasniqi
13 gjatë një vizite që bëri delegacioni i shtabit në zonën e
14 Llapit. Ju kujtohet kjo?

15 PË. Po, më kujtohet mirë.

16 PY. Z. Ibishi, ju nuk e dinit, nuk e njihnit personalisht
17 Jakup Krasniqin përpara lufte apo në gusht 1998. Do të ishte e
18 saktë kjo?

19 PË. Jo, kisha ndëgjju, kisha informacione ngase ishin
20 paraqitjet publike të z. Jakup Krasniqi. Unë e mbaj mend si
21 zëfolës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë. Pra, kisha
22 informacion për të, por personalisht ishte hera e parë që e
23 takoja.

24 PY. Dhe ai po ashtu nuk ju njihte ju, as ju, as profesionin
25 tuaj, si me thënë, rrethanat profesionale në gusht, kështu?

1 PË. Nuk kam njohuri.

2 PY. Tani të vijmë te vendimi që u dha për ju. Ju na thatë se
3 ishte zyrtarizimi i një vendimi që ishte marrë ndërkohë nga
4 komandant Remi, pra, një emërim kishte qenë i mëparshëm si
5 komandant brigade. Nga ato që keni thënë në intervistën në
6 2019, del se ky zyrtarizimi i emërimit tuaj ishte disi si i
7 planifikuar. Pajtoheni ju me këtë përfundim?

8 PË. Po, ashtu ishte.

9 PY. Dhe se në Pjesën 2, faqja 10 e intervistës suaj të 2019,
10 keni thënë që ishit në mes të një trajnimit në shkollën e
11 Bajgores dhe ju thanë, duke trajnuar ushtarët dhe ju thanë të
12 shkonit në komandë. Pajtoheni, ju kujtohet kjo?

13 PË. Po, më kujtohet mirë.

14 PY. Ju shkuat tek kjo shtëpia, u takuat me Jakup Krasniqin
15 dhe komandant Remi ju dha një vendim dhe ju kërkuan që ta
16 nënshkruanit në mënyrë ceremoniale. Ata që ishin të pranishëm
17 ju uruan sukses dhe ju u larguat. Kështu keni thënë?

18 PË. Ashtu është.

19 PY. Dhe kaq ka ndodhur, kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Në intervistën e 2019 me Prokurorinë - dhe për referencë
22 është Pjesa 2, faqja 12 - keni thënë këtë:

23 "Për mua, në atë kohë, Jakup Krasniqi ishte personi që e
24 njihja dhe që ishte zyrtari kryesor në sytë e mi, të tjerët
25 ishin pjesëtar të shtabit dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së dhe

1 nuk u kushtova shumë vëmendje, nuk i pashë të tjerët me të
2 njëjtin sy si personin tjetër.”

3 Pra, ju kujtohet kjo? "... si Krasniqit.”

4 PË. Ngase nuk i njofsha. Nuk i kam pa më herët vërtetë.

5 PY. Dhe vazhdoni dhe thoni -- kjo është në Pjesën 2, faqja 13
6 e intervistës së 2019. Po jua lexoj unë në fillim përpara se
7 t'ju bëj pyetje. Kur ju pyetën "Kush ishte komandant i
8 përgjithshëm aty?" Ju keni thënë "Ishte Jakupi". Kështu?
9 Thjesht dua ta sqaroj çfarë ju krijoi juve këtë përshtypje në
10 atë kohë megjithëse nuk e njihnit personalisht dhe e keni parë
11 vetëm në media.

12 Kishit një përshtypje që pasi e kishit parë në publik
13 daljen e tij publike si përfaqësues, si zëdhënësi i UÇK-së, ju
14 krijoi përshtypje se ishte personi kryesor më i rëndësishëm?
15 Kjo ua ka krijuar këtë përshtypje?

16 PË. Jo, kisha dash që kjo të shiqohet dhe në transkriptin por
17 dhe në zë se asnjëherë s'më kujtohet që kam thënë që ka qenë
18 "komandant". Unë e mbaj mend si zëfolës ashtu. Ndoshta mujt me
19 thënë ka qenë kryesori, them ashtu që e kam njoft, jo
20 "komandant" asesi. Unë kisha dash që kjo të rishikohet, kjo
21 deklaratë e imja lidhur me këtë postim se asnjëherë s'e kam
22 mendue as mendoj se e kam thënë këtë. Se atëherë UÇK-ja nuk ka
23 pas komandant. Si mund të them që ta determinoj diçka çka
24 është inekzistente?

25 PY. Po. Që të jemi shumë të qartë, Jakup Krasniqi nuk ju

1 është prezantuar juve si komandant i përgjithshëm i Shtabit të
2 UÇK-së, apo jo?

3 PË. Jo, as nuk u prezantue, as unë mendoj që nuk e kam thënë
4 një gjë të tillë. Unë kërkoj që të rishikohet pjesa e
5 transkriptit në baza tonike, se e di saktësisht që s'ka qenë
6 komandant.

7 PY. Faleminderit. Ju keni thënë gjithashtu - Pjesa 2, faqja
8 14 e intervistës - se personi me të cilin komunikoni shpesh
9 ishte Bislime Zyrtari. Këtë ju kujtohet ta keni thënë?

10 PË. Po, e kam thënë.

11 PY. Në Pjesën 7, faqja 15 të intervistës e keni konfirmuar se
12 mesa keni pasur dijeni shefi i shtabit ishte Bislime Zyrtari,
13 kështu?

14 PË. Ashtu është.

15 PY. Më përpara ju ka pyetur Prokuroria, ju ka treguar disa
16 organigrama për strukturën organizative.

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe kjo numrin P176 e
18 shënuar me numër provizor. Ta shofim, ju lutem. Ju kërkoj
19 ndjesë, në fakt dua 174.

20 PY. Atëherë kjo është struktura organizative që ju thatë
21 ishte shablloni, modeli që keni marrë me vulën e Shtabit të
22 Përgjithshëm, po apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Ju pajtoheni me mua, apo jo, që ajo çfarë shohim këtu në
25 këtë dokument në të majtë është që dokumenti është i shkruar

1 me shkrim dore, apo jo? Pra, është një organigramë dhe të
2 gjitha postet ose pozicionet në këtë organigramë janë të
3 plotësuara me shkrim dore.

4 PË. Po.

5 PY. A është kështu?

6 A është e drejtë të thuhet që ju nuk e dini se i kujt
7 është ky shkrim dore?

8 PË. Jo, nuk e di.

9 PY. Më herët sot, këtë e keni thënë në Pjesën në faqen 15 të
10 transkriptit të ditës së sotme keni thënë që shablloni ka qenë
11 një strukturë organizative që është dërguar nga Shtabi i
12 Përgjithshëm. A ju kujtohet ta keni thënë këtë sot më herët
13 paradite?

14 PË. Po, e kam thënë.

15 PY. Përpara kësaj, në faqen 7 të transkriptit, në transkript
16 regjistrohet që ju thoni që nuk ju kujtohet se nga e keni
17 marrë këtë organigramë, domethënë, këtë shabllonin nuk ju
18 kujtohet se nga e keni marrë. Po ashtu në procesverbal thuhet
19 që nuk e kujtoni se kur e keni marrë atë dhe se vetmja mundësi
20 është që ju ta keni marrë atë përmes komandës së zonës. A ju
21 kujtohet ta keni thënë këtë?

22 PË. Po, ashtu është.

23 PY. Komunikimet me Shtabin e Përgjithshëm, sipas dëshmisë
24 suaj, mbaheshin vetëm përmes komandantit të zonës, a është e
25 saktë kjo?

1 PË. E saktë.

2 PY. Ju nuk keni komunikuar në asnjë kohë në mënyrë të
3 drejtpërdrejtë me Shtabin e Përgjithshëm, apo jo, z. Ibishi?

4 PË. Jo. Përveç kur kanë qenë vizitë dy herë kam pas komunikim
5 kështu, por jo. Edhe në dy raste tjera me shefin e shtabit,
6 por jo dhe me anëtarë tjerë.

7 PY. Në rregull. Është e drejtë të thuhet, apo jo, që ju nuk e
8 keni marrë këtë shabllon në mënyrë të drejtpërdrejtë nga
9 askush nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

10 PË. Ashtu është.

11 PY. Dhe nuk mund ta konfirmoni se kush e ka përpiluar, se
12 kush e ka hartuar këtë shabllon, apo jo?

13 PË. Jo.

14 PY. Përderisa nuk e dini se kush e ka përpiluar atë dhe kur
15 është përpiluar ky dokument, ju nuk e dini në qoftë se dikush
16 tjetër në zonë e ka përpiluar atë dhe pastaj më vonë ka marrë
17 vulën në dokument. A është e drejtë të thuhet kjo?

18 PË. Nuk kam njohuri.

19 PY. Ti personalisht nuk e konfirmon dot se kur është vënë
20 vula në këtë dokument, apo jo?

21 PË. Jo.

22 PY. Ju mund të na thoni vetëm se keni marrë një grafik me
23 shkrim dore, një organigramë me shkrim dore me një vulë në
24 fund të këtij dokumenti? Ju nuk e dini në qoftë se vula ka
25 qenë më përpara sesa të bëheshin shënimet me shkrim dore ose

1 më pas, apo jo, z. Ibishi?

2 PË. Nuk kam fare detaje. Apo nuk mund të konfirmoj.

3 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do kalojmë tek

4 dokumenti 1765, është dokumenti që ka numër provizor prove. Që

5 është ky dokumenti që mban germën B sipër.

6 PY. Atëherë shikojmë këtë organigramë, këtë strukturë

7 organizative, ju thatë që shënimet në këtë dokument i keni

8 bërë ju vetë, a është e saktë kjo?

9 PË. Saktë. Këto jashtë këtyre, domethënë, strukturës

10 organizative, gjegjësisht, pa kësaj *template* apo, *template*.

11 PY. Po ashtu na keni thënë se ajo çfarë duket këtu me ngjyrë

12 të zezë dhe çfarë duket me ngjyrë blu, dallimet janë sepse

13 dokumenti ka qenë dokument pune dhe se është përditësuar me

14 kalimin e kohës, a është kështu?

15 PË. Ashtu është.

16 PY. Gjithashtu thatë se kur është fotokopjuar, mbase në atë

17 moment ka ndodhë dallimi ose ndryshimi, konvertimi nga ngjyra

18 blu në të zezë ose nga e zeza në blu?

19 Pra thjesht sa për të qenë pak më e qartë, a po thoni ju

20 që një kopje dokumenti pune që është një organigramë me vulë

21 është përdorur herë pas here, është përdorur në vijimësi

22 ndërkohë që janë bërë shënimet përkatëse sipas zhvillimeve

23 përkatëse në të, këtë po thoni?

24 PË. Ashtu është.

25 PY. Në qoftë se do shohim dokumentin dhe në qoftë se dikush

1 nuk do të dëgjonte shpjegimet tuaja për sa i takon fazës në të
2 cilën e shikojmë këtë dokument në provën 1765, duket sikur ka
3 pasur një organigramë me emra të komandantëve dhe pozicionet
4 përkatëse në zonë që është e vulosur nga Shtabi i

5 Përgjithshëm. Por, domethënë, në qoftë se nuk do i dëgjonim
6 shpjegimet tuaj, në pamje të parë, kështu do të dukej ky
7 dokumenti, ky do ishte dokumenti domethënë?

8 PË. Dokumenti nuk përkon me emra këtu. Dokumenti në origjinal
9 është vetëm struktura organizative me pozicionet, gjegjësisht
10 pra, strukturën komanduese edhe udhëheqësit e sektorëve këtu,
11 por pa këto shkrimet plotësuese. Domethënë, kjo është.

12 PY. Po. Por që mban edhe një vulë, domethënë, një kopje me
13 vulë e *template*, e shabllonit është përdorur dhe është
14 ripërdorur nga ti si dokument pune --

15 PË. Po.

16 PY. -- ndërkohë që ju në vijimësi keni bërë shënimet që ju
17 janë dukur të nevojshme?

18 Në kohën që është vënë vula, ai nuk i ka pasur emrat siç
19 i shikojmë neve emrat tani --

20 PË. Jo.

21 PY. -- aktualisht në këtë dokument që mban numrin 1765,
22 kështu?

23 PË. Jo. Vula ka qenë me shabllon pa emra.

24 PY. Prania e vulës në këtë dokument që shohim ne në 1765 nuk
25 mund të konsiderohet si miratim i Shtabit të Përgjithshëm për

1 sa i takon pozicioneve që këta njerëzit kanë në këtë dokument,
2 apo jo?

3 PË. Ashtu është.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do kërkoja tani të kalonim
5 në seancë të mbyllur.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
7 për seancë private?

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
10 në seancë private.

11 [Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 151

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 152

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 153

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 154

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 155

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 156

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 158

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 159

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 jemi në seancë publike.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 përfunduar sot me dëshminë tuaj.

16 Dua të kërkoj, të pyes Prokuroren se çfarë plani është
17 për përfundimin e dëshmisë së dëshmitarit.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Kemi
19 dërguar një email sa i takon dëshmitarëve që planifikohet që
20 të japin dëshmi javën që vjen. Atëherë dëshmitari i parë është
21 4485, pastaj do jenë tere dëshmitarë me videolidhje dhe pastaj
22 do të kemi dëshmitarin 4295 sikurse e kishim planifikuar
23 fillimisht edhe pas tij do vazhdojmë dëshminë e dëshmitarit
24 4759 në varësi të disponueshmërisë së tij.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet që të

1 bëni parashtrimin me shkrim deri në fund të ditës sot.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në fakt e kemi dërguar sot, e
3 kemi dërguar më herët, e kemi dërguar në orën 14.59.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
5 përfunduar për sot. Do të duhet të ktheheni dhe një ditë
6 tjetër, po do t'ju informojë Prokurorja se kur do vini. Ju
7 falënderoj që ishit me ne sot dhe do shihemi gjatë javës që
8 vjen. Faleminderit.

9 Ju lutem mos diskutoni me askënd për përmbajtjen e
10 dëshmisë tuaj, me askënd jashtë sallës së gjyqit.

11 Faleminderit.

12 DËSHMITARI: Faleminderit.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, sikurse e
15 nënkuptove, sot paradite unë do udhëtoj javën që vjen duke
16 përfshirë edhe çështje që kanë të bëjnë me këtë lëndë
17 gjyqësore. Përderisa nuk jemi të sigurtë se kur do të vazhdojë
18 dëshmitari dhe përderisa unë e kam përfunduar, që i kam
19 përfunduar pyetjet për këtë dëshmitar në raundin e parë, mund
20 të bëj një kërkesë që të mund të shfaqem përmes videolidhjes
21 dhe të ndjek këtë dëshmitar përmes videolidhjes për javën që
22 vjen?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Ka ndokush tjetër ndonjë gjë për të thënë? Në qoftë se
25 jo, do shihemi të hënën.

1 --- Seanca mbyllet në orën 16.32

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25